ÇMIMI: 500 LEKË (5 EURO) | (NR: 12) GUSHT 2022 www.newsbomb.al

NEWS BOMB .al



FJALËT QË MARRIN RRUGËT... E VËRTETA E KOSTOVE "TË FRYRA"

PO AFRON

ERRËSIRA



Në brendësi:

dosjet
HISTORITË ME "SPIUNË" LOJA E PISËT E POLITIKËS

turizmi
NË KOMUNIZËM TË HUAJT "VDISNIN" URIE DHE LIRIE...

filmi
GJITHÇKA QË NUK DINI MBI "SKËNDERBEU"-n, "TANA" E "FURTUNA"

asllani
ELBASANLLIU QË PO VRAPON ME INTERIN, RRËFEN JETËN E TIJ



akses®
TIRANA



Redefine *Business.*

INVESTO ME ZGJUARSI!

MATRIX KONSTRUKSION Shaping life!

CEL	+355 69 20 73 531
CEL	+355 69 20 73 530
EMAIL	info@aksestirana.com
EMAIL	shitjet@matrixkonstruksion.com
WEB	www.aksestirana.com

DIKUSH DUHET TË MBAJË PËRGJEGJËSI!

Më dridhet zemra tek mendoj sekondat e fundit në det të Jonadës 7 vjeçare. Më ngrijnë gishtat të shkruaj ndërsa kujtoj imazhin e një babai ulur në gurët e ftohtë të bregut të Potamit, me dy duart që pushtojnë kokën që i buçet nga dhimbja e humbja e toruas, e lotët që rrëshkasin pambarimisht duke ia marrë burrërinë prej tropojani me sekonda; më vjen të ulëras teksa kujtoj njerëzit që nxjerrin aparatët e telefonit dhe duan të kenë në celularët e tyre pamjet tragjike të fundit të jetës shpirtërore të një çifti të ri… Lotët nga sytë s'i ka hequr kush ka parë pamjet.



Nga ANILA BASHA

E mandej, më vjen një ngulçimë prej shpirtit, të bërtas e ulëras se në ç'dreq vendi jetojmë ku themi se kemi ligje, po ligje s'ka; ku themi se ka njerëzillëk, por të tillë s'gjen kund; ku themi se kemi rregulla, por i kemi bërë për t'i shkelur e ku duhet të themi me të madhe se NUK KEMI BËRË ASGJË!

Na del pasandaj gjithë shteti, yrra o burra, me kuç e me maç në aksion të përqëndruar, nga mbledhja e plehrave në bregdet, tek mbledhja e skafeve, gomoneve, jetskive e çdo mjeti tjetër ujor që shfrytëzohet nga ata që dinë, tek ata që s'dinë; nga ata që kanë (para), tek ata që s'kanë brekë në bythë…

E bie ndërmend pak më vonë se kemi ligje, po s'kemi akte nënligjore. Dikush duhet të mbajë përgjegjësi për këtë. E kemi parë kryeministrin që nuk reagon në situata të vëna nën presion, por sërish mendoj se "dreqi ta hajë, ky krim monstruoz ka edhe përgjegjës". Dhe nuk bëhet fjalë për atë policin arrogant që bën cubin në mes të detit, se ai do gjykohet e do dënohet dhe as pendesa dy ditë më vonë e as avokatët nuk do të mund t'i bëjnë gjë për ta shpëtuar.

Këtu ka përgjegjësi, shtetërore, institucionale. Këtu ministrat dalin të mbledhin plehrat me aksione show, por harrojnë të rrinë në zyrë e të bëjnë ligje e rregulla, të bëjnë punën për të cilën janë vendosur në detyrat e tyre.

Ligji për Turizmin parashikon nxjerrjen e aktit nënligjor 6 muaj pas hyrjes së tij në fuqi (në 2020) për "Stacionet sezonale të ankorimit/bregëzimit". Ky udhëzim, apo akt nënligjor, mungon sot e gjithë ditën. Nuk ka korridore ujore, ku duhet të rrinë e ku duhet të hyjnë skafet. Kush quhet e ligjshme e kush quhet e paligjshme.

Nuk kemi parë ndonjë bashki bregdetare që tua vendosë me detyrim përcaktim gjithë subjekteve vendosjen e bovave ujore, lidhur me njëratjetrën që të mos lejojnë hyrjen e mjeteve ujore brenda zonave ku luajnë vogëlushët tanë.

Po kush do ta bëjë këtë? Kush do e marrë përsipër këtë lloj përgjegjësie? Çfarë vlere ka pas kësaj tragjedie të tmerrshme që kryepolici del në konferencë për shtyp dhe kërkon bërjen e këtyre akteve nënligjore në pikun e sezonit?

Ngjarje të tilla i kemi parë vit pas viti në brigjet shqiptare. Sa herë që ndodhin, të gjithë ne themi e shkruajmë se "ky është viti i fundit", e se vitin tjetër nuk do ketë të tilla tragjedi. Por ja që nuk ka ndodhur. Dhe dikush duhet të mbajë përgjegjësi, morale, politike.

Dikush duhet të mbajë përgjegjësi se nuk ka bërë detyrën që duhet të bënte. Kjo, nuk do të lehtësojë asfare dhimbjen e madhe të papërshkrueshme të asaj familjeje që zgjodhi të lërë emigrimin e të vijë të pushojë në Shqipëri. Por, do të ishte një kërkese falje nga ana e strukturave shtetërore që kanë për detyrë të na e bëjnë jetën të sigurt. Në të kundërt, të ruajmë kokën, se kemi me vete veç Zotin; shteti nuk ekziston…

NEWS BOMB al

GUSHT 2022

PËRMBAJTJE



DOSJE DHE INTRIGA

A PO LUHET PËR SHEFIN E OPOZITËS 08

14 DOSJA E "DOSJEVE": LOJA E PISËT E TRANZICIONIT

24 FJALËT QË MARRIN RRUGËT... E VËRTETA E KOSTOVE "TË FRYRA"

Nga FATOS ÇOÇOLI

30 IDEJA E RE NGA RAIFFEISEN BANK



FOTO DËSHMI

NËN RRËNONJAT E SHTËPISË SË NEXHMIJE HOXHËS: NGA MODA SOVJETIKE, TEK FTESAT E DASMËS

Nga ISA MYZYRAJ


























Copyright @2021, të gjitha të drejtat e rezervuara. Prodhim i kompanisë mediatike Newsbomb.al shpk, me NIPT L42417011Q.
Revista publikohet një herë në muaj, 84 faqe me ngjyra. Çdo artikull, investigim, fotografi, ngjarje aktuale politiko-ekonomike-sociale si dhe argëtimi dhe fashion, janë pronë e Newsbomb.al dhe nuk lejohen të merren pa lejen e autorit dhe kompanisë për përdorim të mëtejshëm dhe publikim të paautorizuar.



PO AFRON ERRËSIRA...

Nga FATOS ÇOÇOLI

19



ASLLANI I INTERIT

ËNDRRA E NJË NATE VERE E KRISTJANIT ELBASANAS

Nga RETIN TOKA

71



KUR TË HUAJT 'VDISNIN' URIE DHE LIRIE...

38

44 "MBRETI I BETONIT, MILIONAT E FITUARA NGA TENDERAT PUBLIKË
Nga FLAMUR VEZAJ

48 SI U VRA NJË NËNË QË KËRKONTE NË POLICI VRASËSIT E DJALIT
Nga NIKOLETA KOVAÇI

52 LUFTË DHE SPIUNAZH, NJË HISTORI E PABESUESHME NË GJIROKASTËR
Nga ERALD KAPRI

54 JETA E NATËS NË VITET '90 NGA DISKO ALBANIA DHE MARIKAJ TE BUZUKËT E PARTY-t RAVE
Nga REZARTA DELISULA

58 INVA MULA, UNË SOPRANOJA E PARË SHQIPTARE NË SKENAT EVROPIANE
Nga SUADA DACI

62 FILMAT, NGA "SKËNDERBEU", "TANA", "FURTUNA", SI NISI KINEMATOGRAFIA
Nga ERGYS ALUSHI

80 QUIZ BOMB
Nga KADRI VOKOPOLA

NEWSBOMB.al

GUSHT 2022



Download on the App Store

Available on the Google Play

ABONOHU!

POSTA SHQIPTARE:

+355 68 50 80 753

Redaksia Newsbomb.al:

+355 69 67 32 020

abonime@newsbomb.al

ADRESA:
Rruga: "Emin Duraku",
Hyrja 1, Apartamenti 14, Tiranë

Mobile: +355 69 922 2201 | +355 69 922 2202

E-mail: info@newsbomb.al

Newsbomb SHPK
NIPT: L42417011Q

NEWSBOMB.al

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ANILA BASHA

BASHKËPUNUAN

FATOS ÇOÇOLI

ISA MYZYRAJ

FLAMUR VEZAJ

REZARTA DELISULA

LUELA MYFTARI

NIKOLETA KOVAÇI

ERGYS ALUSHI

RETIN TOKA

SUADA DACI

KADRI VOKOPOLA

GRAPHIC DESIGN

ALTIN ALIAJ

TIRANA BANK



DEPOZITA
DERI NË
6.6%
INTERES

PARATË E TUA PUNOJNË PËR TY

EDHE KUR TI EKSPLORON DETIN

DOSJE DHE INTRIGA

A PO LUHET PËR SHEFIN E OPOZITËS

Në fundin e një korriku ku nuk po ndodhte ndonjë gjë e madhe, kur sesioni parlamenar ishte mbyllur dhe kur supozohej që një paqe politiko-mediatike po nderej mbi shpirtrat e lodhur të këtij trualli, një shkresë e beftë nga Autoriteti i Dosjeve, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, ndryshoi gjithçka. Një ditë pasi la postin më të lartë që njeh Kushtetuta e vendit, atë të Presidentit, Ilir Meta u shpall bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit.

"Kemi zbuluar se Ilir Meta është bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit", thotë pak a shumë letra drejtuar kryetares së Kuvendit, Lindita Nikolla. Këtë e bëjnë të ditur për revistën Newsbomb.al, persona që e kanë parë dokumetin. Autoriteti i Dosjeve, kërkon më tej ndryshim ligjor, për të bërë të mundur zbardhjen dhe transparencën. Pasiqë, një nen i ligjit i ndalon publikimet apo hulumtimet për rastet kur komisionet e mëparshme, si Mezini apo Bezhani, janë shprehur.

Autoriteti kishte hedhur sakaq një sy tek dosja përvëluese, dhe e komunikon zbulimin, por nga ana tjetër, hiqet sikur e mban ende sekret. Mirëpo, për ta bërë publike të gjithën këtë, kujdeset shefja e Parlamentit, e cila shprehet se është shumë e shqetësuar nga ky informacion që ka marrë.

I gjithë mekanizmi ishte vënë në lëvizje nga një email anonim, që përpos Autoritetit të Dosjeve, i qe adresuar me gjasë edhe partnerëve në Tiranë.

Ky ishte zjarri i parë në Shqipërinë piroteknike, që nxjerr flakë e tym ngado në ditët e gjata me 40 gradë.

Siç edhe pritej, përgjigja e Ilir Metës nuk ishte më pak shpërthyese. Tanimë si kryetar i PL, partisë së dytë më të madhe në opozitë, ai akuzoi menjëherë Edi Ramën si përgjegjës të kësaj loje të pisët siç e cilësoi, të këtij manipulimi në shkelje të ligjit e Kushtetutës.

Në nxjerrjen e dosjes së sigurimit për Ilir Metën, mund të ketë dorë edhe Sali Berisha. S'ka dyshim që ish-kryeministri e ish-presidenti i vendit, ka patur dijeni. Por, siç kanë treguar shpesh bashkëpunëtorë të tij të vjetër, ai ka patur po ashtu pasion ruajtjen e një kopje, për ta përdorur si mjet në synimet politike



Sezoni i ri politik që nis në shtator pritet të jetë më i ashpri i skenës politike në këto dekada. Nisma janë depozituar në parlament që synojnë hapjen e dosjeve të Sigurimit të Shtetit, e më tej ndalimin me ligj të aktivizimit politik të bashkëpunëtorëve apo personave të shpallur non-grata. Ilir Meta dhe Sali Berisha në target. Kush e nxori dosjen e Ilir Metës, dhe a është në lojë lidershipi i Opozitës. Çfarë fshihet në nëntokën e politikës dhe ç'pritet të ndodhë? A do të jetë ky shtator përcaktues për fatin e Ramës, Metës dhe Berishës? Një analizë e plotë nga Newsbomb.al



QETËSIA RA. S'KA PUSHIME!

Vaktet e nxehta të Gushtit që kanë zhytur gjithë shoqërinë në një gjendje flegmatike, të përgjumur e pa energji, duket se nuk i penguan aspak Sali Berishën dhe Ilir Metën që përkundër kësaj atmosferë të bëjnë aksione frenetike, energjike dhe të zhurmshme, duke dominuar dukshëm skenën publike për gjithë këto kohë. Për më tepër, qendrimet, angazhimet dhe përbetimet e tyre, na tregojnë se shtatori, në kuptimin politik, do të jetë edhe më përvëlues se sa moti i rënduar klimatik i kësaj vere.

Me rikthimin e Ilir Metës në LSI, që sak të njëjtën ditë u shfaq me logo dhe emër të ri, Partia e Lirisë, një tonus tjetër i erdhi ritmeve të ditës, ku denoncimet dhe retorikat e ashpra nuk mungojnë asnjë çast. Por ato u bënë, kërcënuese dhe të fundbotshme, pas asaj ngjarje që është shumë e vështirë për ta besuar si rastësi. Bash 24 orë pasi la zyrtarisht godinën e Presidencës, dhe pushoi së qëni kreu i shtetit, u shfaq në publik një fabul që fillimisht krijoi shumë pështjellim. Dhe duhet pranuar, ndihmoi jo pak në lënien mënjanë të skandaleve të shumta qeveritare, sidomos atë të aferës së incineratorëve, që po e nxjerr fare zbuluar Ramën me të tijtë, në një abuzim monumental.

Argumenti u mbajt ndezur nga ai që nuk mungon në kësi rastesh, Taulant Balla, i cili shpalli se e përkrah nismën e Autoritetit të Dosjeve, dhe ka lënë të kuptohet se do ta pasurojë akoma më tej këtë iniciativë. Në target tanimë është jo vetëm Meta, por edhe Berisha.

Në emër të mazhorancës, Balla ka lënë të kuptohet se do të ndalojnë me ligj dy liderët e opozitës, që të merren me politikë.

Reagimi i Ilir Metës qe më shumë se sanguin. Ishte i ashpër. Kërcënues. Madje, me terminologji të marrë nga slangu i të fortëve të Tiranës.

Duke i thënë Ramës vagabond, dhe se e thyen në mes, Ilir Meta dëshmoi edhe një herë se ka jo pak raste kur emocionet e kontrollojnë atë, e jo anasjelltas. Ky komunikim in-extremis, gjithaq të bën të kuptosh se nuk ka më asnjë ndërmjetës mes tyre, asnjë korrier që të mund të marrë e japë mesazhe. Ka ngelur që t'ja bëjnë të ditur kumtet shoshoqit përmes mediave.

RIKTHEHET GJUETIA E DOSJEVE

Siç ka ndodhur jo rrallë në këto 3 dekada në luftën politike në vend, në atë betejën e ashpër e të vrazhdë për asgjesimin e kundërshtarit, jo mundjen e tij me ide, vizion, apo platformë, por dekapitimin me instrumen-

Dosjet. Veçanërisht ato që lidhen me Sigurimin e Shtetit, janë hije të zeza që asnjëherë nuk u bënë publike si duhet, por u mbajtën sipas volisë nëpër sirtare

ta të tjerë, në ndihmë vijnë si gjithnjë armët e preferuara. Dosjet. Veçanërisht ato që lidhen me Sigurimin e Shtetit. Këto hije të zeza që asnjëherë nuk u bënë publike si duhet, por u mbajtën sipas volisë nëpër sirtare.

E gjithë politika e tranzicionit ka qënë e bërë pis dhe e zhytur në atë baltë, ndaj ata kanë ruajtur në një farë mënyrë njëri-tjetrin, duke mos nxjerrë kurrë të plotë nga errësira këtë histori të palavdishme.

Një analizë e rrethanave të çon në konkluzionin se rruga që kërkon të ndjekë mazhoranca dhe Rama në këtë rast, për kundërshtarët e tij, përvijohet në dy segmente. Në fillim demaskim, linçim publik, më tej ndalim.

Shenjat janë dhënë. Nismat ligjore në shtator do të bëjnë të mundur publikimin e dosjeve, pra nxjerrjen e njollës faqe botës. Më tej, sipas paralajmërimeve, po me ligj, do të kërkohet ndalimi i karrierës, i politikës, apo i ushtrimit të funksioneve publike për të shenjuarit.

Po gjithë synimi është që me një gur, rilindasit të vrasin dy zogj. Nëse ja dalin ta nxjerrin Metën të lidhur me Sigurimin e Shtetit, duan po ashtu që me këtë vrull, të asgjesojnë edhe Berishën.

Nisur nga e shkuara e tij si anëtar i Partisë së Punës, apo mbajtës i ndonjë posti që ka patur të bëjë me propagandën dhe ideologjinë e regjimit të atëhershëm. Pa harruar asin që e kanë nën mëngë, shpalljen e tij non-grata.

Ndryshimet në ligj, në Kodin Zgjedhor, apo në atë të Dekriminalizimit, s'ka dyshim se do të bëhen enkas, në rrobaqepësinë e duhur, sipas përmasave të kreut të PD e PL.



E gjithë politika e tranzicionit ka qenë e bërë pis dhe e zhytur në atë baltë, ndaj ata kanë ruajtur në një farë mënyrë njëri-tjetrin, duke mos nxjerrë kurrë të plotë nga errësira këtë histori të palavdishme

SHTATOR PËRVËLUES

Eshtë premtuar. Sinjalet janë dhënë. Këtë shtator që po vjen kazani i madh i politikës do të ziejë rëndshëm dhe me ç'duket gjithë llurba do të derdhet, do të dalë në shesh. Nuk ka asnjë dyshim që kundërshtarët nuk do të kursejnë asgjë për njëri tjetrin.

Edi Rama me gjasë do ta godasë Metën me dosje sigurimi, më anë tjetër, kreu i PL s'ka ndërmend të qëndrojë duarkryq. Ka thënë se materiale tronditëse do të shfaqen për kryeministrin.

Ngacmime me "djalin e Netës", apo me të dhëna për bashkëpunimin e tij me revistën e sigurimit të Shtetit janë hedhur në letër. Ose pyetje, të tilla si; Çfarë të lidh me A.L, apo N.L?

Quize që na bëjnë të ditur se arkiva e lëndëve eksplozive që kanë palët për njëri-tjetrin, është e bollshme.

Se nuk do të ketë më qetësi, kjo është marrë vesh që me protestën e madhe të 7 korrikut, ku Sali Berisha e ka shpallur armik kreun e rilindjes. Dhe do të sillet me të si me një armik.

Rama do të bëjë gjithçka ka në dorë për ta nxjerrë nga skena kreun e PD, të rikthyer në krye të opozitës. Me ndryshimet që mund të sjellin skualifikimin nga loja të personave non-grata, ose të atyre që kanë pasur funksione në Partinë e Punës.

Konsensus për këto nisma, që kërkojnë vota më shumë sesa Rama gëzon aktualisht, pritet të gjejë tek deputetët që mbështetin Lulzim Bashën. Ish-kreut të PD dhe pasuesve të tij, i pëlqen dhe shijon secila përpjekje që do të dëmtonte Berishën dhe Metën, duke mbajtur gjallë iluzionin e tyre për një rikthim në fushë.

Mbështetja e partnerëve, më saktë e Ambasadës Amerikane, në iniciativa si këto, duket se është e gatshme dhe e pakursyer.

Për më tepër, në këtë klimë, Alibeaj ka depozituar një projekt në Parlament, që është edhe më agresiv se ajo që kërkon Autoriteti i Dosjeve, e që u mbështet menjëherë nga Balla.

Popozimi i Alibeajt synon hapjen totale të dosjeve, lustracion, e po ashtu dekomunistizimin e shoqërisë. Skakierat janë bërë gati. Shqiptarëve do t'u duhen nerva dhe stomak i

META E MOHON, RAMA PËRGJIGJET PAS 5 DITËSH

Sapo është bërë publik lajmi, pas shkresës së Autoritetit të Dosjeve dërguar Kuvendit, Ilir Meta e ka mohuar kategorikisht të ketë patur lidhje me Sigurimin e Shtetit, duke u shprehur se është e gjitha montim i Edi Ramës.

5 ditë më vonë, më 30 korrik, Kryeministri ka bërë të parin e të vetmin reagim për këtë çështje me një shënim të gjatë në rrjetin e tij social.

"A është bashkëpunëtori i Sigurimit me inicialet IM, pikërisht ish-presidenti, ish-kryekuvendari, ish-kryeministri dhe ish-dhjetoristi i shfaqur mes studentëve, në takimin me Ramiz Alinë?", e nis Rama qendrimin, që është më tepër një lëvrim publicistik, se sa deklaratë e një kreu qeverie. Shefi i rilindjes më tej ka shpenzuar shumë kohë e hapësirë për të sqaruar se pikërisht Genta Sulën që Meta sot e akuzon si e përdorur nga Rama, ka qenë saktësisht ai që ja ka propozuar për atë pozicion që mban sot.

"Unë nuk e di a është Ilir Meta apo Metaj, ky spiuni me inicialet I.M dhe as e kam parë vetë dosjen! Po ama një gjë është shumë fare e sigurtë: Mes Autoritetit të Dosjeve nga njëra anë, i cili thotë shkresërisht, se Iliri që doli nga Presidenca para pak ditësh është i njëjti Ilir, që doli edhe nga dosja e Sigurimit pak ditë më pas dhe nga ana tjetër, Ilir Metës apo Metajt, i cili shan e bërtet që bëhet fjalë për një Ilir tjetër dhe se kjo është një poshtërsi e madhe patronazhistësh, padiskutim që unë i besoj trupës së drejtuar nga Genta Sula e vetë asaj", shprehet Rama.

Kryeministri pohon se këtë histori nuk i takon politikës ta ndajë, por vetëm Autoritetit të Informimit mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit. Rama hedh po ashtu idenë se personat e lidhur me këto dosje, duhet të bëhen pjesë e ndalimit që përcakton ligji i Dekriminalizimit, dhe thotë se në Shtator do të vijojë më tej me këtë argument duke shpallur mbështetjen për nismën që ka mbërritur në Kuvend prej Genta Sulës.



fortë për të përballuar vërshimin sekëlldisës të sezonit të ri politik që do të nisë së shpejti. Bashkë me të edhe të emisioneve të shumta politike, që si ushqim kryesor do të kenë pikërisht këtë temë. E gjitha në një kohë kur tensioni politik do të vijë në ngjitje edhe për një arsye tjetër, duke qenë se gara për bashkitë është gjithnjë e më afër.

PSE U RISHFAQ IDEJA E QEVERISË TEKNIKE?

Zor se një sipërmarrje e tillë do të pritej me një entuziasëm të çartur brenda radhëve të mazhorancës. Ka aty, në Grupin Parlamentar, ose në pozicione të tjera kyçe, njerëz të lidhur me të shkuarën komuniste që do të prekeshin nga ndonjë ndalim me ligj. Në parim, çdo lustracion, të majtës, trashëgimtare të Partisë së Punës, do t'i kushtonte shumë më shtrenjtë se të tjerëve.

Burime qeveritare tregojnë se Rama mund të jetë nën presion edhe nga partneri ynë më i rëndësishëm, e në këtë mënyrë, do ta çojë deri në fund këtë "revolucion". Por premisat janë reale që të ketë rezistencë dhe rrjedhje nga kartonat e shumicës.

Eshtë kjo arsyeja që ka risjellë edhe një herë në skenë termin dhe idenë e një qeverie teknike, të përmendur dendur së fundmi nga Ilir Meta.

Disa besojnë se ky lloj lustracioni, mund ta rrëzojë qeverinë, mund të bëjë që shefi i rilindjes të humbasë mbështetjen. Nga ana tjetër, specialistë dhe njohës të kësaj çështje kanë shprehur rezervat e tyre për një proces të pjesshëm. Dhe në të vërtetë ngelet absurde dhe gjueti shtrigash, nëse do të ndalohej me ligj aktivizimi politik i një bashkëpunëtori të Sigurimit të Shtetit, ose të dikujt që ka pasur post drejtues në parti, kurse xhelatët e vërtetë, ata që kanë qenë hetues të diktaturës, ose oficerët e saj, të vazhdojnë karrierën të qetë.

Kjo rrit skepticizmin, nëse një nisëm e tillë është realisht një përpjekje serioze për pastrim e katarsis me të shkuarën e dhimbshme dhe kriminale, apo një bllof, një lojë politike për t'i marrë rezultatet në tavolinë.

BERISHA-META,
A KA RIVALITET PËR LIDERSHIPIN E OPOZITËS?

Të vënë në shënjestrën e Ramës dhe shumicës parlamentare me nisma si këto të shtatorit, natyrshëm se Sali Berishën dhe Ilir Metën kjo i bën edhe më të afërt me njëri-tjetrin. Çimenton lidhjen e tyre, qoftë edhe nëse do t'u duhet të luftojnë për t'i mbijetuar kësaj vale,



Në protestën e 4 gushtit në bulevard, Berisha dhe Meta kishin zënë vend në anë të ndryshme, secili për hesap të vet, shoqëruar me mbështetës. U desh ndëhyrja e një deputeti, spontane po aq, për t'i bërë ata bashkë në një moment, afrim e shtrëngim duarsh që kapi vëmendjen e mediave dhe u shfaq live

pa përmendur këtu synimin tjetër që është ardhja në pushtet.

Po a shkon gjithçka grurë mes dy liderëve, të cilët nuk e mohojnë as në publik vlerësimin që kanë për njëri-tjetrin?

Protesta që u zhvillua me 4 gusht, pas vdekjes tragjike të një fëmije në Himarë, përplasur fatalisht nga një skaf që drejtohej prej një polici, nxori në pah se mund të ketë një çalim të komunikimit mes tyre.

Berisha dhe Meta kishin zënë vend në pjesë të ndryshme të bulevardit, secili për hesap të vet, shoqëruar me mbështetës. U desh ndëhyrja e kujdesshme e një deputeti, spontane po aq, për t'i bërë ata bashkë në një moment, afrim e shtrengim duarsh që kapi vëmendjen e mediave dhe u shfaq live.

Besohet se ka jo pak hapësirë në shoqëri, ka jo pak popull që nuk e do qeverinë, që ende nuk është rreshtuar megjithatë me PD. Ky është një target që synohet ethshëm nga Meta. Të dy kanë nevojë të zgjerojnë bazën e mbështetjes në publik dhe të kapërximit të radhëve të militantëve. Meta edhe më shumë, duke qenë se rezultati i fundit zgjedhor i LSI, ishte katastrofik.

Ndoshta kjo bëri që ai ta përmbysë atë formacion, ta risjellë me një emër tjetër, me drejtues të rinj, e formë të re dhe më energjike të aktivizimit.

Terreni ku luajnë të dy, është i njëjti, dhe padyshim se përtej dakordësisë së madhe, kjo sjell edhe rivalitet mes Berishës dhe Metës.

Një sprovë do të jenë zgjedhjet lokale që po vijnë, e në veçanti Bashkia e Tiranës. Kreu i PL e ka thuajse çdo ditë në të folurën publike këtë qytet, duke dekonspiruar në këtë mënyrë ambicien e tij për një zyrë që është jo vetëm më e rëndësishmja pas asaj të Kryeministrit, por dhe kapitali politik e financiar më i madh në vend, e rruga më e sigurtë për të shkuar drejt majës.

Berisha nuk ka munguar të sqarojë se do të ketë primare për caktimin e kandidatëve. Primare, do të thotë se ai që do të rivalizojë me Veliajn, do të dalë nga radhët e PD.

Pakti që do të arrihet për vendoret, fushata, dhe më tej, rezultati që do të marrin, do të jenë vendimtare për të ardhmen e aleancës mes aktorëve kryesorë të opozitës.

INTRIGAT NË MES?

Megjithatë, jo pak vëzhgues të politikës bizantine të Tiranës, mendojnë se diçka po ndodh në nëntokën e Opozitës. Rikuperimi që mori Meta ditët e fundit të mandatit presidencial, duke u ftuar në festën kombëtare të SHBA, hapja e ceremonisë me fjalën e tij, vizitat e vazhdueshme në Uashington të zonjës Kryemadhi, tregojnë për një shërim të këtyre raporteve, që vetëm pak muaj më parë ishin në pikën e vdekjes.

Burime serioze tregojnë se vetë Meta, pritet të ketë një vizitë së shpejti përtej oqeanit.

Të gjitha këto, kanë ushqyer në tryezat e atyre që komentojnë zhvillimet e nëndheshme, se mundet që Meta të ketë marrë përsipër rolin e futjes së Opozitës nën kontroll, përpara partnerit që ka vendosur të mos ketë raporte me Sali Berishën, e të cilin po e lufton në të gjitha drejtimet. Nuk është më pak relevante në këtë drejtim, edhe shpallja po ashtu non-grata nga Londra. Një akt që e dobëson edhe më shumë liderin demokrat në sytë e publikut.

Ngjan si një terren i mirë për Metën për t'u rritur akoma më shumë. Edhe ndryshimi i emrit shkon me këtë llogjikë. Duke e quajtur Partia e Lirisë, ai ka ofruar një strehë për më shumë opozitarë se sa anëtarët e LSI.

Nga ana tjetër, njihet zotësia e tij për të bërë pakte personale e për t'u qendruar atyre, me faktorë brenda të djathtës, që për një arsye apo një tjetër, mund të kenë pakënaqësi me Berishën.

E gjitha kjo panoramë, ka mëkuar në jo pak ambjente idenë, se në nxjerrjen e dosjes së sigurimit për Ilir Metën, mund të ketë dorë edhe Sali Berisha. S'ka dyshim që ish-kryeministri e ish-presidenti i vendit, ka patur dijeni. Por, siç kanë treguar shpesh bashkëpunëtorë të tij të vjetër, ai ka patur po ashtu pasion ruajtjen e një kopje, për ta përdorur si mjet në synimet politike.

Jo pak vetë, nuk lënë jashtë kësaj intrige edhe Erjon Veliajn, i cili njihet për influencën që ka në disa pika e zyra të rëndësishme, siç mund të jetë edhe ai i Autoritetit të Dosjeve. Kjo duke qenë se jo rrallë flitet që Meta vetë aspiron të kandidojë për Bashkinë e Tiranës. Deri më sot, vetë i prekuri ka identifikuar si autor të kësaj goditje, të paktën në publik, vetëm një njeri. Edi Ramën.

PREMIUM

QAFSHTAMA

UJI I SHËNDETIT

ZERO NITRATE

I PASUR ME MAGNEZ



Furnizimi me ujë shoqërohet me pajisjen dhe mirëmbajtjen e saj.

Kontakt
+355697009900
www.qafshtama.com

I vetmi ujë i mbushur në lartësinë 1350m

- Ujë i nxehtë
- Ujë ambienti
- Ujë i ftohtë

Sistemi ftohës gaz R134a

Frigorifer i poshtëm 16L

Dalje direkte e ujit

I përshtatshëm për 11 dhe 19L



DOSJA E "DOSJEVE": LOJA E PISËT E TRANZICIONIT

Azem Hajdari Frrok Çupi

Në shtator 2022 parlamenti do të duhet të marrë në shqyrtim një nismë të mazhorancës socialiste lidhur me amendimin e ligjit të dekriminalizimit, duke mundësuar verifikimin e të gjithë kandidatëve për deputetë për rekordet e tyre lidhur me Sigurimin e Shtetit. Nisma është politike dhe nuk është e destinuar të japë rezultat dhe nuk është strategji afatgjatë, por efekti kryesor i saj është afatshkurtër, për përdorim politik ditor. Të njëjtin fat, kanë pasur nisma të tilla të njëjta për konsum politik, e fundit e vitit 2009, rrëzuar nga Gjykata Kushtuese me vendimin nr.9 të marsit 2010. Këtë herë preteksti i debatit lidhet me një lajm të prodhuar nga Autoriteti i Dosjeve, sipas të cilit ish Presidenti i Republikës Ilir Meta ka qenë bashkëpunëtor dhe denoncues në favor të Sigurimit të Shtetit. AIDSSH ka dhënë opinione pozitive të Ilir Metën më 2017 kur ai u zgjodh President, por pas mbarimit të mandatit i njëjti institucion dhe të njëjtit drejtues japin opinion negativ për të njëjtin subjekt.

> Sa herë vendi ndodhet në krizë besimi apo ka interesa elektorale politika rikthen në debat çështjen e hapjes së dosjeve

Kuvendi ka informuar grupet parlamentare, mazhoranca dhe opozita njoftuan nisma të reja parlamentare, por vetë Meta e ka denoncuar si akt manipulues, ndërkohë që AIDSSH nuk ka bërë publike as rekordet e dosjes dhe nuk mundëson as aksesin e medias për të hetimin e rastit. Në tërë këtë histori, rezultatet e para janë marrë dhe janë të dukshme: e para, politika vijon të përdorë çështjen e dosjeve edhe pas 32 vitesh nga ndryshimi i sistemit, e dyta, institucionet përgjegjëse kanë ndikim të theksuar politik, e treta, ka politikanë që ende nuk kanë bërë transparencën e plotë të CV jetësore të tyre dhe së fundi, se kauza e dosjeve si mjet presioni vijon të jetë e fortë dhe atraktive nga të njëjtit aktorë politikë që kanë qenë pro ose kundër hapjes së tyre, në varësi nga interesi elektoral.

Më 2009 PD inicoi ligjin e lustracionit, ligj me nene radikale që me të drejtë u refuzua nga Presidenti Topi dhe u kritikua nga SHBA, BE dhe OSBE, por ishin socialistët ata që duke kundërshtuar edhe hapjen e dosjeve e dërguan çështjen në Gjykatë Kushtetuese dhe arritën fillimisht ta pezullonin ligjin dhe më pas ta rrëzonin atë si antikushtetues. PS u përfaqësua në atë kohë në Gjykatën Kushtetuese nga Vasilika Hysi dhe Shega Ligori.

Më 2020 ishin përsëri socialistët që refuzuan një nismë ligjore radikale të ndërmarrë nga deputeti Myslim Murrizi për të ndaluar marrjen e posteve politike e publike të individëve që kanë qenë pjesë e nomeklaturës së regjimit të vjetër dhe pjesë e Sigurimit të Shtetit. Në emër të PS argumentet për rrëzimin e nismës u paraqitën nga deputetët Ulsi Manja dhe Alket Hyseni, i pari aktualisht Ministër i Drejtësisë dhe i dyti kryetar i gjykatës në Partinë Socialiste. 13 vjet nga rrëzimi i ligjit të parë në Gjykatën Kushtetuese dhe vetëm 2 vjet nga rrëzimi i nismës për lustracionin, PS ka ndryshuar

Si e ka shfrytëzuar politika prej ’90 çështjen e dosjeve të bashkëpunëtorëve të shtetit: Me të tilla dosje është sulmuar pishtari i Demokracisë Azem Hajdari, por edhe kryeredaktori i parë i RD Frrok Çupi. Me dosje është sulmuar Neritan Ceka e Perikli Teta, madje edhe Rustem Gjata... Si janë përdorur më parë komisionet “Mezini” e “Bezhani” për luftën politike



mendje dhe tani është ajo që inicon ligj të ri radikal për politikanët e përfshirë në dosjet bashkëpunuese me Sigurimin e Shtetit dhe zyrtarët e lartë të PPSH.

Për ironi, demokratët që inicuan ligjin më 2009 dhe e mbrojtën atë në Gjykatë Kushtetuese, tani janë kundër, përfshirë edhe zotin Meta dhe mbështetësit e tij politikë, aleatë me PD më 2009-2013.

LOJA ME DOSJET NISI NË FILLIMET E VITEVE 90

Sa herë vendi ndodhet në krizë besimi apo ka interesa elektorale politika rikthen në debat çështjen e hapjes së dosjeve dhe lustracionin në politikë. Rastet e para ndodhën në vitet 1992-1993 kur përmes akteve ligjore dhe administrative u bënë largime masive nga sistemi dhe administrata të zyrtarëve të përfshirë në listat e bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit ose në procese politike. Një numëri madh zyrtarësh, kryesisht eksponentë qëndrorë dhe lokalë të PS-së dhe aleatëve të saj, humbën postet në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe u akuzuan për bashkëpunëtorë të sigurimit. Akuzat ishin aq trendi sa çdo invidiv që kritikonte qeverinë e Berishës akuzohej prej tij dhe strukturave rreth tij si bashkëpunëtorë i Sigurimit. Akuzat ishin aq brutale dhe aq të keqpërdorura në funksion të nevojave politike të ditës sa qeverisja e Berishës akuzoi edhe njeriun simbol në PD, Azem Hajdari, për bashkëpunëtorë me policinë sekrete. Akuza të njëjta iu adresuan edhe drejtuesit të parë të RD-së Frrok Çupi, madje duke e akuzuar për bashkëpunëtorë të shërbimit sekret jugosllav, si dhe një numër i madh deputetësh e zyrtarësh të lartë. Disa prej akuzave qëndronin, disa jo, por me rëndësi, - në këtë periudhë nisi procesi i përdorimit të dosjeve sekrete si mjet presioni dhe shantazhi.

Për shembull, më 1995 me këtë akuzë u shkarkua një ministër, i cili emigroi në Itali për ti shpëtuar burgut, por të njëjtit që e shkarkuan dhe përdoren dosjen e tij të bashkëpunimit vite më vonë e promovuan aq shumë saqe për disa orë ishte kandidat pa rival për të qenë President i Republikës. Po ashtu, nëse për dy poetët e pushkatuar në Librazhd kishte dy autorë që ndihmuan Sigurimin e Shtetit duke hartuar dosje kritike ndaj krijimtarisë së tyre, e djathta sulmoi ashpër njërin prej denoncuesve për shkak se u bë deputete e të majtës, ndërkohë që heshti për tjetrin, madje e kishte atë kandidat të vetë PD-së për deputet më 1997.

Loja me dosjet u përdor ndjeshëm edhe nga e majta e viteve 90, kryesisht për të shantazhuar individët e saj që mbështesnin të djathtën ose ishin kritikë me kryetarin e partisë dhe linjën e saj zyrtare. Për shembull, kur një deputet i majtë shoqëroi në Kinë në delegacion ish Presidentin Berisha, ai u sulmua nga të vetët si bashkëpunëtor i Sigurimit. Vetë Ilir Meta është zgjedhur me votat e PS deputet, ministër, zv/kryeministër, kryetrar Kuvendi dhe President dhe pas 32 vitesh e njëjta parti e akuzon atë se ka qenë bashkëpunëtor i Sigurimit dhe madje edhe i SHIK të Gazidedes.

Pyetja është: nëse ai ka qenë bashkëpunëtor dhe siç dalin dëshmi në media, Nano dhe Rama e dinin, atëherë përse është promovuar prej tyre kaq gjatë dhe kaq lart në politikën shtetërore? Nga ana tjetër, pyetja për PD është, nëse ajo është për lustracionin dhe kundër Sigurimit, përse ajo promovoi në parlament dhe sidomos në krye të sistemit gjyqësor individë që kanë qënë drejtues e presekutorë të regjimit të kaluar?

1995-1996: KOMISIONI “MEZINI” LARGOI NGA POLITIKA MBI 200 KANDIDATË PËR DEPUTETË

Më 1995 PD nisi verifikimet e të gjithë kandidatëve të saj në degë për drejtues partie, bashkie apo deputetë, duke larguar një pjesë të madhe

të kandidatëve që rezultonin bashkëpunëtorë të Sigurimit. Vetëm në qytete të vogla si Pogradeci, Kukësi, Lezha, Kolonja, Delvina, Himara dhe Gramshi, ranë më shumë se 50% e kandidatëve për kryetarë e deputetë, për shkak të rekordeve të tyre me Sigurimin. Nga ana tjetër PD krijoi Komisionin "Mezini" për të kontrolluar dhe sulmuar partitë e opozitës, ku gjendeshin pjesa më e madhe e drejtuesve të PPSH dhe të Sigurimit të Shtetit. Më 5 mars 1996 u arrestuan dhe më pas u dënuan me burg Irakli Koçollari, ish kryetar i shërbimit sekret në vitet 1991-1992 si dhe ish Ministri i Brendshëm Vladimir Hysi, me akuzën e zhdukjes së dosjeve dhe dokumetacionit sekret. Me ligjin "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik" u skualifikuan 200 kandidatë, kryesisht të opozitës dhe se shumica e tyre figuronin në listat e sigurimit të shtetit. Nga lista e PD-së u skualifikuan vetëm 3 kandidatë, kurse nga PS emrat më të njohur, kryetari, zv.kryetari i parë dhe sekretari i Përgjithshëm, përkatësisht, Nano, Pëllumbi dhe Ruçi. Nga PSD lista e të skualifikuarve drejtohej nga kryetari i partisë, Gjinushi, kurse në PAD figurat e goditura me akuzën për bashkëpunim me policinë sekrete të Hoxhës ishin edhe tre ish deputetë të PD-së, Zogaj, Peshkëpia e Teta, dy prej të cilëve ishin ministra në Qeverinë e Stabilitetit. Nga numri total, vetëm 60 persona apeluan në Gjykatën e Lartë, dhe vetëm 9 prej tyre fituan të drejtën për t'u regjistruar në zgjedhje. Për të evituar problemet me kandidatët, Partia Socialiste zgjodhi tre kandidatë për çdo zonë elektorale, lëvizje që i mundësoi asaj regjistrimin në çdo zonë me kandidatë, pavarësisht vendimit të Komisionit. Në atë kohë, Këshilli i Europës, në raportin monitorues për Shqipërinë, në janar 1996, vlerësonte se përjashtimi kolektiv ishte i papranueshëm dhe se në dallim nga vende të tjera, ndalon edhe kandidimin e personave për në parlament. Në janar 1997, KE miratoi një rezolutë të ashpër në këtë pikë, duke kërkuar abrogimin e plotë të dy ligjeve ose amendimin e tyre për t'i përshtatur me parimet dhe standardet e Këshillit të Europës.

> Për ironi, demokratët që inicuan ligjin më 2009 dhe e mbrojtën atë në Gjykatë Kushtetuese, tani janë kundër, përfshirë edhe zotin Meta dhe mbështetësit e tij politikë, aleatë me PD më 2009-2013

1997-1998: PS HAKMERRET, RRËZON KREUN E GJYKATËS KUSHTETUESE

Pas rotacionit politik të vitit 1997, PS ndryshoi Komisionin "Mezini" duke zgjedhur në krye të tij avokatin e 2 prillit 1991, Nafiz Bezhani, i cili funksionoi vetëm dy vjet duke marrë dy vendime të rëndësishme, së pari inicoi shkarkimin e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese Rustem Gjata dhe e dyta, amnistoi shumicën e politikanëve të majtë të rrëzxuar nga Komisioni "Mezini". Pas këtyre dy vendimeve, PS nuk kishte më nevojë për të, dhe prej atëherë deri tek krijimi i AIDSSH Shqipëria nuk ka pasur më institucion përgjegjës për verifikimin e rekordeve të kandidatëve për deputetë e poste politike në raport me dosjet e Sigurimit të Shtetit. Ironikisht, Bezhani është dekoruar në shkurt 2022 nga presidenti Meta, ashtu si drejtuesve e AIDSSH Gentiana Sula fillimisht është zgjedhur po me mbështetjen e tij dhe rizgjedhur me mbështetjen e kryeministrit Rama.


LOJA ME PSEUDONIMET DHE REHABILITIMI I SIGURIMIT

Në mediat online vazhdimisht qarkullon një listë pseudonimesh, e cila për shkak të audiencës së lartë, është përdorur vazhdimisht edhe në retorikën dhe fjalimet politike në parlament. Lista përfshin politikanë të lartë dhe drejtues të mediave, individë me profil publik dhe drejtuesit kryesor të së djathtës, ndërkohë që tek e majta përfshin kryesisht ish drejtues të legjislaturave të mëparshme. Lista është abuzive dhe nuk ka asnjë provë që është reale. AIDSSH nuk ka kryer asnjëherë verifikime për të dhe edhe në raste kur publikisht janë dhënë dëshmi për ndonjë person, si psh, ish ministri i bujqësisë gjatë qeverisjes Berisha II, ai ka siguruar një vërtetim ndershmërie nga Autoriteti i Dosjeve.

Loja me pseudonimet është përdorur sidomos ndaj emrave më të njohur të politikës, përfshirë Berisha,Topalli, Ruçi, Meta, etj, duke "harruar" se disa prej tyre për shkak të angazhimit në PPSH me ligj nuk mund të ishin edhe bashkëpunëtorë të Sigurimit, apo se disa të tjerë nuk kanë pasur as moshën dhe as ndonjë dokument ilustrues për qenë në Sigurim. Nga ana tjetër është interesante fakti se drejtuesit kryesorë të Sigurimit, përfshirë Luan Pobratin drejtues për pjesën e inteligjencës dhe atë akademike, ish zv/ministri i brendshëm Mustafaraj si drejtues i Sigurimit, ish kreu i Sigurimit Irakli Koçollari, apo ish ministri i Brendshëm Ruçi, kanë pasur poste të larta shtetërore, përkatësisht dy prej tyre këshilltarë të posaçëm për kryeministrat Nano e Meta, dy të tjerët zv.ministra me Ramën apo kryetarë parlamenti. E njëjta statistikë vlen edhe për kuadrot në nivele më ulta drejtruese të Sigurimit, pothuajse të gjithë janë ricikluar dhe kanë marrë pozita drejtuese në parti politike, përfshirë në PD, LSI,



FAKSIMILE E VENDIMIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE PËR HAPJEN E DOSJEVE



Vendimi nr. 9, datë 23.03.2010
(V – 9/10)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Vladimir Kristo, Kryetar, Fehmi Abdiu, Kujtim Puto, Xhezair Zaganjori,Petrit Plloçi,Vitore Tusha, Sokol Sadushi, Admir Thanza, Sokol Berberi, anëtarë, me sekretare Blerina Çinari, në datë 07.05.2009 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.5/2 Akti, që i përket:

KËRKUES:

NJË GRUP DEPUTETËSH TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Shega Ligori dhe Arian Salati, me autorizim.
SHOQATA KOMBËTARE E PROKURORËVE, përfaqësuar nga Dashamir Kore, me autorizim.
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT, përfaqësuar nga Vasilika Hysi, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.
KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Viktor Gumi dhe Marsida Xhaferllari, me autorizim.
PRESIDENTI I REPUBLIKËS, në mungesë.
GJYKATA E LARTË, në mungesë.
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, në mungesë.
PROKURORI I PËRGJITHSHËM, në mungesë.

OBJEKTI:

a) Shpallja si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e Ligjit nr. 10034, datë 22.12.2008 "Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve";
b) Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në shpalljen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 7, 30, 34, 45, 71, 81, 87, 90, 92, 98, 107, 115, 116, 124, 127, 128, 131; 134, 135, 137, 138, 139, 140, 145, 147, 149 dhe 169 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE

përfaqësuesit e kërkuesve,një grup Shqipërisë dhe Komiteti Shoqata e Prokurorëve të Shqipërisë dhe Komiteti Shqipërisë (Kuvendi) dhe Këshillit të Ministrave "Amicus Curiae" të

VËREN:

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja "a", 134, germat "c" dhe "f" të Kushtetutës dhe nenit 72 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 10034, datë 22.12.2008 "Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve".
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit

B. Lidhur me pretendimin se rregullimet e ligjit për pastërtinë e figurës cenojnë garancitë ligjore për gjyqtarët, prokurorët dhe nëpunësit e administratës publike të parashikuara në disa ligje të përforcuara (ligje organike), të cilat kërkojnë për miratim një shumicë të cilësuar të deputetëve (neni 81/2 i Kushtetutës).

56. Kërkuesit pretendojnë

A. Lidhur me pretendimin se ligji për pastërtinë e figurës, duke përcaktuar një shkak të ri për ndërprerjen e mandatit të organeve të parashikuara nga Kushtetuta, cenon garancitë kushtetuese për mandatin e këtyre organeve.

41. Kërkuesit pretendojnë se disponita të caktuara të ligjit normojnë një shkak të ri

IV

PR, PS dhe deri te Aleanca Kuq e Zi.

Sipas statistikave të ISKK dhe grupeve civile që merren me memorien, më shumë se 70 drejtues të Sigurimit vijojnë të jenë aktiv dhe drejtues në sistemin e drejtësisë, në Policinë e Shtetit, në administratën publike dhe në vetë radhët e partive kryesore politike. Riciklimi i tyre është lexuar shpeshherë si pjesë e lojës dhe shantazhit përmes dosjeve, sidomos tek e djathta, ku ka statistikisht më shumë bashkëpunëtorë të Sigurimit sesa tek e majta, ku ndodhen më shumë ish drejtues të Sigurimit sesa bashkëpunëtorë.

AIDSH: NË DY ZGJEDHJET E FUNDIT, VETËM 5 KANDIDATË KISHIN DOSJE TË SIGURIMIT TË SHTETIT

Në një njoftim publik AIDSH ka bërë të ditur se asnjë nga partitë e mëdha, përfshirë PS, PD e LSI, nuk kanë dërguar listën e kandidatëve për verifikim as më 2017 dhe as më 2021. Më 2017 paraqitën kërkesë (përkatësisht PDIU, 144 emra dhe Aleanca Popullore për Drejtësi, 141 emra) për verifikim të kandidatëve për deputetë. Për zgjedhjet parlamentare të prillit 2021, vetëm katër subjekte politike (Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Partia Bindja Demokratike, Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Evropiane, (ABDE), Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë), gjithsej 61 kandidatë, morën në konsideratë këtë proces të rëndësishëm për integritetin e zgjedhjeve. Autoriteti i është drejtuar me shkresë të gjitha partive politike të regjistruara në zgjedhje (31 gjithsej) që, në zbatim të nenit 30 të ligjit 45/2015, i ndryshuar, të bashkëpunojnë me institucionin për përmbushjen e detyrave për verifikim të kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkish dhe kryetarë këshilli qarku. Për zgjedhjet parlamentare 2017 dhe 2021, nga Autoriteti u verifikuan 446 kandidatë për deputetë, ku 441 rezultuan pa dokumente dhe 5 kandidatë për deputetë figuruan bashkëpunëtorë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

Loja me pseudonimet është përdorur sidomos ndaj emrave më të njohur të politikës, përfshirë Berisha,Topalli, Ruçi, Meta, etj, duke "harruar" se disa prej tyre për shkak të angazhimit në PPSH me ligj nuk mund të ishin edhe bashkëpunëtorë të Sigurimit, apo se disa të tjerë nuk kanë pasur as moshën dhe as ndonjë dokument ilustrues për qenë në Sigurim

Evropa po përballet me krizën më të madhe energjetike: Në Zvicër, autoritetet u kërkojnë banorëve që të mbajnë QIRINJ nëpër shtëpia. Në Gjermani e Francë po rivendosen në punë çentralet e qymyrit. Hollanda ndërkohë ka hequr masën e kuotave të karbonit... Në Shqipëri, vazhdojmë harxhojmë energji si... "sheikët". Nuk i shkon në mendje kujt të kursejë, nga dritat e rrugëve, tek shtëpitë me kondicionerët hapur. Dimri do jetë i vështirë. Duhet të nxirrni nga bodrumët, gjeneratorët...



PO AFRON ERRËSIRA...

Nga FATOS ÇOÇOLI

576 mijë pensionistë kryefamiljarë, pensionistë me pension më të vogël se gjysma e pagës minimale dhe familje në nevojë, në sajë të Paketës së Rezistencës Sociale, nga 1 prilli 2022, morën për tre muaj kompensimin e çmimeve të rritura të shportës së mallrave ushqimore, me 3 mijë lekë në muaj. Ky kompensim, edhe pse fare i pamjaftueshëm, ndihmonte disi.

Më 1 korrik 2022, mbaroi afati tremujor i kompensimit të Paketës. Qeveria ende nuk e ka ripërtëritur këtë afat, edhe pse për gjashtëmujorin e parë janar-qershor 2022, ka të ardhura rekord shtesë në buxhet, me mbi 440 milionë euro. Çfarë e detyron qeverinë të mos ripërtërisë mbështetjen e paktë ndaj shtresave në nevojë? Po pret Armagedon-in energjitik?

Në historinë fetare, në librin "Dhjata e Re", termi "Armageddon" përshkruan betejën e fundit mes të Mirës dhe të Keqes, përpara Ditës së Gjykimit. Për qytetarët kudo në botë, ky

GRAFIK 1.

ENERGJIA ELEKTRIKE NË QIELL!

A. ÇMIMI MESATAR I ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREGJET NDËRKOMBËTARE:

Gusht 2021:	Gusht 2022:
78 euro/MWh	466 euro/MWh

RRITJE ME 6 HERË!

B. ÇMIMI I ENERGJISË PËR 7440 BIZNESE ME TENSION TË MESËM:

Dhjetor 2021:	Janar-maj 2022:
11.2 Lek/kWh	18.8 Lek/kWh

RRITJE ME 53% PËR VITIN 2022



term është më i njohur dhe i lidhur me filmin e suksesshëm fantastikoshkencor të Hollivudit "Armageddon" *(Armageddon ne hebraishten e vjeter do te thote "Mali Magido", vend betejash vendimtare, reference ne librin "Dhjata e Re")* të vitit 1998, që përshkruan një rrezik për shkatërrimin e planetit Tokë.

Më 23 korrik 2022, njëlloj si më 3 tetor 2021, kryeministri i vendit paralajmëroi qytetarët se qeveria mund të jetë e detyruar të zbatojë kufizime të furnizimit me energji elektrike. Qeveria nuk po arrin të blejë nga jashtë sasinë e plotë të energjisë. Nuk ka para mjaftueshëm, por nganjëherë edhe nuk gjen energji mjaftueshëm në tregje, sado i lartë çmimi. Po rrezikojmë Armagedonin, katastrofën.

RUSIA, KËMBËKRYQ MES PROBLEMIT

Nga 27 korriku 2022, Rusia ka ulur në mënyrë drastike, me katër të pestat, furnizimin e vendeve të Bashkimit Evropian me gaz natyror, përmes gazsjellësit Nord Stream 1, kanalit kryesor që ky vend i shet energji Evropës.

Përpara shpërthimit të luftës në Ukrainë nga agresioni rus, Evropa Perëndimore siguronte 40 përqind të nevojave të saj për energji nga gazi dhe nafta ruse. Tani gazi rus vjen në një të pestën e sasisë së tij, ndërsa furnizimi me naftë nga Rusia është ndërprerë për shumë shtete anëtare të BE-së, ose pakësuar ndjeshëm. Putin është ulur këmbëkryq mes problemit ekonomik madhor të Evropës dhe botës.

Mund të kuptohet qartë uria për gaz natyror dhe energji elektrike në tregun evropian. Kjo uri dhe burimet e kufizuara të ofertës, kanë bërë që tregjet ndërkombëtare të energjisë elektrike të paraqiten me çmime në rekorde historike të paprecedentë, në nivelet e mbi 400 Euro/MWh (megavat/orë).

PARASHIKIMET E ÇMIMEVE TË ENERGJISË

Më datën 12 gusht 2022, çmimi ndërkombëtar ishte 457 Euro/MWh në base-load (kohën bazë), ndërsa në peak-load (kohën e pikut) ishte 466 Euro/MWh.

Pritshmëria nga të gjithë ekspertët e tregut energjitik dhe nga vetë shtetet anëtare të BE-së, është që për muajt në vazhdim, çmimet do të vijojnë në këtë situatë të jashtëzakonshme.

Sipas bursës hungareze "Hupx", energjia për muajin shtator 2022 (energjia blihet më përpara me kontrata të quajtura "futures") e ka çmimin 492 Euro/MWh. Tremujori i fundit i vitit 2022 është në çmimin "futures" 552 Eur/MWh dhe viti 2023 po shitet aktualisht në vlerën 472 Euro/MWh.

Tek ne, çmimi i shitjes së energjisë për klientët fundorë familjarë dhe bizneset e vogla, të furnizuara nga ana e Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU), strukturës shtetërore që shet energjinë elektrike, ka mbetur i pandryshuar, në krahasim me çmimin përpara shpalljes së gjendjes së emergjencës. Është vetëm 9.5 lekë për kilovat/orë. Qeveria është e vendosur ta mbajë me çdo kusht këtë çmim. Ndërkohë, çmimi i energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare është rritur me afro gjashtë herë më shumë brenda një viti, nga 74 Euro/ MWh që ishte në gusht 2021.

NEVOJAT TONA PËR ENERGJI

Të dhënat për nevojë për energji për klientët fundorë (qytetarët dhe bizneset) për vitin 2022, janë si në tabelën më poshtë:

TABELA 1.

SASIA TOTALE E ENERGJISË ELEKTRIKE

ENERGJIA E KËRKUAR NGA FSHU PËR T'U SHITUR	ENERGJIA E PARASHIKUAR PËR T'U PRODHUAR NGA KESH	ENERGJIA PËR T'U BLERË NGA IMPORTI
5,403,282 MWh	3,530,340 MWh	1,556,142 MWh

Qeveria parashikoi në buxhetin e vitit 2022 një fond prej 20 miliardë lekësh për të përballuar krizën energjitike, ose 170 milionë euro. Mirëpo ky fond ka qenë parashikuar për një çmim mesatar blerje energjie rreth 200 Euro/MWh. Në kushtet aktuale, kur çmimi është pothuaje 500 Euro/MWh, duhen gjetur edhe mbi 20 miliardë lekë shtesë. Por edhe sikur me sakrifica, të mund të gjenden një pjesë e këtyre fondeve, në tregjet ndërkombetare, në Bursën hungareze për shembull, që është referenca më e afërt, mund të mos ketë energji elektrike për t'u shitur, aq sa do të kemi nevojat ne! Ndaj, e kemi domosdoshmëri të shikojmë burime alternative, për të siguruar energjinë që na mungon.

VEPRIMET NË AFATMESËM

Në tetor 2020, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit Ekonomik ndërmjet SHBA dhe Shqipërisë. Në të janë dy projekte shumë të rëndësishëm për rritjen e sigurisë energjetike në vend: projekti LNG (gaz i lëngshëm) dhe Skavica. Kësaj i shtohet tashmë edhe projekti i anijeve lundruese që po ofrohet nga kompania amerikane Excelerate.

Krahas këtyre dy investimeve themelore, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka realizuar dy ankande për zhvillim të burimeve fotovoltaike nga dielli, të fituara nga kompania franceze Voltalia. Ankandi i parë është investimi me vlerë 100 milionë euro në Karavasta, me kapacitet 140 MË, i cili filloi punimet në korrik 2022 dhe pritet të fillojë prodhimin në mesin e vitit 2023. Ankandi i dytë është investimi në Spitallë, me kapacitet 100 MË, ndërtimi i të cilit pritet të fillojë në fund të vitit 2022. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë po zhvillon një ankand për burime energjitike nga era me kapacitet deri në 150 MW. Ankandi ka përmbyllur fazën e parë në korrik 2022 dhe 16 kompani ndërkombëtare kanë paraqitur ofertat e tyre.

Të gjitha këto veprime, sado të mira dhe me perspektivë, nuk na e zgjidhin hallin urgjent që kemi tani, shpëtimin nga Armagedoni.

PËRGATITJET TONA PËR EMERGJENCËN ENERGJITIKE VJESHTË-DIMËR. DO MJAFTOJNË?

Kryesorja tani është gjetja e burimeve alternative dhe mekanizmave për të siguruar prodhim shtesë të energjisë elektrike. Për këtë, qeveria ka porositur dy anije lundruese Termocentrale (të quajtura barxhe), të cilat do të instalohen në Triport të Vlorës.

Ato kanë një kapacitet 114 MW dhe nga prodhimi i tyre pritet që të ketë një zbutje të konsiderueshme të nevojës për import. Është e vërtetë, janë teknologji e vjetëruar. Edhe ndotin ambientin. Por këto ditë i kanë kërkuar shtetet shumë më të fuqishme se ne dhe nuk i kanë marrë dot.

Sado të kushtojë prodhimi i megavat/orës prej tyre, kosto e këtij prodhimi është gjithnjë tre herë më e lirë se kosto e blerjes së megavat/orës nga importi. Nga ana tjetër, të tilla anije lundruese ka pak në botë. Ja përse shumë vende evropiane kanë kërkuar t'i kenë, por nuk kanë mundur të gjejnë.

Kjo masë e jashtëzakonshme e qeverisë shqiptare është në linjë me gjithë masat e përkohshme që po marrin shtetet anëtarë të Bashkimit Evropian dhe jo vetëm, për përballimin e krizës. Barxhet duhen sjellë sa më shpejt, se erdhi vjeshta, dhe pastaj dimri!



TOPTANI

kënaqësi
NË ÇDO COPËZ



SE VERA
SHIJOHET
NË **TOPTANI**

www.toptani.com.al

NUK KURSEJMË HIÇ!

Ndërkohë, në këto ditë me të nxehtë afrikan, kondicionerët bëjnë që energjia elektrike tek ne të harxhohet përditë gati po aq sa në ditët më të ftohta të janarit dhe shkurtit.

Vetëm në tre javët e para të korrikut, qeveria ka paguar afro 62 milionë euro për energjinë që na nevojitet dhe e siguron nga jashtë. Importojmë 2.5 milionë euro në ditë! Nëse vazhdojmë kështu, do na duhen edhe 560 milionë euro importe deri në fund të vitit! Nuk i kemi! Ja përse kryeministri paralajmëroi në korrik 2022, sikurse bëri më 3 tetor 2021.

Qeveria ka apeluar për të kursyer energji në vend, por ne nuk kemi kursyer hiç!

TABELA 2.

ENERGJIA ELEKTRIKE: SA HUMBIM DHE SA VIDHET

HUMBJET TEKNIKE:

Mesatarja e humbjeve teknike në botë: **» 5%**

Humbjet teknike në Shqipëri: **» 13.7%**

Humbim afro 3 herë më shumë se bota.
Diferenca janë 126 mln euro importe më shumë!

HUMBJET JO-TEKNIKE (VJEDHJET):

Mesatarja e humbjeve jo-teknike në botë: **» 2%**

Humbjet jo-teknike në Shqipëri: **» 6.3%**

Humbim mbi 3 herë më shumë se bota.
Diferenca janë 72 mln euro importe më shumë!




TABELA 3.

BORXHET E FRIKSHME TË SISTEMIT ENERGJITIK

BORXHI TOTAL QE OSHEE, KESH DHE OST KANË NDAJ NJERA-TJETRËS:

VITI 2017:	VITI 2019:	VITI 2021 (jo zyrtare)
617 milionë euro	910 euro/MWh	910 mbi 1 miliardë euro

Sipas ERE, në pesë vitet e fundit 2017-2021, borxhi i tre kompanive publike të energjisë (KESH, OSHEE dhe OST) u rrit me 67.4 përqind

Jo vetëm nuk kursejmë, por e harxhojmë energjinë elektrike si sheikët. Ndërkohë që jemi të krimbur e mbytur në borxhe nga brenda sistemit tonë energjitik.

Rreth 20 përqind e energjisë tek ne konsumohet pa kriter dhe mund të ishte kursyer tashmë. Kjo do të thotë se me papërgjegjshmërinë ekstreme, si vend "djegim kot" të paktën 240 milionë euro energji në vit. Duke filluar nga dritat nëpër rrugë, që në fundjavë punonjësi i bashkisë i "harron" t'i fikë, edhe kur drita e diellit hyn që në pesë të mëngjesit, dhe shpesh i lë ndezur deri në dhjetë të ditës! Duke vazhduar me kondicionerët nëpër zyrat e shtetit që ftohin dhoma e korridore edhe kur ato janë bosh!

Administrata jonë do të zërë mend nga keqtrajtimi i energjisë elektrike, vetëm kur pakujdesitë dhe papërgjegjësitë e saj të gjobiten nga sanksione shumë të rrepta, të vendosura me ligj. Ligji për energjinë duhet të ndryshojë urgjentisht, pasi nuk ka më kohë.

DO NISIM TË KURSEJMË?

Me apele dhe lutje për kursim kemi bërë një vrimë në ujë. Nëse duam që 120 milionë euro, në këtë kohë të kiametit, të mos i harxhojmë kot në këto gjashtë muajt e dytë të vitit, duhet të vendosim sanksionet dhe gjobat më të rrepta. Qeveria ka që nga janari 2014 që nuk e shton çmimin e kilovat/orit për qytetarët dhe bizneset e vogla. E ka mbajtur kokëfortë për afro nëntë vite vetëm 9.5 lekë për kilovat/orë. Për këtë ka paguar 485 milionë euro më shumë import energjie nga shtatori 2021, kur çmimet në bursat ndërkombëtare nisën të çmendeshin, e deri tani.



Por askush nga ne nuk kujtohet për këtë. Nëse do të veprohej ndryshe, llogaritej që nga gjysma e dytë e vitit të kaluar duhet të ishte trefishuar çmimi i energjisë për qytetarë dhe biznese, për të mbrojtur Kaskadën e Drinit. Ndërsa nga shtatori 2021 deri në qershor 2022 pagoi shtesë për biznese e qytetarë plot 736 milionë euro. Në periudhën tetor-dhjetor 2021, kur koha u ftoh, sikurse na ndodh gjithmonë, importuam. Edhe pse eksportuam më shumë energji gjatë vitit, për shkak se në tre muajt e fundit të vitit, çmimi i energjisë elektrike u rrit gati mbi gjashtëfish, shitëm energji vetëm 56 milionë euro dhe blemë, importuam 300 milionë euro vitin e kaluar. Po vijojmë të blejmë gjatë gjithë këtij viti. Viti 2022 është një vit shumë i thatë. Kemi patur maj të nxehtë, me temperatura si gushti dhe të nxehtit vazhdon akoma, edhe pse ra breshër më 12 gusht.

SI PO VEPROJNË VENDET E BE-SË?
QIRINJTË E ZVICRËS

Për të përballuar këtë situatë të jashtëzakonshme, secili vend anëtar i BE-së, por jo vetëm, po merr masat e veta të jashtëzakonshme.

Qeveria zvicerane ka paralajmëruar qytetarët e saj për furnizim problematik me energji elektrike gjatë dimrit. *"Qytetarët e Zvicrës duhet mbajnë parasysh që të kenë qirinj në shtëpi, në rast të ndërprerjeve të energjisë elektrike me zgjatje disa orë"*, deklaroi Werner Luginbühl, Kryetari i Entit Rregullator të Energjisë së Zvicrës (Elcom).



Werner Luginbühl, Kryetar i ELCOM

Në këtë vend të standartatit të lartë të jetesës, autoritetet po përgatiten tashmë për mungesën e energjisë elektrike që nga vjeshta, ndaj qytetarëve u thuhet se në dimër duhet të llogarisin ndërprerjet e energjisë elektrike.

Gjermania ka riaktivizuar disa impiante qymyri për përballimin e krizës energjetike. Franca rivendosur në punë centralin me qymyr në Saint Avold. Hollanda ka hequr përkohësisht kuotat e karbonit, me synim prodhimin nga centralet e qymyrit. Kështu po veprojnë edhe shtetet e tjera anëtare të BE-së.

"OLELE DRITAT!"

Mund të mos bjerë shi deri në fund të tetorit 2022 dhe të shohim sërish shi të dendur vetëm në nëntor. Ç'do të bëjmë? Mund edhe të kemi sërisht simfoni gjeneratorësh nëpër rrugët dhe pallatet tona, si në vitin e largët 2006. Katastrofa, Armagedoni biblik po afrohet.

Nëse nuk i vëmë mend kokës dhe të nisim të kursejmë këtë energjinë që si konsumatorë ende e paguajmë kaq lirë. Ka 11 mënyra të thjeshta për të kursyer deri në 25 përqind të energjisë që si konsumatorë paguajmë. Nga mos harrimi i derës hapur të frigoriferit, tek moslënia që të krijohen shtresa akulli brenda tij, apo tek moslarjet me lavatriçe kur nuk ke mbushur kazanin me rroba. A do të fillojmë ndonjëherë të mendojmë për shtetin si për shtëpinë tonë? Deri kur të nisim të mendojmë kështu, rrezikojmë që për këtë dimer të themi "Olele, na ikën dritat!".



FJALËT QË MARRIN RRUGËT...

E VËRTETA E KOSTOVE "TË FRYRA"

Nga FATOS ÇOÇOLI

Në ndërtimin e një segmenti rrugor, përcaktues i kostos së tij është standardi që vendoset në bazë të kategorisë së rrugës, ku çdo variant i saj ka të specifikuar zërat e kushteve teknike të projektimit dhe ndërtimit. Nëse nuk merr parasysh kategorinë e rrugës, të krahasosh koston për km të rrugës je praktikisht në ajër. Edhe po të kesh dy rrugë me kategori të njëjtë, prapë është shumë vështirë dhe mund të jesh sërisht duke rrahur ujët në tavan. Mund të jenë të dyja rrugë me dy korsi, por njëra ndodhet në fushë dhe me shtrat të gatshëm nga një gjurmë rruge e mëparshme, kurse tjetra është gjurmë e re dhe në terren tërësisht malor. Asnjë inxhinier ndërtimi që respekton veten, nuk e merr përsipër krahasimin, pasi e di që ka një mori parametrash që duhen vënë në balancë

Në një intervistë për revistën Newsbomb.al, kreu i ARRSH-së, Evis Berberi flet për projektet që kanë përfunduar dhe ato që janë akoma në proces. Vetëm në 6 muajt e 2022 janë ndërtuar 44.3 km, ndërkohë që shumë projekte janë duke vijuar. Në këtë intervistë të zgjeruar, Berberi sqaron edhe "fjalët", akuzat, thashethemet për kostot e rrugëve, fryrjen e tyre pa kriter sipas akuzuesve, dhe çfarë planesh do të ketë në vijim.



Në gati një vit, që drejtoni Autoritetin Rrugor Shqiptar, ka pasur shumë projekte të rëndësishme, disa vepra të dorëzuara tashmë, që mund t'i konsiderojmë suksese, por edhe shumë kritika dhe akuza në drejtim të institucionit që ju drejtoni...

Për ne në ARRSH më të rëndësishme janë veprat se sa fjalët. Dhe veprat janë ato që i çertifikojnë qytetarët, pasi lehtësojnë dhe përmirësojnë jetën e tyre të përditshme. Janë një sërë projektesh të rëndësishme infrastrukturore të përfunduara me sukses gjatë viteve të fundit, si rruga Tiranë – Elbasan, Kardhiq – Delvinë, bypasset e Fierit, Vlorës, Tepelenës dhe bypass perëndimor Shkodër, ndërkohë që po ecim me ritme të mira edhe në disa projekte të tjera siç janë e rruga e Arbrit, e hapur pjesërisht për kalimin e mjeteve, rruga Orikum – Dukat, Korçë – Ersekë Loti 2, tuneli i Llogarasë, rruga Palasë – Dhërmi etj.

Vetëm në gjysmën e dytë të vitit 2021 dhe 6-mujorit të parë të vitit 2022, periudhë gjatë së cilës unë kam nderin të drejtoj këtë institucion, kemi përfunduar gjithsej 20 kontrata, të cilat përfshijnë ndërtimin e 44.3 km rrugë të kategorive të ndryshme. Më lart unë përmenda vetëm rrugët me një impakt kombëtar, por ka edhe mjaft akse rrugore me impakt rajonal, siç janë segmentit rrugor Dukaj–Sinanaj, disa segmente të Unazës së Madhe Tiranë (Unaza Lindore, që është pjesa nga Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta te Sheshi Shqiponja), Rruga e Porto Romanos, si dhe rikonstruksioni dhe ndërtimi i disa urave si Ura e Dragotit, Ura e Leklit dhe Ura e Zemblakut.

Sigurisht që kur punon dhe ke rezultatet të mira, do të jesh edhe në qendër të kritikave, apo akuzave, që në gjykimin tim në shumë raste janë me sfond të pastër politik dhe që nuk lidhen me realitetin. ARRSH është e hapur dhe i vlerëson me mjaft seriozitet të gjitha kritikat apo denoncimet e bëra, pasi jemi të bindur se kjo gjë na ndihmon për të përmirësuar cilësinë e punës tonë dhe për të rritur performancën. E përsëris, se për fat të keq, në shumë raste konstatojmë se një pjesë e mirë e akuzave, janë të motivuara politikisht dhe nuk kanë për bazë realitetin e kontratave dhe punimeve në terren, por interpretime sipas përkatësisë apo favorizimit partiak të akuzuesve.

Ka disa rrugë, që nëse do të përdornim një shprehje të preferuar të Kryeministrit "kanë mbetur rrugëve", siç është rasti i rrugës së Arbrit, e cila është hapur pjesërisht për qarkullimin, por e papërfunduar dhe në disa pjesë siç është bypassi i Murrizit, e vështirë për t'u kaluar. Pse ndodh kjo dhe si do të zgjidhet?

Rruga e Arbrit është një rrugë që jo vetëm nuk ka mbetur rrugëve, por ka përmirësuar edhe rrugë rurale, si ajo e Bypass-it të Murrizit. Kjo rrugë për momentin po përdoret si rrugë aksesi për lidhjen e dy portaleve të Tunelit të Murrizit dhe ndoshta ngarkesa e momentit e bën të duket disi e vështirë, por në të ardhmen kur trafiku të kalojë përmes tunelit, kjo rrugë do të jetë një aks turistik, për të gjithë ata që do të duan të shijojnë bukuritë e zonës.

Ndërkohë që banorët e Burrelit, Klosit, Bulqizës dhe Dibrës tashmë po shfrytëzojnë në maksimum përgjysmimin e distancës me kryeqytetin, duke vlerësuar edhe avantazhet ekonomike që ka sjellë hapja e rrugës. Dibra tashmë është vetëm rreth 2 orë larg nga Tirana dhe po ta krahasosh me 5 orët që duheshin më parë të të arritur në këtë qytet, gjithkush e bën vete llogarinë e ndryshimit dhe përmirësimit të situatës.

Nga ana tjetër kemi hasur vështirësi në tunelin e Murrizit, por nuk e kemi lënë për asnjë moment pas dore, përkundrazi në brendësi të tij vijon pa ndërprerë puna, por është një punë specifike dhe e vështirë për shkak të situatave gjeologjike dhe planit të rrëshqitjes. Për këtë shkak ky tunel ka kërkuar shtesë kohe nga grafiku i parë i punimeve.

Cilat janë problematikat më të shpeshta që bëhen pengesë për ecurinë e projekteve tuaja? Lidhen ato me financimin, apo me kompanitë e ndërtimit të rrugëve?

Projektet gjatë zbatimit kanë problematika të ndryshme, por pothuajse në asnjë rast nuk lidhen me financimin. Kjo pasi vitet e fundit ka pasur një planifikim shumë më të mirë të investimeve për infrastrukturën rrugore dhe pagesat ndaj kompanive të ndërtimit të rrugëve kanë qenë në kohën e duhur, pa krijuar situata debish, por që në të njëjtën kohë edhe do të vështirësonin më tej punën e tyre.

Nëse do të më duhej të bëja një renditje, për aq sa është e mundur sipas rëndësisë, ndër problematikat kryesore do të veçoja:

- Ripunimin e projekteve për standartizimin e tyre, sipas Kushteve Teknike të Projektimit që janë sot në fuqi (Unaza e Madhe e Tiranës, Rruga Kardhiq-Delvinë, etj.);
- Ripunimin e projekteve, në kushtet e një zhvillimi të vrullshëm ekonomiko-social të zonave ku zbatohen këto projekte;
- Ripunimin e projekteve, për shkak të kushteve gjeologjike të pa-parashikuara;

Në pothuajse të gjitha veprat infrastrukturore një nga vështirësitë kryesore mbetet procesi tepër i ndërlikuar dhe me probleme sociale i shpronësimeve. Një pjesë e akseve rrugore në ndërtim (më kryesori, Unaza e Madhe e Tiranës) kalojnë në zona urbane informale dhe për pasojë, procesi i shpronësimit dhe lirimi i shesheve të ndërtimit vështirësohet shumë.

Nga ana tjetër, vitin e fundit, një vështirësi e shtuar është situata e krizës ndërkombëtare, që po shoqërohet me rritje të ndjeshme të çmimeve të elementëve bazë të ndërtimit, siç janë hekuri dhe çimentoja. Kjo rritje ndërkombëtare e çmimeve sigurisht që ka ndikuar edhe në rritjen e kostove të ndërtimit në vend.

Sa i përket kompanive private, të cilat zbatojnë projektet e ndërtimit të rrugëve, përgjithësisht me eksperiencën dhe me kapacitetet teknike që ato kanë, janë të afta që të zbatojnë çdo projekt infrastrukturor që marrin përsipër mbi baza kontraktuale.

Në shumë vepra infrastrukturore në ndërtim, gjatë viteve të fundit, janë kërkuar kontrata shtesë. Kaq të paparashikueshme janë punet që kryhen dhe problematikat që dalin, në krahasim me studimet e leverdisshmërisë së veprave që tenderoni?

Procedurat për kontrata shtesë nuk janë fenomen i viteve të fundit, por kanë lindur dhe do të vazhdojnë

TABELA 1 - TETË LOTET E "KARDHIQ – DELVINË"

NR.	LOTI	GJATËSIA	KOSTO
1	Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvine Loti 1 *(Filluar në Dhjetor 2007, Përfunduar Nëntor 2017)*	**7.150** km	**5.65** mln euro
2	Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvine Loti 2 *(Filluar në Dhjetor 2007, Përfunduar Dhjetor 2016)*	**4.399** km	**4.89** mln euro
3	Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 3 *(Filluar në Qershor 2008, Përfunduar Dhjetor 2016)*	**4.980** km	**3.86** mln euro
4	Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4 *(Filluar në Shtator 2018, Përfunduar Tetor 2021)*	**6.150** km	**28.2** mln euro
5	Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 5 *(Filluar në Shtator 2018, Përfunduar Tetor 2021). Gërmime të mëdha shoqëruar me vepra arti.* ***Dy ura***	**3.058** km	**21** mln euro
6	Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 6 *(Filluar në Shtator 2018, Përfunduar Dhjetor 2021). Vepra arti,* ***mure të larta mbajtëse***	**4.650** km	**28.4** mln euro
7	Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 7 *(Filluar në Gusht 2020, Do përfundojë më Gusht 2022).* ***Tuneli i Skërficës***	**2.630** km	**17.8** mln euro
8	Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 8 *(Filluar në Mars 2020, Përfundoi më qershor 2022).* ***Sinjalistikë, siguri rrugore dhe rivitalizim skarpatesh***		**16.5** mln euro



të dalin, sa herë që shfaqen problematika të ndryshme gjeologjike apo vështirësi të kushteve teknike. Të gjitha kontratat shtesë janë lidhur, bazuar në procedurat përkatëse të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ritheksoj se problematika kryesore lidhet me ripunimin e projekteve, për standardizimin e tyre, sipas Kushteve Teknike të Projektimit që janë sot në fuqi (Unaza e Madhe e Tiranës, Rruga Kardhiq-Delvinë, etj.). Rrjedhimisht, pas ripunimit të projekteve, në disa raste ka qenë e domosdoshme edhe shtesa e punimeve, për të përfunduar plotësisht projekti, sipas kushteve dhe standarteve që aplikohen sot.

Për shembull, për lotet 4, 5 dhe 6 të aksit rrugor Kardhiq-Delvinë, të cilat shtrihen në gjurmë tërësisht të re, në një terren të thyer malor, me gjeologji komplekse shoqëruar me vepra arti të mëdha dhe me masa inxhinierike të kushtueshme, shtesat e punimeve u realizuan, për shkak të fenomeneve gjeologjike të paparashikuara, të evidentuara sipas faktit gjatë kryerjes së punimeve. Po të mos kishim bërë këto punime shtesë, rruga nuk do të ishte realizuar. Sipas legjislacionit në fuqi, shtesat e kontratave negociohen me të njëjtin kontraktor, për arsye të pamundësisë të ndarjes së punimeve dhe kompleksitetit të radhës teknologjike të punëve.

Pse shumica e kostove tuaja dalin më të larta se rritja mesatare e kostove të ndërtimit në VKM-në përkatese të Manualeve të Kostove të Ndërtimit të vitit 2015, në krahasim me Manualin e vitit 2005? Flasim për kosto punimesh edhe përpara shpërthimit të luftës në Ukrainë...

Pavarësisht situatës aktuale në të cilën ndodhemi, ku kriza ekonomike në periudhën pas Covid-19 dhe pasojat që po sjell lufta në Ukrainë, kanë ndikuar në lëvizjen e indeksit të ndërtimit dhe kanë sjellë nevojën për rishikim, ne kemi kosto më të ulëta se manuali.

Theksoj se nuk mund të krahasohen kostot e ndërtimit kaq thjesht, si dy numra, kush është më i madh, ndërtimi sipas Manualit të vitit 2005 me ndërtimin e rrugëve sipas Manualit të vitit 2015.

Sipas Manualeve të çmimeve të ndërtimit të vitit 2005 dhe Manualeve të çmimeve të ndërtimit të vitit 2015 (me këto të fundit veprohet sot për llogaritjen e kostos-preventivave), rezulton se ka një diferencë të ndjeshme në çmimet e zërave të punimeve për ndërtimin e rrugëve, që lidhen me çmimet e materialeve kryesore, të fuqisë punëtore, të mjeteve dhe makinerive, etj.

Për shkak të luftës në Ukrainë, ARRSH do të kompensojë finaciarisht kontraktorët, sipas Aktit Normativ Nr.10, datë 18.05.2022. Ky Akt Normativ parashikon kompensimin financiar për materialet kryesore ndërtimore, si hekur, çimento, bitum, material plastik, etj., të cilat kanë pësuar rritje të ndjeshme në çmim. Besoj se rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare pas pandemisë dhe akoma më shumë tani me luftën në Ukrainë, është një fakt i njohur dhe i pranuar botërisht nga të gjithë dhe nuk mund të mendohet se është një pretendim i pambështetur i ARRSH, apo kontraktorëve të rrugëve.

Ka pasur pretendime për moszbatim të radhës kronologjike të dëmshpërblimit ndaj personave të shpronësuar në rrugët që ndërtoni, duke kryer likujdime jashtë radhe për persona të veçantë?

Zyrtarisht ARRSH nuk ka pasur ankesa për këtë çështje dhe në të gjitha rastet është

Problematika kryesore lidhet me ripunimin e projekteve, për standardizimin e tyre, sipas Kushteve Teknike të Projektimit që janë sot në fuqi (Unaza e Madhe e Tiranës, Rruga Kardhiq-Delvinë, etj.). Rrjedhimisht, pas ripunimit të projekteve, në disa raste ka qenë e domosdoshme edhe shtesa e punimeve, për të përfunduar plotësisht projekti, sipas kushteve dhe standardeve që aplikohen sot





Depozita Shije

Interesa të ëmbla

Interes rritës deri në
2% për depozitë në
Euro dhe **3.5%** në Lekë

Përfito interesin çdo vit

**Për çdo depozitë të re,
banka Credins do të dhurojë
për projektet në**

smile.al

CREDINS bank

www.bankacredins.com
Tel.: +355 4 53 53 000

Skano për më shumë



zbatuar ligji sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave në fuqi. Pagesat kryhen sipas datës përkatëse të dorëzimit të dokumentacionit në protokoll nga pronarët dhe sipas grafikut të punimeve.

Ajo çfarë ne kemi hasur shpesh është parregullsia e dokumentacionit të pronarëve. Kemi raste që kemi bërë shpronësimë te vitit 2008, pasi pronarët nuk kanë pasur dokumentacion të rregullt. Në momentin e dorëzimit të plotë të dosjes, ata kanë hyrë menjëherë në grafikun e fondit buxhetor të shpronësimeve.

Ndërkohë që kemi pasur edhe raste specifike, siç ishte ai i bypassit të Vlorës, ku banorët që duhej të shpronësoheshin, kishin aktet e marrjes në pronësi të tokës, por nuk i kishin regjistruar ato në Kadastër dhe kjo gjë pengonte ecurinë e projektit. Nga ana e tyre një pjesë e banorëve, për arsye të ndryshme nuk kishin mundësi për të aplikuar pranë Kadastrës dhe është dashur ndërhyrja e MIE dhe ARRSH, që të ndihmonin në mënyrë të drejtpërdrejtë banorët, duke i çuar dokumentet e tyre ne Kadastër dhe duke ndjekur hap pas hapi procedurën ligjore, deri në përfundim të saj, me regjistrimin e pronës dhe pastaj nisjen e procedurave për shpronësim.

Jeni sulmuar për rritje artificiale të kostos së studimeve të leverdisshmërisë. Gjithnjë, sipas jush, këto studime të prokuruara për rrugët që ndërtoni, kanë respektuar rregullat e një nikoqireje të mirë shtëpie?

Kostot, si për studimin dhe për të gjitha fazat që kërkon hartimi i një projekti për t'u hedhur në tenderim, mbështeten mbi një bazë ligjore, siç është VKM nr. 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim". Thënë ndryshe, çështja e kostove nuk është në dëshirën, apo vullnetin e drejtorit të ARRSH, apo punonjësve të këtij institucioni, por është ligji që i përcakton ato. Këto kosto nuk mund të rriten apo të ulen në mënyrë preferenciale, nga drejtori i radhës i ARRSH, por përcaktohen vetëm sipas Vendimit që citova më sipër.

Jeni i sigurt që nuk keni pasur asnjëherë, as edhe hijen e favorizimit të një subjekti privat pjesëmarrës në garë, në dëm të operatorëve të tjerë privat?

Procesi i prokurimit, në dukje i thjeshtë, kalon në disa faza dhe filtra ndërinstitucionalë. Edhe në këtë rast nuk është në dëshirën e drejtorit të ARRSH zhvillimi i procesit, por është i përcaktuar ligjërisht. Ky proces është tërësisht i hapur dhe i aksesueshëm për të gjithë operatorët, që garojnë apo jo.

Gjatë drejtimit tim në këtë institucion, faktet tregojnë se, për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik janë zbatuar parimet e transparencës edhe të barazisë në tendera. Kjo vërtetohet edhe nga fakti që gjatë pothuajse një viti ne kemi zhvilluar 59 procedura tenderimi dhe kemi pasur vetem 8 ankesa dhe kontestime nga garuesit. Edhe në rastet e ankesave që ju janë drejtuar në mënyrë zyrtare organeve kompetente për kontrollin e ligjshmërisë së procedurave tona, pas hetimeve dhe verifikimeve të bëra nuk është konstatuar

TABELA 2. FJALNAJA DHE E VËRTETA E RRUGËS KARDHIQ-DELVINË

NR.	FJALNAJA	E VËRTETA
1	Rruga u projektua me vetëm një lot në vitin 2008. Lotet u bënë 8 në vitin 2018	Projekti ishte gati në vitin 2007 dhe nisi zbatimin në vitin 2008 për tre lotet e para, dhe jo vetëm për një. Qeveria hapi fond vetëm 100 mijë lekë në vitin 2008!
2	Deri në vitin 2013 u punua mirë dhe u zbatuan kontratat fillestare	Në vitet 2008-2013 u realizua një vëllim punimesh prej 15 mln euro për tre lotet e para, ishin në fushë dhe me shtrat rruge të gatshëm. Qeveria pagoi vetëm 3.6 mln euro ose 24% të punimeve. Qeveria pas 2013 pagoi pjesën tjetër deri në vitin 2017, si shlyerje e detyrimeve të prapambetura
3	Kosto e rrugës u rrit në mënyrë abuzive në pesë vitet e fundit nga 60 mln euro në 108 mln euro.	Të pesë lotet e tjerë ishin në terren malor dhe me vepra arti. Në vitin 2015, u bë i detyrueshëm rishikimi i projektit për të përmbushur kërkesat ligjore, teknike dhe financiare. Lotet 4,5 dhe 6 shtrihen në gjurmë tërësisht të re, në një tërren të thyer malor, me gjeologji komplekse, shoqëruar me vepra arti të mëdha dhe me masa inxhinierike të kushtueshme.
4	U realizuan kontrata shtesë të panevojshme	Shtesat e punimeve për këto 3 lote u realizuan për shkak të fenomeneve gjeologjike të paparashikuara të evidentuara gjatë kryerjes së punimeve. Sipas ligjit, shtesat e kontratave negociohen me të njëjtin kontraktor për arsye të pamundësisë të ndarjes së punimeve dhe kompleksitetit të rradhës teknologjike të punëve.



asnjë shkelje ligjore. Konkretisht asnjë nga ankesat e bëra nuk ka fituar në Komisionin e Prokurimit Publik, çka vërteton ligjshmërinë e procedurave të organizuara nga ARRSH.

Cilat janë projektet e ardhshme, në planin afatshkurtër dhe afatgjatë të ARRSH?

Unaza e madhe Tiranës është një nga projektet më prioritare, që tashmë ka marrë udhë dhe punimet po ecin me ritme të mira. Loti 5 i kësaj Unaze është një kantier ku po punohet me intensitet, për të avancuar këtë projekt të shumëpritur për kryeqytetin. Në këtë lot, po kryhen gërmime në volume të konsiderueshme për hapjen e trasesë, si dhe janë vendosur deri më tani më shumë se 500 pilota. Gjurma e Unazës së Madhe të Tiranës po merr çdo ditë e më shumë formë. Do të vijojmë pa u ndalur, deri në përfundimin e plotë të kësaj vepre.

Çdo ditë punohet për mirëmbajtjen e akseve kombëtare duke rritur sigurinë rrugore. Per shembull, në Tepelenë-Gjirokastër është bërë pastrimi i kunetave, i kanaleve anësore dhe vegjetacionit, pa penguar qarkullimin e mjeteve.

Në Tunelin e Llogarasë po punohet me ritme të larta. Falë formacionit të favorshëm gjeologjik, deri në fund të korrikut u hap më shumë se gjysma e segmentit. Vijon puna rutinë për mirëmbajtjen e segmentit rrugor Tiranë-Durrës, aksit kryesor qarkullues të vendit. Që në orët e para të mëngjesit, për të mos penguar trafikun, pastrohen trafikndarëset, kunetat dhe vegjetacioni.

Projekte të reja me të cilat po punojmë janë disa, por do ju rendis më të rëndësishmit, që tashmë kanë marrë udhë dhe priten të implementohen së shpejti. Ato janë: Bypass-i i Tiranës, zgjerimi i aksit Elbasan- Qafë Thanë, Korridori Blu dhe aksi Berat-Ballaban. Të treja këto projekte do të ndikojnë jo vetëm në lehtësimin e trafikut, por edhe në zhvillimin e zonave që përreth tyre.

AKSE TË PËRFUNDUARA

- **NYJA E MILOTIT**
- Gjatësia 1,46 km
- Nisur në maj 2011
- Përfunduar në korrik 2018

- **TIRANË-ELBASAN**
- Gjatësia 27,2km
- Nisur në korrik 2011
- Përfunduar në mars 2019

- **LIN-POGRADEC**
- Gjatësia 17,36km
- Nisur në qershor 2011
- Përfunduar në tetor 2019

- **KORCË-ERSEKË** (loti 1)
- Gjatësia 17,5km
- Nisur në qeershor 2013
- Përfunduar në dhjetor 2018

- **ELBASAN-BANJË**
- Gjatësia 24,4km
- Nisur në gusht 2015
- Përfunduar në gusht 2020

- **VIADUKTET E RRUGËS SË KOMBIT**
- Gjatësia 1,344km
- Nisur në korrik 2007
- Përfunduar në gusht 2019

- **DELVINË-KARDHIQ**
- Gjatësia 33km
- Nisur në dhjetor 2007
- Përfunduar në korrik 2022

- **BYPASS TEPELENË**
- Gjatësia 2.3 km
- Nisur në korrik 2018
- Përfunduar në dhjetor 2020

- **BYPASS FIER**
- Gjatësia 22 km
- Nisur në nëntor 2018
- Përfunduar në mars 2022

- **BYPASS PERËNDIMOR SHKODËR**
- Nisur në nëntor 2011
- Përfunduar në janar 2022

- **DUKAJ- SINANAJ**
- Gjatësia 14.5 km
- Nisur në dhjetor 2020
- Përdunruar në tetor 2021

AKSE QË JANË NË PROCES NDËRTIMI

- **Unaza e madhe e Tiranës**
- **Bypass Vlorë**
- **Palasë - Dhërmi**
- **Korçë - Ersekë** Loti 2 (pjesa e parë)
- **Korçë - Ersekë** Loti 2 (pjesa e dytë)
- **Porto Romano - Durres,** Loti 3
- **Mbikalimi TEG dhe rrugët lidhese të tij**
- **Qukës-Qafë Plloçë**
- **Orikum-Dukat**
- **Tuneli i Llogarasë**
- **Maliq – Lozhan**
- **Levan – Vlorë,** rikonstruksion rruga e vjetër



Ideja e re

NGA RAIFFEISEN BANK

SCAN & GO, RADHËT E GJATA NË SUPERMARKETE MARRIN FUND



Kompani të mëdha financiare, si Global Finance, Euromoney, The Banker etj, i japin vazhdimisht çmime dhe mirënjohje Raiffeisen Bank, si një bankë pararojë në Shqipëri. Dhe gjithmonë, Banka vjen me ide inovative. Psh, nga celulari mund të kryesh pagesa të shumta kudo të jesh, pa shkuar në sportelin e bankës e të presësh radhët e gjata. Por ka edhe shumë shërbime, Leasing, Invest, shërbime që janë në lehtësim të jetës financiare të çdo familjeje shqiptare, me të ardhura të çfarëdoshme.

Por, ajo që sot vjen si një risi dhe që më parë nuk ka ndodhur në vend, ka të bëjë me aplikacionin e ri Scan&Go nga banka Raiffesien, i cili mund të përdoret nga klientët për blerje më të shpejta në supermarkete.

Fare thjeshtë, mjafton të shkarkosh në celularin tënd aplikacionin, shkon në raftet e supermarketit, zgjedh produktin, skanon bar-kodin, produktet i fut në shportë dhe ja… mbaroi gjithçka. Nuk do të presësh në radhë te kasierja për të kaluar çdo produkt tëndin. Të gjitha i ke të skanuara, e veç të mbetet të paguash, po nga aplikacioni.

Brunilda Toromani, Menaxhere Produkti/ Divizioni i Bankingut Ditor dhe Kartave, në një intervistë për revistën NEWSBOMB.AL, hedh dritë mbi këtë risi të bankës, duke treguar sfidën më të re me të cilën do të përballen në evolucionin e teknologjisë digjitale dhe në Shqipëri. Fundja, si kudo në botë, ku gjithçka, bëhet më e lehtë për konsumatorin.

E si do të menaxhohet gjithë kjo risi? Për këtë, le ti hedhim një sy sqarimeve të zonjës Toromani.

Scan&Go është një shërbim i ri i ofruar nga Raiffeisen Bank, i cili mundëson një mënyrë të re pagese "pa radhë" në supermarket. Ç'mund të na thoni më tepër për këtë produkt/funksionalitet, cilat janë veçoritë dhe si mund të përfitojnë klientët?

Scan&Go është një shërbim i ri, një aplikacion i prezantuar së fundmi nga banka jonë, ku klientët

Scan & Go është një tjetër pjesë e puzzle (mozaikut) që i shtohet të gjithë ofertës digjitale që Raiffeisen Bank sjell për klientët e saj. Ne do të vijojmë transformimin digjital të bankës me qëllim të sjellim një eksperiencë të shkëlqyer për klientët dhe prandaj kujdesemi të vijmë vazhdimisht me risi, me përmirësime të produkteve ekzistuese dhe zgjerim të gamës së zgjidhjeve digjitale

tanë të cilët shkarkojnë këtë aplikacin mund të kryejnë blerje pa radhë në një nga rrjetet kryesore të supermarketeve në Shqipëri.

Të gjithëve ne kur bëjmë pazare dhe i afrohemi kasës për të paguar na ndodh që të përballemi me radhë të gjata, ndërkohë që mendojmë sa shumë aktivitete të tjera na presin dhe sa kohë po humbasim.

Duke patur në fokus nevojat e klientit dhe orientimin që Raiffeisen Bank ka drejt digjitalizimit, lindi ideja për Scan&Go.

Scan&Go është aplikacioni i vetëm që ofron mundësinë të bërit pazar në dyqan nëpërmjet telefonit. Ndërsa lëvizin midis rafteve në dyqan, klientët mund të skanojnë bar-code të produkteve që dëshirojnë të blejnë direkt nga rafti, t'i vendosin në shportën e tyre dhe në fund të konfirmojnë blerjen nëpërmjet aplikacionit duke zgjedhur llogarinë për të kryer pagesën.

Të gjithë klientët që blejnë duke përdorur aplikacionin Scan&Go, lehtësisht mund të dalin nga dyqani nga kasa e dedikuar Raiffeisen duke shmangur pritjen dhe radhët.

Scan&Go ofrohet për të gjithë klientët Individë që kanë një llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank dhe që zotërojnë celulare smart Android ose iOS. Fillimisht, klientët duhet të shkarkojnë aplikacionin në AppStore ose Play Store, për të vijuar më tej me regjistrimin. Shkarkimi dhe përdorimi i aplikacionit Scan&Go është falas. Të dhënat që klientët tanë vendosin gjatë regjistrimit në aplikacion, sigurohen dhe mbrohen sipas standarteve europiane të sigurisë së informacionit dhe të privatësisë.

Çdo përdorues ka mundësi të shohë, të lexojë dhe pranojë kushtet e punës dhe formën e pëlqimit që i shfaqen gjatë proçesit të regjistrimit në aplikacion.

A do të shtrihet ky shërbim në markete të tjera? Në çfarë harku kohor?

Aktualisht klientët tanë mund të blejnë duke përdorur aplikacionin Scan&Go në supermarketet Interspar në TEG dhe QTU.

Qëllimi ynë është që këtë sherbim ta sjellim sa më afër klientëve, në dyqanet ku ata kryejnë blerje në përditshmëri, por edhe në dyqane të tjera që frekuentojnë rregullisht ku radha përbën një problem në menaxhimin sa më të mirë të kohës së tyre, për t'ju ofruar një përvojë të thjeshtë dhe pa stres.

Si e ndikon eksperiencën konsumatore Scan&Go dhe ku qëndron në mozaikun e ofertës digjitale të Raiffeisen Bank?

Scan&Go është një tjetër pjesë e mozaikut që i shtohet gamë së gjërë të zgjidhjeve digjitale që Raiffeisen Bank sjell për klientët e saj. Ne do të vijojmë transformimin digjital të bankës me qëllim që të sjellim një përvojë të shkëlqyer për klientët, ndaj dhe kujdesemi të vijmë vazhdimisht me risi, me përmirësime të produkteve ekzistuese dhe zgjerim të gamës së zgjidhjeve digjitale. Çdo risi dhe përmirësim që sjellim në treg bëhet duke patur në qendër nevojat dhe kërkesat e klientit dhe rreth klientit zhvillohen të gjitha shërbimet, duke e bërë sa më të thjeshtë rrugëtimin e tij me bankën tonë.

Sipas jush, a është gati tregu jonë të mirëpresë dhe të përdorë këto risi digjitale dhe a perqafohen lehtësisht nga klientët?

Përvoja po na tregon që tregu ynë po i përqafon risitë në fushën digjitale, si në aktivitetin bankar, ashtu edhe në fusha të tjera të cilat po zhvillohen paralelisht. Ne, si bankë pararojë në sherbime digjitale, kemi edhe përgjegjësi të shtuar përsa i takon pjesës së edukimit financiar duke qene se shumë shërbime i prezantojmë për herë të parë në treg. Scan&Go është një mënyrë alternative për të kryer blerjet në dyqan dhe si çdo zgjidhje e re do të





kërkojë kohën e nevojshme për t'u njohur nga tregu shqiptar dhe për t'u përqafuar. Jemi të sigurtë që pasi klientët të kryejnë blerjen e parë me Scan&Go, do e rekomandojnë dhe tek të njohurit e tyre.

Cilat janë sfidat që hasni në implemetimin e këtyre produkteve të reja?

Ashtu si e përmenda më lart, duke qenë se shpesh here ne jemi të parët në prezantimin e produkteve të reja financiare digjitale, sfida kryesore është njohja e tregut me format e reja të pagesave apo shërbimeve dhe edukimi tyre financiar. Një sfidë tjetër është që këto shërbime të reja kërkojnë një klient të orientuar drejt teknologjisë dhe dashamirës ndaj përqafimit të këtyre qasjeve të reja.

Më tepër mund të përmend që në rastin e Scan&Go, ndryshe nga zgjidhjet e tjera digjitale, është thelbësor bashkëpunimi i ngushtë me tregtarët si një proçes i vazhdueshëm. Rrjedhimisht, suksesi i Scan&Go qëndron pas një bashkëpunimi të ngushtë midis Bankës dhe tregtarëve në promovimin e tij, në pranimin si një mënyrë e volitshme për klientin për të kryer blerjet në dyqan dhe në përmirësimin e aplikacionit për të qenë gjithmonë në hapat e ndyshimeve teknologjike në treg.

Zepa Natyral, dashuri me shijim të parë!

ZEPA NATYRAL

Shija që Duam


Dëshira, vendosmëria dhe pasioni për të sjell në treg produkte 100 % natyrale, krijoi brandin Zepa Natyral, pjesë e kompanisë A G S sh.p.k. Zepa Natyral është në tregun shqiptar që prej vitit 2017, duke numëruar kështu më shumë se 50 produkte të qumështit të dhisë e lopës, si edhe lëngje frutash 100 % natyrale, të prodhuara sipas standarteve të Bashkimit Europian për sigurinë ushqimore. Fillimisht, sfida jonë ka qenë besueshmëria e konsumatorit. Tashmë, me një mision të përmbushur, ju garantojmë ruajtjen e standartit dhe sigurinë e shëndetit tuaj!

Zepa Natyral është certifikuar nga TUV Austria për:
-sistemin e administrimit të cilësisë,
-menaxhimin e sigurisë ushqimore,
-plotësimin e kritereve në administrimin e mjedisit
-si edhe plotësimin e kritereve për të menaxhuar sigurinë në punë.

Kontrollet analitike, kimike dhe mikrobiologjike të përditshme të qumështit, në të gjitha fazat e zinxhirit të prodhimit, i garantojë konsumatorit produkte të cilësisë së lartë.



Ushqyes, i shijshëm, me një ekuiliber të shkëlqyer të sheqernave.





Lëreni veten të pushtoheni nga fantazia, teksa shijoni kremozitetin e kosit Zepa Natyral.

Rezultat i një përzjerje përbërësish të shëndetshëm dhe natyral, siç është kosi i lopës 100% natyral shqiptar me të cilin prodhohet.





web: zepanatyral.al
zepanatyral

Mob: +355 69 60 44 707
Email: info@zepanatyral.al

BLI ONLINE



NË RRËNOJAT E SHTËPISË SË NEXHMIJE HOXHËS:

NGA MODA SOVJETIKE, TEK FTESAT E DASMËS

Nga ISA MYZYRAJ

Jetoi një shekull të vrullshëm por vitet e pleqërisë dhe ditët e fundit i kaloi në një shtëpi diku te ish rrethrrotullimi i sheshit "Shqiponja". Bëhet fjalë për të venë e diktatorit, Nexhmije Hoxhën.

Si gazetar qëmtues detajesh, me aparatin në dorë, kur filloi gjithë historia e prishjeve të banesave për t'i hapur rrugë unazës së madhe, godina dykatëshe e quajtur ish-pularia, do të shembej.

Nexhmija kishte vdekur që në shkurt 2020 dhe nuk ishte gjallë të shihte sesi do ta lëviznin prapë prej banesës së saj. Kishte jetuar në kohën e luftës në shtëpi të thjeshta prej qerpiçi, siç ajo dhe diktatori shpesh tregonin në intervista.

Mandej, paslufta, apo regjimi komunist, u dha luksin e të jetuarit në të vetmin oaz qetësie, rehatie e bukurie, në Bllok, një vend në qendër të Tiranës që edhe sot ruan të njëjtin emër.

Në vëmendjen dhe raportimet e gazetarëve që e kishin vizituar në shtëpinë e saj, kishte përshkrime të hollësishme sesi po jetonte në vitet e demokracisë e veja e diktatorit. Një oborr i madh ku parkoheshin makinat, e më pas merrje shkallët për në katin e dytë, ku sapo hyje në korridor, shihje një derë të madhe druri, që ta hapte kushdo nga personat që ishte në shtëpi. Tavolina të thjesha e karrige plastike, korridoret të lyera me bojë të bardhë plastike dhe po një derë e bardhë që të çonte te dhoma e Nexhmijes. Aty, kishte jetuar për kohë të gjatë derisa vdiq zonja Hoxha, me kujtimet e saj, fotografitë, librat e Enverit, dhe një kolltuk i madh ngjyrë gri ku i pëlqente të ulej.

Kjo ishte panorama e banesës pak a shumë ku kishte jetuar. Por, kur projekti i Unazës së Re u kristalizua, dhe godinës dykatëshe do t'i vihej rruspa, kurioziteti për të parë se ç'kishte ndodhur në atë godinë, më shtyu të shkoja dhe të fotografoja ç'kishte mbetur. Ishte data 16 qershor 2020.

Nuk ishte e thjeshtë të hyje brenda rrethimit, sidomos me protestat e Astirit. T'u tregoje punëtoreve se ishe një gazetar, nuk kishte asnjë lloj përfitimi. Ndaj, e fsheha identitetin duke u treguar se po punoja për një OJQ. Kështu, munda të hyj edhe njëherë, për herë të fundit, në shtëpinë ku kishte jetuar Nexhmije Hoxha, përpara se godina të shembej.

Duhet thënë se pjesa më e madhe e orendive që kishin qenë aty ishin marrë. Nxitimi për t'i hequr shumë shpejt, më riktheu në memorje skenat e filmave shqiptarë që kam parë për familjen që i internonin, ku makina të ushtrisë merrnin familjet dhe plaçkat e tyre përgjatë natës. Përveç objekteve të domosdoshme, shumë të tjera binin rrugës, pa u kushtuar vëmendje. Shkrimtarë të shumtë





E veja e diktatorit jetoi 20 vjet tek ish-pularia, godina dykatëshe që ishte afër rrethrrotullimit "Shqiponja" para se të shembej për t'i hapur rrugë ndërtimit të Unazës së Madhe. Nexhmija vdiq në shkurt 2020, ndërsa godina u shemb katër muaj më vonë, në 16 qershor. Por çfarë kishte në shtëpinë e saj pak orë para se fadromat të kthenin gjithçka në inerte? Gazetari Isa Myzyraj sjell për Newsbomb.al foto ekskluzive, të pabotuara më parë nga pamja e brendshme e shtëpisë...

shqiptarë, por edhe ish-funksionarë të komunizmit të internuar që kanë shkruar memuarët e tyre, kanë përshkruar skena të tilla.

Kështu ishte gjendja te shtëpia e Nexhmijes. Me vete mendova: si nuk jetoi edhe një vit të përjetonte internimin e ri.

Dhe ja tek jemi. Fotot që po përcjell eksklluzivisht në revistën Newsbomb.al, janë të fundit që janë bërë në atë vend ku jetoi e veja e diktatorit.

Më kanë bërë përshtypje shumë detaje që i fiksova mirë dhe do të jap për to nga një shpjegim të shkurtër, për mënyrën sesi u bënë dhe kontekstin e kohës.

1. ARKIVA E GAZETAVE, IKËN BASHKË ME INERTET

Nexhmije Hoxha duket se ishte tepër e kujdesshme ndaj çdo artikulli gazetash që kishin shkruar për ish-bashkëshortin e saj, pasi qindra gazeta ishin të futura në thasë të mëdhenj, e në kartonë. Asgjë nuk mbijetoi nga arkiva e mbajtur me kujdes nga e veja e diktatorit. Thasët e kutitë e gazetave pak orë më vonë, u bashkuan me inertet e godinës dy-katëshe që po shembej, për t'u hedhur në ndonjë vend si mbeturina.

E njihja atë shtëpi, pasi më herët kur Nexhmije Hoxha ishte gjallë kisha qenë aty, por asnjëherë si atë ditë nuk kisha hyrë vjedhurazi, dhe duke kaluar ferrat dhe avllinë e madhe për të mos u vërejtur.

Pak para shembjes, e dija që aty mund të gjendeshin dëshmi të historisë, sepse pikërisht në atë dhomë kishte jetuar për më shumë se dy dekada personi që ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e këtij vendi, kishte lënë gjurmët e errëta të një kohe që brezi im nuk e pa, por sigurisht që duhet të njihet me të, përmes të gjitha formave, edhe duke vizituar për herë të fundit shtëpinë ku kishte jetuar e veja e diktatorit.

Në dhomën ku Nexhmija jetonte, mbi një copë komedine qëndronte libri i saj me kujtime i titulluar "Jeta ime me Enverin", i bëra shpejt një foto, dhe e futa në çantë, jo vetëm për ta lexuar, por për ta pasur si kujtim të asaj dite kur djersët kishin mbuluar rrobat e mija, ca nga vapa, ca nga sikleti që hyra vjedhurazi, e ca nga frika se mos dikush me gjente aty dhe ca nga kërshëria për të mësuar sa më shumë për atë që mendonte Nexhmije Hoxha.

Dhjetëra fotografi të Enverit, Nexhmijes, dhjetëra CD e kaseta të vjetëra, rroba, libra e faqe gazetash ishin shpërndarë nëpër dy dhomat e shtëpisë së familjes Hoxha, ndërsa veç librit mora edhe disa gazeta të tjera, dhe disa libra, aq sa më zuri çanta që e mbaja në shpinë, tek e fundit ato do të kthehesin në mbeturina pak orë më vonë, kur fadromat e IKMT-së do ta shembnin atë.





FOTOT DËSHMI

FOTOGRAFIA E TRETË

Ika me vrap, duke kaluar avllinë nga ana e pasme e shtëpisë, ndërsa për herë të parë më ngjante vetja si hajdut, por edhe isha i lumtur sepse isha ndoshta personi i fundit që mori disa dëshmi nga shtëpia e Nexhmije Hoxhës. Pasi shtëpia u shemb, dhe inertet u larguan nuk mund të qëndroja pa shkuar edhe një herë për të parë se ç'bëhej në vendin ku ishte ajo shtëpi?

Së bashku me një tjetër kolege shkuam përsëri atje, dhe para na dolën punonjësit e firmës së ndërtimit që po bënin Unazën e Madhe, dhe nuk n'a lanë të afroheshim për disa minuta. Unë kisha aparatin në dorë, dhe ata direkt dyshuan mos jemi gazetarë. I gënjyem duke u thënë që jo vetëm nuk jemi gazetarë, por jemi nga një organizatë që s'ka lidhje me gazetarinë, ndërsa pak nga



pak, ata po bindeshin, dhe na lejuan të shkonim në vendin ku më herët ishte pallati ku jetonte familja Hoxha.

Gjithçka ishte rrafshuar, e pastruar me kujdes, por përsëri kishin mbetur dëshmi.

Në mes disa gjetheve të thara ndodhej një gazetë e datës 4 nëntor 1999, ndërsa në ballinë të saj kishte foton e Enver Hoxhës, dhe si titull kryesor "55-vjetori i Partisë Komuniste të Shqipërisë".



Një palë të brendshme grash ngjyrë rozë, kishin mbetur nën një masiv dheu, gjysma brenda e gjysma jashtë, i bëra një foto dhe lëviza nga aty.

> E njihja atë shtëpi, pasi më herët kur Nexhmije Hoxha ishte gjallë kisha qenë aty, por asnjëherë si atë ditë nuk kisha hyrë vjedhurazi, dhe duke kaluar ferrat dhe avllinë e madhe për të mos u vërejtur



Nën një tjetër masiv dheu kishte mbetur një botim i Komitetit Qëndror të Partisë me titull kryesor "Rruga e Partisë" por që ishte dëmtuar, dhe e mora me kujdes duke e pastruar me duar, dhe e futa në një qese e pastaj e mora edhe atë me vete.



Nën në tjetër vend ndodheshin dhjetëra ftesa dasmash që datonin prej 1984 – 1985 -1986 dhe që drejtoheshin kryesisht ish-zëvendëskryeministrit të asaj kohe Spiro Kolekës, dhe familjes së tij.



Si dëshmi kishin mbetur edhe dhjetëra revista në gjuhën franceze dhe që i kushtoheshin grave sovjetike të viteve 1950, dhe aty u ndala një moment duke menduar se teksa Shqipëria jetonte vitet më të vështira nën një izolim tërësor, të mëdhenjtë e partisë lexonin për jetën e vajzave e grave sovjetike, çfarë paradoksi!



Nën një tjetër cep të pallatit, ndodhej edhe një fotografi që nuk kishte lidhje me komunizmin, as me teorinë marksiste-leniniste, as me jetën 40-vjeçare në Shqipëri. Ishte një fotografi e Shën Mërisë, dhe pyetja e menjëhershme drejtuar vetes ishte se: Ç'kërkonte një fotografi e Shën Mërisë, në shtëpinë e gruas së Enver Hoxhës, të cilët i shpallën luftë të hapur fesë, dhe Shqipërinë e bënë vend ateist me ligj?



Përgjigja sigurisht që ishte e vështirë, e pamundur madje, nuk ka përgjigje për këtë pyetje, veç hamendësime.

Akoma më tej, sapo marr atë fotografi për ta future në çantë, poshtë saj gjej një varëse me shumë mundësi e llojit serm, dhe me një medalion të vogël e të mbyllur, marr varësen, hap medalionin dhe përsëri një fotografi e vogël e Shën Mërisë.


Pyetja ishte e njëjta, por meqënëse përgjigja mungonte, thjesht marr atë varëse e fus në xhep dhe më vonë blej edhe një pako të vogël për ta rujtur, se di për sa kohë!

U larguam nga ai vend, me shumë pikëpyetje, por edhe me disa gjëra të marra me vete, këto nuk ishin të vjedhura si në rastin e parë në fakt, ishin të gjetura mes disa rrënojave që do i mbulonte betoni.

I mora për të treguar, për të treguar histori, për të treguar orët e fundit të shtëpisë së Nexhmije Hoxhës, sepse historitë janë për tu treguar, dhe për të diskutuar për to.


NEWS BOMB .al

FOTOT DËSHMI





Turizmi në Shqipërinë komuniste. Cilat ishin hotelet më të mira, menuja për të huajt dhe destinacionet “më të bukura” që mund të prezantonte vendi ynë?



KUR TË HUAJT ‘VDISNIN’ URIE DHE LIRIE...

Nga LUELA MYFTARI

Në Shqipërinë komuniste ishte e vështirë të bëje pushime. E vështirë ta njihje këtë vend që kishte mbyllur kufijtë për botën perëndimore, që në fakt ishte thuajse e gjithë bota. Vendi ynë për thuajse 50 vite ishte një joshje njëlloj si ishulli i Leonardo di Caprios në filmin “The beach”. Por ndryshe nga sa aty vetëm destinacioni është “i ndaluar, i kontrolluar, i fshehtë”, Shqipëria e asaj kohe kishte edhe kushtet e veta. Veshja, ushqimi, aparati fotografik, interesi për vendet fetare, pyetjet, por edhe mendimet duhet të ishin të kuruara sipas realizmit socialist. Sepse që në momentin kur do të duhej të mendoje për pushime në Shqipëri, duhet të dije si të mendoje si socialist i kohës dhe të merrje të mirëqenë që udhërrëfyesi yt ishte një komunist që do të raportonte gjithçka te Nëna Parti. Në fund të fundit, në shtëpitë tona është mirë që nëna t’i dijë të gjitha. E për ata që jetonin këtu ishte krejtësisht normale kjo situatë, sa kohë kishin pranuar, që fletën e lejes së pushime, KU dhe KUR ta përcaktonte ndërmarrja ku punoje. Nëse nuk të takonte të pushoje, nuk do të pushoje.

PUSHIMET PARA 100 VITESH

Nga dokumentet e zbuluara deri më tani, gjatë periudhës së Mbretërisë, Shqipëria numëronte 13 qendra pushimesh dhe 27 hotele. Qyteti i Durrësit në këtë periudhë kishte një vëmendje të veçantë. Thuajse njihej si një ndër zonat më të kërkuara dhe më të preferuara, ndaj edhe mbreti Zog kërkoi që të punohej e të merrte formë një projekt urbanistik që parashikonte ndërtimin e vilave të pushimit. Përgjatë kësaj periudhe, në dy portet kryesore të vendit në Durrës dhe në Vlorë ankoroheshin rregullisht anije me turistë të huaj.



PUSHIMET PARA 70 VITESH


Më ardhjen në pushtet të regjimit komunist, situata e turizmit ndryshon. Iniciativat private për zonat turistike shtetëzohen. Thujase të gjitha zonat e mira u morën nga shteti dhe vetëm qeveritarët mund të pushonin aty. Asnjë tjetër nuk lejohej. Edhe në zonat ku pushonin klasat punëtore nisi rrethimi me tela me gjemba dhe për të pushuar në disa vende nevojitej autorizim. Për udhëheqjen e lartë atë kohë u ndërtuan shtëpi pushimi të veçanta, ndërsa për familjarët ishin programuar kampet e pushimit. Jo të gjithë punëtorët arrinin të siguronin një fletë kampi. Për familjet shqiptare, pushimet ishin të mundimshme pasi për 15 ditë pushime, familja duhej të merrte gjithçka me vete, peshqirë, çarçafë, tenxhere, tiganë e madje edhe kapakët e tyre. Sigurisht, këtu nuk bëhej fjalë që një person i klasës punëtore të dilte jashtë shtetit. Të paktën jo deri pas lidhjes me Bashkimin Sovjetik. Për të huajt ishte një sfidë më vete qoftë edhe për të hyrë në Shqipëri.

PUSHIMET PARA 50 VITEVE

Komunistët shqiptarë fillimisht as që e mendonin turizmin si një e mirë që mund t'i vinte ekonomisë apo vetë shqiptarëve. Për ta ajo nuk kishte asnjë përfitim, përveçse si pjesë që mund t'i shërbente propagndës së asaj kohe. Kur diktatori Hoxha nisi të mendonte për lidhjet e Shqipërisë me vendet e tjera lindore, nisi edhe vala e të menduarit për turizmin. Në këtë periudhë, qeveria fillon të kuptojë se ka interes nga të huajt për ta njohur këtë vend komunist që është mbyllur brenda kufijve të vet, rrethuar po prapë nga popullsia e vet. Këto kohë rusët, çekët, polakët, gjermanët dhe hungarezët ishin grupet më të shpeshta të turistëve, ose së paku ato që mund të lejoheshin në Shqipëri, sigurisht të kontrolluar. Pas, këtij këndvështirmi të ri për turizmin, që shënohet diku nga mesi i viteve 50, kur edhe krijohet Ndërmarrja Shtetnore e Turizmit, nis edhe vala e parë e turistëve shqiptarë që kishin fatin të pushonin në vendet e rreshtuara në bllokun sovjetik.

LETRA

Në korrik të vitit 1955, një gjimnazist nga Republika Federale Gjermane dërgon një letër në gjuhën shqipe, dretjuar Qeverisë së Shqipërisë për të programuar një udhëtim që do të ndodhë një vit më vonë, në verën e vitit 1956.



NDËRMARRJA SHTETNORE E TURIZMIT

Kjo ndërmarrje u krijua në vitin 1955. Selinë qendrore e kishte në Tiranë dhe njihej me emrin "ALBTURIST". Investimi fillestar për këtë ndërmarrje nga ana e Këshillit të Ministrave është 5 milion lekë, shifër që do të shërbejë për autobusë, mjete transporti dhe mjete të tjera që nevojiten për të pritur grupet e turistëve të huaj. Në pikën shtatë të dokumentit që shënon edhe krijimin e kësaj ndërmarrjeje vendosen edhe pikat ku mund të vendoset turistët e huaj, si hotel "Dajti" dhe "Vjosa" në Tiranë, Hotel Butrinti në Sarandë, hotel "Adriatik" në Vlorë, hotel "Vollga" në Durrës, hotel "Parku" në Shkodër dhe "Turizmi" në Pogradec.

SI TË HYSH NË SHQIPËRI?

Në korrik të vitit 1955, një gjimnazist nga Republika Federale Gjermane dërgon një letër në gjuhën shqipe, dretjuar Qeverisë së Shqipërisë për të programuar një udhëtim që do të ndodhë një it më vonë, në verën e vitit 1956. I riu nga Gjermania kërkon të vijë në Shqipëri bashkë me 5 moshatarë të tij, por nuk ka asnjë informacion për këtë vend, as se ku janë pikat kufitare, as çfarë monedhe përdoret dhe as nëse lejohet të lëvizësh lirshëm apo të fotografosh. E ndonëse ne kemi vetëm letrën e gjermanit që kërkon një leje udhëtimi, pa përgjigjen e qeverisë, nga të tjerë dokumente të ruajtura në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave gjejmë të tjera "perla të turizmit sipas komunizmit".

NË SHËRBIM TË TURISTIT TË HUAJ

Jo të gjithë kishin mundësi të bënin pushime në vende diktatoriale. Turistët në atë kohë e konsideronin veten me fat që e vizitonin vendin tonë, sepse ishte thuajse e pamundur të kërkoje që të ishe dëshmitar i mënyrës se si jetonin njerëzit nën regjimin komunist. Shqipëria ishte vend i ndaluar, njësoj siç është Korea e Veriut në ditët e sotme, ose Kuba dy dekada më parë. Ndaj edhe shteti përgatitej që vizitorët që vinin nga shtetet e huaja të priteshin sa më mirë dhe të njiheshin me histori mbresëlënëse të këtyre anëve. Viza turistike nuk zgjaste më shumë se një muaj, ndaj në pak ditë ose javë duhet të prezantohej Shqipëria në anën e saj më të mirë. Turistët kishin autobusin e dedikuar për të mbërritur në Shqipëri, ishin të shoqëruar nga një guidë, i cili dinte shumë mirë të gjithë historinë dhe ishin udhëzuar mjaft mirë se çfarë të tregonin dhe


çfarë nuk duhet t'i rrëfenin një të huaji. Guidat në atë kohë dinin disa gjuhë të huaja, fillimisht Rusisht, Frengjisht, Gjermanisht dhe Anglisht.

LUKSI QË PAGUHET SHTRENJTË

Hotel Dajti ishte hoteli më modern në atë kohë dhe mbase hoteli më i përgjuar. Në të vendoseshin të gjitha delegacionet politike që mund të vinin nga vendet komuniste. Bëhej fjalë për të gjithë ata që vinin për vizita zyrtare në Shqipërinë komuniste, apo për ata të huaj që kishinftuar vetë familjet e Bllokut qeveritar. Mendohet se vetëm aty mund të luhej muzikë e huaj. Prindërit tanë e dinë shumë mirë se vetëm ndonjë mbrëmje pot ë kaloje aty dëgjoheshin tinguj që më herët ishte e pamundur t'i dëgjoje përmes Radio Tiranës. Këngë të reja, me tekste të huaja dhe sigurisht edhe ndonjë mbrëmje vallëzimi. Hotel "Dajti" që ishte ndërtuar nga italianët, sot njihet gjerësisht si vendi që dëgjohej muzikë të huaj, por që përgjohej nga çdo cep. Ndaj nga një pikëpamje konsiderohej si hoteli ku gjeje lirinë, por ku liria paguhej shtrenjtë nëse pije pak më shumë se ç'të mbante goja.

KUR IZOLOHET SËRISH SHQIPËRIA...

Viti 1961 dikton ndër të tjera edhe në shkëmbimet turistike. Prishja e marrëdhënieve të Shqipërisë me bllokun sovjetik sjell jo vetëm ndërprerjen e turistëve shqiptarë që shkonin drejt vendeve të bllokut lindor por edhe turistët e vendeve lindore që duhej të vinin drejt Shqipërisë. Shqipëria nis të izolohet dhe numri i turistëve bëhet gjithnjë e më i paktë. Në këtë kohë, sa ishin përfunduar edhe investimet e para të hoteleve, të ndërtuara sipas frymës sovjetike, por që do të mund të përdoreshin vetëm nga shqiptarët që merritonin fletë kapmi.



Patatja, edhe bukë edhe gjellë

Edhe nëse ishe përgatitur për gjithçka të mundshme, kishte gjithnjë diçka të re, të papritur apo të parashikuar nga partia për axhendën e pushimeve të një të huaji. Kontrolli dhe rregullat nisnin sapo të vije këmbët në kufijtë zyrtarë të vendit, e disa herë edhe paraprakisht me letra.

KUJDES VESHJEN!

Një nga rregullat kishte të bënte me paraqitjen e një turisti. Vizitorët ishin të paralajmëruar me rregullat e veshjes kryesisht para se të mbërrinin në Shqipëri ose menjëherë sa mbërrinin. Ata kishin rënë dakord që më herët se nuk duhet të dilnin nëpër rrugë me funde të shkurtra, pantallona të shkurtra apo rroba banjo a ndonjë fustan të tejdukshëm, me tyl apo qëndisje që tregonte pjesë të trupit. Dekolteja duhet të kishte masë, sigurisht. Edhe pantallonat nuk mund të jenë të ngushta sepse bien në sy format e trupit. Sepse të gjitha këto ishin të ndaluara. Fustanet e turisteve janë në gjatësi normale deri te gjuri ose poshtë gjurit dhe i vetmi akesor që mund të lejohej ishte kapeja, syzet dhe çanta e dorës. Duhet të kurseheshe me vendosjen e bizhuterive.

NUK MUND TË FOTOGRAFOSH GJITHÇKA!

Të gjitha pajisjet elektronike që kishin marrë me vete shtetasit e huaj që do të kalonin pushime në

Bli Online

albsig.al



ALBSIG


PJESË E
KASTRATI GROUP


Shqipëri, duhet t'i deklaronin në pikat kufitare, si në Portin e Durrësit po ashtu edhe në Aeroport. Madje marka e aparatit fotografik apo një radioje të vogël mbahej shënim njëlloj si të ishte edhe emri i turistit vetë.


Një histori interesante është ajo e turistes nga Franca, e cila ka mbërritur në Shqipëri nga data 4 gusht dhe ka qëndruar për 15 ditë në vendin tonë si pjesë e vizitës së organizuar nga Shoqata e Miqësisë Francë-Shqipëri). Pasi ka mbërritur në Francë ajo i dërgon një letër Ndërmarrjes së Turizmit ku I ankohet për Bashkimin. Bashkimi është shoqëruesi i grupit, një zotëri nga Elbasani që përveçse ndryshon axhendën e vizitave, i rrëmben edhe kameran. Francezja ankohet se pas vizitës në uzinën e plastikës, ajo kishte nevojë të pushonte, por aty Bashkimi e ka gjetur të vetme, i ka marrë kamerën, të cilën ia ka kthyer një ditë më vonë me filmin e ndryshuar. Por, ajo që e fyen më shumë turisten është fjala e shoqëruesit, që e konsideron atë spiune. Ndaj dhe ajo e mbyll letrën me fjalët: "Nëse i prisni të huajt me kaq mosbesim më mirë do ish të mbyllnit kufijtë".

MENUJA E PËRCAKTUAR

Shumica e ankesave që vijnë të regjistruara nga turistët e huaj ka të bëjë me ushqimin. Sasia që i vendoset në pjata është e pamjaftueshme sipas tyre. Thuajse asnjë nga të huajt nuk ankohet për pastërtinë apo cilësisnë e ushqimit, por për menunë e varfër dhe për sasinë e pakët që i ofrohet. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave teksa kërkoj për ankesat e turistëve të huaj gje mes tyre edhe menunë e dy ditëve që i ofrohet, që i "jepet" në fakt, disa turistëve që vijnë nga Gjermania. Mëngjesi i parë është vezë, kos, bukë e vogël dhe kafe ose çaj, dreka është supë dhe 150 gramë mish ose peshk, komposto ose fruta, ndërsa darka sultjash, pak gjalpë, djath dhe çaj me limon. Në këtë menu ajo që më bie në shy është që sa herë gjen fjalën bukë, e gjien gjithnjë të shoqëruar me fjalën pa, ose me fjalën përcaktuesin "e vogël". Por, pastaj mendoj që është krejtësisht normale në një vend ku patatja është edhe bukë, edhe gjellë.







Një histori interesante është ajo e turistes nga Franca, e cila ka mbërritur në Shqipëri nga data 4 gusht dhe ka qëndruar për 15 ditë në vendin tonë si pjesë e vizitës së organizuar nga Shoqata e Miqësisë Francë-Shqipëri). Pasi ka mbërritur në Francë ajo i dërgon një letër Ndërmarrjes së Turizmit ku I ankohet për Bashkimin. Bashkimi është shoqëruesi i grupit, një zotëri nga Elbasani që përveçse ndryshon axhendën e vizitave, i rrëmben edhe kameran. Francezja ankohet se pas vizitës në uzinën e plastikës, ajo kishte nevojë të pushonte, por aty Bashkimi e ka gjetur të vetme, i ka marrë kamerën, të cilën ia ka kthyer një ditë më vonë me filmin e ndryshuar.



TURIST NË SHQIPËRINË E VITEVE ‘80

Cilat ishin destinacionet që mund të vizitoje në Shqipërinë e para 3 dekadave? Çfarë të sugjeronte Ndërmarrja Shtetnore Turistike të vizitoje?

Një vizitë në Uzinën e Plastikës të enjten e një tjetër në Uzinën e Telit të shtunës janë disa nga alternativat për të njohur më shumë Shqipërinë. Dhe këto nuk janë anektoda nga vendi ynë që përjetonte thuajse grahmat e fundit të diktaturës. Por, këto janë histori të vërteta të zbuluar nga dokumentet e mbajtura asokohe e që sot përmes arkivave na rrëfejnë Shqipërinë turistike që u prezantohej të huajve.

17 persona kanë udhëtuar nga Gjermania drejt Shqipërisë më 3 mars të vitit 1980, por nga e hëna e parë e marsit të këtij viti e deri të enjten nuk kanë asnjë program përveçse të pushojnë. Dita e parë është në Tiranë për shkak se mbërritja është në Rinas. Dita e dytë dhe e tretë në Durrës, por vetëm ditën e katërt është programuar që 17 persona nga Shoqata Gjermane të vizitojnë Uzinën e Plastikës dhe Muzeumin e Luftës. Dita e pestë i dedikohet një tjetër Muzeumi, atij ateistit në Shkodër. Kuptohet nuk ka qenë Shkodra e sotme, ku xhamia dhe kisha janë përballë njëra –tjetrës dhe mes tyre qëndron hirplotë imazhi i Nënë Terezës.

Nga i gjithë programi prej dy javë pushimesh në Shqipëri, vështirë të gjesh diçka interesante. Uzina e Telit, vërtet nuk ekziston më, por ehde sikur ta mendosh, asgjë joshëse nuk duket. Sigurisht edhe të vizitosh zonën e shkatërruar nga Tërmeti në Shkodër nuk ka diçka argëtuese, por kush e di si e ka menduar Partia kur hartonte një plan ku vizitat bëheshin në klinika dentare apo në kopshtet e fëmijëve.

Programi është po aq pak serioz kur lexon se ekskursioni në Tiranë, do të finalizohet me një shfaqje artistike të shkollës 8-vjeçare “Shqipëria sot”, shoqëruar sigurisht me shënimin, “nëqoftëse do të ketë” program artistik.

E si mund të jetë joshëse Shqipëria sot kur për 50 vite nuk ka kuptuar dot pasurinë që ka? Asnjë vizitë në Butrint, shumë pak përmendet Apollonia, asnjë fjalë për qytetin antik të Durrësit, asnjë amfiteatër, asnjë grimë kulturë, përkundrejt muzeumeve të luftës apo atyre kundër besimeve fetare. Uzina telash e plastike, fabrika të prodhimit të brekëve në Korçë, trikotazhe për të cilat qëndrohej në rradhë, të gjitha me sjellje shembullore të punëtorëve. Ky ishte imazhi që duhej të krijonin të huajt. Asgjë për Dhërmiun, Jalën, gjirin e Gramës, Thethin apo Lumin e Shalës a të tjera mrekulli të Shqipërisë. Mrekullia që i prezantonim dikur të huajve ishte lumturia e punëtorit në Metalurgjik, buzëqeshja e shoqes së punës në fabrikën e qelqit, apo duart e forta të përgjegjësit në Uzinën e Telit.



“MBRETI I BETONIT”

MILIONAT E FITUARA NGA TENDERAT PUBLIKË

Nga FLAMUR VEZAJ

Pasditja e 22 qershorit të vitit 2006 në qytetin Torreviejas të Provincës së Alicantes në juglindje të Spanjës, ishte e qetë dhe me shumë turistë. Atë pasdite skuadra e krimit të organizuar e policisë spanjolle ndërhyri në një servis makinash, që po vëzhgohej prej kohësh. Dyshohej se përdorej nga trafikantët e drogës.

Aty, policia i ndërpreu punën e ndërrimit të gomës një shtetasi shqiptar dhe ndihmësve të tij. Sylejman Shkalla së bashku me një tjetër shqiptar sapo kishin nxjerr disa pako të mbështjella me natriban, që rezultuan më vonë se ishte heroinë. Punonin të pashqetësuar në çmontimin e gomave për të nxjerrë prej tyre kutitë.

Sipas asaj që shkruhej në vendimin e gjykatës, Policia gjeti dhe sekuestroi 100 pako të mbështjella me natriban. Rezultoi se peshonin 50 kilogram e 610 gram e 88 miligram. Sipas vendimit të arrestimit në flagrancë të shtetasve shqiptarë, cilësia e pastërtisë së sasisë së heroinës ishte mbi 48 % dhe kapte vlerën e tregut rreth 2 milion dollarë.

Në operacionin që vëzhgohej prej disa kohësh u arrestuan edhe shqiptarë të tjerë: Julian Deblini alias Julian Gjoka, Arjan Ndoci dhe Dritan Gradica.

Në të njejtën kohë u ndërhy edhe në një rezidencë banimi, e quajtur Torre La Matta ku u arrestua shtetasi Carlos Alberto i cili kishte zbritur në territorin spanjoll dy ditë para arrestimit. Në vendim thuhet se Carlos Alberto më vonë u identifikua si shtetasi shqiptar me identitetin Pashuk Gjini. Në dosjen e ardhur nga Spanja ai njihet edhe me disa emra të tjerë: Pashk Rrapi, Pashuk Gjini, Pashuk Maloku apo me emrin e njohur në Shqipëri tashmë si Anton Gjinaj, të cilin e kishte ndërruar pas kthimit nga Spanja. Ai dyshohej se ishte pronari i drogës së trafikuar nga Holanda në drejtim të Spanjës, drogë të cilën do ta shpërndanin shqiptarët e tjerë, bashkëpunëtorë të tij.

Anton Gjinaj qëndroi vetëm disa muaj në burg, duke shfrytëzuar hapësirat ligjore të lirimit me kusht dhe më pas u largua nga Spanja për t’u kthyer në Shqipëri, ku ndërroi identitetin dhe qëndroi i lirë për t’u marrë me biznes.

Kjo është një histori si nëpër filma, sepse, ndërsa hesapet në Spanjë mbeten të hapura, në Shqipëri, punët dhe milionat shkonin për mrekulli.

BIZNESI QË LULËZONTE ME DISA FIRMA

Në çdo cep të Tiranës, hapeshin gropa të mëdha. Punohej me ritme të shpejta. Me dhjetëra betoniere lëviznin mes morisë së makinave duke rënduar jo pak trafikun. Fundja, shqiptarët ishin mësuar me këtë situatë.

Shumica e betoniereve mbanin të njëjtën logo: “ALESIO 2014”. Furnizonin me lëndë të parë thuajse çdo gropë që hapej në kryeqytet për të ngritur shumëkatësisht që thuajse të zënë frymën.

Kompania u krijua në maj të vitit 2014 nga Anton Gjinaj, një emër i panjohur për median deri në vitin 2021. Në regjistrin e biznesit në kohën e hapjes, kjo kompani kishte një kapital themeltar 100 mijë lekësh, por që rrugës u ndryshua kapitali bashkë me veprimtarinë e kompanisë. Jo vetëm biznesi i ndërtimit, por u shtuan edhe ata të transportit, turizmit dhe

Një histori si nëpër filma ajo e Anton Gjinajt ndaj të cilit SPAK pak javë më parë vuri sekuestron e pasurive. I dënuar në Spanjë për trafikimin e 50 kileve heroinë, Gjinaj, "u fsheh" në Shqipëri, ku krijoi kompaninë "Alesio 2014". Opencorporates.al, zbulon me dhjetëra kontrata e miliona euro të përfituara nga buxheti i shtetit, nën hundën e SPAK, prokurorisë e policisë shqiptare si dhe drejtorisë së pastrimit të parave. Por si arriti Pashk Gjini alias Anton Gjinaj të ishte biznesmeni më i fuqishëm në Shqipëri?

të gjitha që parashikohet në legjislacionin shqiptarë në fushën e tregtisë apo ndërtimit. Bashkë me këto ndryshime, u shtuan edhe pronat e pasuritë.

Pas investimeve nëpër Shqipëri në kompani e biznese të ndryshme të ndërtimit dhe jo vetëm, Anton Gjinaj me kompaninë e tij "ALESIO 2014", vetëm një vit pas hapjes së saj, në vitin 2015 blen aksione në kompanin "FAROLB ALABASTER", e licencuar për prodhimin e gipseve dhe pjesëve të saj me seli në Kavajë. Këto aksione, Gjinaj i bleu nga një shtetas italian, të cilit në vitin 2018 ia blen edhe aksionet e mbetura, duke e kthyer "ALESIO 2014" me 74.99 % të portofolit të aksioneve. Pjesa tjetër e mbetur prej 25 % të aksioneve i përket Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Jemi në momentin kur Gjinaj, një i dënuar për trafik droge në Spanjë me 8 vjet e 9 muaj burg, bëhet aksioner në një kompani me shtetin shqiptar. Kompania merret me prodhimin dhe eksportin e gips-alabaster me seli në Mengaj të Kavajës.

Pas këtij suksesi të kompanisë "ALESIO 2014", pronari Gjinaj në shtator 2020 blen shoqërinë "Garden Residence Turdiu" një kompleks shumëkatësh te Fusha e Aviacionit. Kjo blerje, bëhet së bashku me lejën e ndërtimit dhe të gjithë punimet e kryera me një vlerë totale prej 1 milion eurosh që shoqërohet në faturat e kontratës së blerjes.

Eshtë e paqartë sesi gjithë këto transaksione shitjeje e blerjeje kryheshin nën hundën e strukturave të posaçme të krimit të organizuar në Shqipëri apo të Drejtorisë së Pastrimit të Parave.

Veç këtyre kompanive, në QKB figuron që familja e Anton Gjinajt ka në pronësi edhe tre kompani të tjera: "DEIZI-M" sh.p.k, shoqërinë "POLYSTYRENE (EPS) MANUFACTURER" sh.p.k dhe "XYZ 08" sh.p.k me objekte të ndryshme në treg. Këto shoqëri, janë hapur dhe menaxhuar nga vet Anton Gjinaj, ose vajza e tij.


E ndërsa biznesi rritej, askush nuk kishte dëgjuar në media për të kaluarën e Anton Gjinaj, por vetëm për suksesin e papritur të kompanisë "ALESIO 2014" në tregun shqiptar.

TENDERA PUBLIKË, GOSTIA E RE E "ALESIO 2014"

Në vitin 2018, kompania "ALESIO 2014" kishte filluar të aktivizohej në projekte publike, duke përfituar fonde nga tenderat.

Bashkia e parë që filloi të shpallë fitues në tenderat për asfaltimin e rrugëve, është ajo e Krujës. Nga viti 2018 deri në mesin e vitit 2019 Bashkia Krujë e ka shpallur fituese kompaninë "ALESIO 2014" në 8 tendera publikë, duke i kaluar në llogari të kompanisë së tij shuma të mëdha parash.

Pasojat e tërmetit të nëntorit të 2019 në Shqipëri, sollën mirëqenie dhe rritje të aktivitetit të kompanisë "Alesio 2014". E konsoliduar në treg dhe me njohje të mëdha deri 'lart', kompania filloi të shapllej fituese




EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	J629038441
2. Data e Regjistrimit	08/11/1994
3. Emri i Subjektit	FORALB ALABASTER
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	04/11/1994
6. Kohëzgjatja	Nga: 04/11/199425.05.2027
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Kavaje KAVAJE Mengaj
8. Kapitali	30.980.000.00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	30.980.00
9. Objekti i aktivitetit	Prodhimin dhe ekspertimin e gips-alabaster dhe prodhimeve të tyre, tregtimi i tyre per vend dhe eksport. Nxjerrja, shfrytëzimi dhe përpunimi i produkteve të alabastres, gips dhe materialeve të tjera jo metalore, prodhimin e tregtimin me pakicë e shumicë te prodhimeve të ndryshme prej druri,eksport-import te materialeve te ndryshme, artikujve te ndryshem industriale, etj. Veprimtari dhe shërbime të tjera te lejuara nga ligji.
10. Administratori et	Anton Gjinaj
10.1 Afati i emërimit	Nga: 29/01/2019 Deri: 29/01/2024
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore	
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	
12. Ortakët	ALESIO - 2014
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 23.232,000,00
12.2 Numri i pjesëve	23.232,00
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	74,99
12.4 Komente (nëse ka)	Natyre:
13. Ortakët	

Ministria e Ekonomisë, Tregtise dhe Energjetikes



Rezultate permbledhese

Institucion Buxhetor	Perfitues	Dega Thesari	Vlera trasaksioneve	Nr i trasaksioneve	Limiti I vleres	Intervali (sipas date regjistrimi)	Intervali (sipas date ekzekutimi)
	ALESIO - 2014	All	346,878.00	3	All	=>	=>

Rezultate permbledhese sipas kritereve te perzgjedhura

Autoritet Prokurues	Operator Ekonomik Kontraktues	Nr. i tenderave te shpallur	Fondi limit per tenderat e shpallur (ne Leke, pa TVSH	Nr. i tenderave te shpallur me fitues	Fondi limit per tenderat e shpallur me fitues (ne Leke, pa TVSH	Vlera totale e shpallur fituese (ne Leke, pa TVSH
Qeverisja Vendore Tiranë	ALESIO - 2014	12	443,936,192	12	443,936,192	862,665,006

Rezultate permbledhese sipas kritereve te perzgjedhura

Nr. i Institucioneve tenderuese	Operator Ekonomik Kontraktues	Nr. i tenderave te shpallur	Fondi limit per tenderat e shpallur (ne Leke, pa TVSH	Nr. i tenderave te shpallur me fitues	Fondi limit per tenderat e shpallur me fitues (ne Leke, pa TVSH	Vlera totale e shpallur fituese (ne Leke, pa TVSH
3	ALESIO - 2014	12	443,936,192	12	443,936,192	417,611,357

Lista e tenderave

Autoriteti Prokurues sipas Njesise se Qeverisjes Vendore	Objekti i Tenderit	Vlera / Fondi Limit Leke	Statusi i Tenderit	Operator Ekonomik Kontraktues	Vlera fituese
Qeverisja Vendore Lezhë	"Shembja e njesive individuale te banimit te pabanueshme, te demtuara nga termeti i dates 26.11.2019 dhe transportimi i materialeve te dala nga shembja e tyre". (Programi i Rindertimit)	76,433,448	Lidhur Kontrata	ALESIO - 2014	75467882.2
Qeverisja Vendore Krujë	Ndertimi i Atrium Center Thumana, Njesia Administrative Thumane Bashkia Kruje, ne kuader te procesit te rindertimit. (Programi i Rindertimit).	220,210,898	Lidhur Kontrata	ALESIO - 2014	220,079,942.0
Qeverisja Vendore Durrës	Bierje asfalt per rruge urbane dhe rurale 2021	34,999,000	Lidhur Kontrata	ALESIO - 2014	34,981,280.00
Qeverisja Vendore Durrës	Bierje Asfalti per Rruge Urbane dhe Rurale 2020	33,332,967	Lidhur Kontrata	ALESIO - 2014	24,275,450.00
Qeverisja Vendore Krujë	Sistemim Asfaltim i rruges nga Superstrada -Varrezat Katolike Derven , Njesia Thumane	16,130,417	Lidhur Kontrata	ALESIO - 2014	11,953,624.00
Qeverisja Vendore Krujë	Ndertim KUZ , Sistemim Asfaltim i rrugeve 'Xhafa' e 'Doku' Njesia Fushe Kruje .	5,729,618	Lidhur Kontrata	ALESIO - 2014	4,434,705.00
Qeverisja Vendore Krujë	Sistemim-asfaltim i rruges Abazi dhe ndriçim rrugor i rrugeve Çlirimi dhe 5 Maji, prane Unazes se Vogel, Nj.A.Fushe Kruje	2,593,911	Lidhur Kontrata	ALESIO - 2014	2,437,020.00
Qeverisja Vendore Krujë	Shtese punimesh per objektin Sistemim Asfaltim i Rrugës Hyrese Thumane.	4,614,978	Lidhur Kontrata +Shtesë	ALESIO - 2014	4614978.33333333
Qeverisja Vendore Krujë	Sistemim Asfaltim i Rruges Hyrese Thumane	24,658,175	Lidhur Kontrata	ALESIO - 2014	23,176,180.00
Qeverisja Vendore Krujë	Sistemim-asfaltim i rruges Mazhe e Mu...	7,119,453	Lidhur Kontrata	ALESIO - 2014	4,341,366.00
Qeverisja Vendore Krujë	"Sistemi...	11,339,014	Lidhur Kontrata	ALESIO - 2014	6,999,544.00
		6,774,313	Lidhur Kontrata	ALESIO - 2014	4,849,385.00

FAKSIMILE TË TENDERAVE PUBLIKË FITUAR NGA KOMPANIA "ALESIO 2014" SIPAS TË DHËNAVE TË MARRA NGA OPENCORPORATES.AL

për disa tendera të rindërtimit të vendit si pasojë e tërmetit. Kështu, veç Krujës, kompania e shtetasit Anton Gjinaj u shpall fituese e tenderave edhe në qytetin e Lezhës dhe Durrësit.

Nga verifikimi i të dhënave të publikuara në opencorporates.al rezulton se kompania e tij ka përfituar miliona dollarë nga këto kontrata publike. Rezuton se "ALESIO 2014" në tre kontrata të ndryshme, së bashku me tre kompani si bashkësipërmarrës, kanë përfituar nga Bashkia e Tiranës rreth 11 milionë dollarë amerikanë.

Në mesin e projekteve tenderuese të fituara nga "ALESIO 2014" është edhe ajo në zonën e "5 MAJIT" në Tiranë, ku kishte protesta të shumta të banorëve. Edhe në këtë zonë, kompania e Gjinajt është fituese i dy tenderave për ndërtimin e kompleksëve të banimit në këtë zonë. Në njërin prej këtyre tenderave, vlera e kontratës është 537,665,006.00 lekë të reja dhe ka për objekt: Rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në zonën e shpallur për zhvillim të detyruar në njësinë administrative 4 dhe 8, zona e "5 MAJIT" Bashkia e Tiranës. Si dhe kontrata tjetër e tenderimit kap vlerën e 279,000,000.00 lekë të reja po për të njejtin program të rindërtimit në zonën e "5 MAJIT" në Tiranë. Gjithashtu po në këtë zonë është shpallur fituese bashkë me dy kompani të tjera në rregullimin e pedonales, shesheve dhe rrugëve mes këtyre pallatëve të reja që do ndërtohen me vlerën e tenderit prej 409,913,598.00 lekë të reja.

Në total të të tre këto kontrata kapin vlerën e rreth 11 milionë dollarë dhe janë firmosur në vitin 2020. Gjatë kësaj kohe edhe Bashkia e Durrësit, e Krujës dhe ajo e Lezhës e kanë shpallur kompaninë "ALESIO 2014" si të vetme fituese në ndërtimin e zonave të ndryshme, me vlerë totale rreth 4 milionë dollarë.

Ajo që bie në sy është fakti, se emri i Gjinajt nuk është më enigmatik, pasi në prill të 2021 ai po tentonte të kalonte në Mal të Zi, kur u arrestua nga policia malazeze në zbatim të urdhërit të Interpolit-spanjoll për arrestimin e tij. Ai u arrestua në kufi, por lajmi në Shqipëri doli disa ditë me vonesë, për shkak edhe të njohjeve të shumta që Gjinaj kishte në Shqipëri. Por pavarësisht se ai ndodhej në burgun e Spanjës, Bashkia e Lezhës nuk ngurroi ta shpallë fituese të një tenderi për asfaltimin e rrugëve rurale me nje vlerëmbi 34 milionë lekë të reja.

Pas arrestimit dhe ekstradimit të tij në Spanjë, ai qëndroi disa kohë atje për të vuajtur dënimin e dhënë nga Gjykata e Lartë me 8 vjet e 9 muaj burg. Fillimisht në vitin 2010, Gjinaj ishte dënuar në mungesë me 12 vite burg, por ky vendim u ankimua nga avokatët e të pandehurit në mungesë në Gjykatën e

GJYQET PËR LIRIM NË SHQIPËRI

Që nga vitit 2011, Gjinaj ishte i dënuar për trafik droge në Spanjë. Ndërkohë në Shqipëri kishte filluar aktivitetin e ndërtimit apo më pas të investitorit në bashkëpunim me institucionet shtetërore, i pashqetësuar nga policia, apo prokuroria. Shqetësim që ia prishi policia malazese, pasi tentoi të kalonte kufirin kur edhe u arrestua

Lartë, e cila vendosi dënimin e tij përfundimtar në vitin 2011 me 8 vjet e 9 muaj burg.

Pra që nga vitit 2011, Gjinaj ishte i dënuar për trafik droge në Spanjë. Ndërkohë në Shqipëri kishte filluar aktivitetin e ndërtimit apo më pas të investitorit në bashkëpunim me institucionet shtetërore, i pashqetësuar nga policia, apo prokuroria. Shqetësim që ia prishi policia malazese, pasi tentoi të kalonte kufirin kur edhe u arrestua.

Pas qëndrimit disa mujor në Spanjë, me procedurë të përshpejtuar Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme nxituan ta sjellin në Shqipëri, Anton Gjinaj, për të vuajtur dënimin. Fillimisht u bë njohja e vendimit të gjykatës spanjolle në një gjykatë shqiptare dhe më pas filluan procedurat e transferimit, ku vetëm pak muaj më parë u soll i prangosur në burgun e Reçit në Shkodër.

Avokatët kanë filluar manovrat e lirimit të parakohshëm, edhe pse autoritet spanjolle në vendimin e transferimit kanë qenë taksativë, duke kërkuar që i pandehuri Gjinaj të qëndrojë në burg deri në përfundim të dënimit.

E sikur mos të mjaftonte kjo, policia shqiptare, pas arrestimit në Malin e Zi dhe me kërkesë të autoriteteve spanollje, referuan pranë SPAK-ut materialet për evidentimine pasurisë së tij në bazë të ligjit Antimafia. Prokurorët e SPAK-ut pasi gati një viti hetimi, i kërkuan Gjykatës të vendos sekuestrimin e 6 kompanive të Anton Gjinajt dhe gjithë kapitalin apo pronësinë në emër të këtyre kompanive dhe familjarëve të tij, rreth 25 mijë metra katror truall e arë si dhe 507 metër katrorë apartamente e ndërrtesa si dhe 4 makina. Ky vendim është ankimuar nga avokatët e Gjinajt dhe pritet nisja e seancave gjyqsore.

Rezultate permbledhese

Institucion Buxhetor	Perfitues	Dega Thesari	Viera trasaksioneve	Nr i trasaksioneve	Limiti I vleres	Intervali (sipas date regjistrimi)	Intervali (sipas date ekzekutimi)
All	ALESIO - 2014	All	383,606,739.00	212	All	=>	=>

Transaksione

"Te dhenat e ketij shorbimi jane te aksesueshme ne web-in zyrtar "Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit"

Institucion Buxhetor	Perfitues	Dega Thesari	Viera	Data regjistrimit	Data ekzekutimit	Numri fatures	Kategori shpenzime	Pershkrimi fatures
Ndermarja Rruga (0707)	ALESIO - 2014	Durres	250,159	2021-06-17	2021-06-18	1282107014/2021	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rruges	2107014 NDERMARJA RRUGA ASFALT PRIMER FAT 3 DT 11.06.2021
Ndermarja Rruga (0707)	ALESIO - 2014	Durres	216,778	2021-06-17	2021-06-18	1302107014/2021	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rruges	2107014 NDERMARJA RRUGA ASFALT PRIMER FAT 7 DT 12.06.2021
Ndermarja Rruga (0707)	ALESIO - 2014	Durres	226,394	2021-06-17	2021-06-18	1332107014/2021	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rruges	2107014 NDERMARJA RRUGA ASFALT PRIMER FAT 6 DT 12.06.2021
Ndermarja Rruga (0707)	ALESIO - 2014	Durres	247,454	2021-06-17	2021-06-18	1462107014/2021	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rruges	2107014 NDERMARJA RRUGA ASFALT PRIMER FAT 23 DT 15.06.06.2021
Ndermarja Rruga (0707)	ALESIO - 2014	Durres	76,527	2021-06-17	2021-06-18	1552107014/2021	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rruges	2107014 NDERMARJA RRUGA ASFALT PRIMER FAT 30 DT 16.06.2021
Ndermarja Rruga (0707)	ALESIO - 2014	Durres	327,586	2021-06-17	2021-06-18	1482107014/2021	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rruges	2107014 NDERMARJA RRUGA ASFALT PRIMER FAT 15 DT 14.06.2021
Ndermarja Rruga (0707)	ALESIO - 2014	Durres	259,327	2021-06-17	2021-06-18	1432107014/2021	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rruges	2107014 NDERMARJA RRUGA ASFALT PRIMER FAT 18 DT 15.06.06.2021
Ndermarja Rruga (0707)	ALESIO - 2014	Durres				1472107014/2021	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rruges	2107014 NDERMARJA RRUGA ASFALT PRIMER FAT 22 DT 15.06.06.2021
						1492107014/2021	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rruges	2107014 NDERMARJA RRUGA ASFALT PRIMER FAT 24 DT 16.06.2021
								2107014 NDERMARJA RRUGA ASFALT PRIMER FAT 13 DT 14.06.2021
								2107014 NDERMARJA RRUGA ASFALT PRIMER FAT 23 DT 15.06.06.2021
								2107014 NDERMARJA RRUGA ASFALT PRIMER FAT 16 DT 15.06.06.2021

Rasti i Pashk Rrapit, konsiderohet në jurisprudencën Shqiptare nga më të denjët për rekordin "Guinness", për shkak se i gjithë mekanizmi i Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, është vënë në kolonë dhe lëvizje, jo vetëm për transferimin e këtij të dënuari nga Spanja në Shqipëri, por tashmë në kohë rekord, janë duke u bërë inskursione juridike, për lirimin e tij nga burgu. Pashk Rrapi, zbriti në pistën aeroportit të Rinasit në datën 23 qershor 2022, ku në orën 17:35 ku është pritur nga kryekomisari i Operacionales së Policisë së Burgjeve, Edmond Levani. Levani, e ka shoqërua në ambjentet e burgut 313 dhe një ditë më pas është transferuar në burgun e Reçit në Shkodër.

Ende pa u mësuar me dhomën dhe korridoret e këtij burgu, njeriu që njihet me 4 emra, ka shpalosur ambicien e tij, për tu liruar nga burgu.

Brenda 8 ditëve që "Mbreti i Betonit" kishte shkelur në Shqipëri, ka depozituar njëherësh në gjykatën e Shkodrës, jo një por dy kërkesa për lirim me kusht.

Një rekord juridik i denjë për "Guinness", çfarë tregon se Pashk Rrapin nuk e mbajnë më muret e burgut të Reçit. Dhe i gjithi ky inskursion juridik, kryhet në vetëm 8 ditë qëndrim në burgjet Shqiptare të Pashk Rrapit.

Në datën 5 korrik 2022, është zhvilluar në gjykatën e Shkodrës seanca e parë, ku gjyqtari Hasan Selimi dhe prokurori Agron Bushati, kanë marë pjesë në këtë seancë gjykimi. Pashk Rrapi, përfaqësohej në këtë gjykim nga avokati ish-gjyqtari i Krimeve të Rënda, Luan Hasneziri.

Gjyqi i 5 korrikut është shtyrë, duke u lënë në 13 korrik 2022 të zhvillohej seanca e rradhës. Edhe kjo seancë është shtyrë, duke bërë që gjyqtari i çështjes, Hasan Selimi, të vendosë datën 20 korrik 2022, për zhvillimin e seancës së rradhës. Brenda 20 ditëve të muajit Korrik 2022, gjyqtari Hasan Selimi në Shkodër, caktoi tre seanca gjyqësore për kërkesën e lirimit me kusht ndaj, Pashk Rrapit.



SI U VRA NJË NËNË QË KËRKONTE NË POLICI VRASËSIT E DJALIT

Nga NIKOLETA KOVAÇI

Në të dalë të ditës dhe në të rënë të rrezes së parë të diellit, Fatmira shkonte te varri i të birit, Visit. Aty kishte fatin dhe shpresën e saj! Pasi fliste me të, i tregonte ankthet dhe betejat e ditë-natës, ajo nisej për në punë, në Golem, disa metra sipër vendit ku Visi i saj ishte vrarë me breshëri plumbash në kohën kur Fatmira nënë iu kishte gëzuar ardhjes në jetë të djalit të tij. Ashtu i ngrysi 15 muaj e një javë të jetës së vet, mes nëntokës dhe qiellit, mbuluar me të zeza duke u endur nëpër dyert e insitucioneve nga ku përditë thoshte të njëjtin emër, përditë iu tregonte për të njëjtën shok të të birit, përditë priste një shkëndijë të vërtete të ligjshme që vrasësi i Visit të kishte emrin që ajo njihte dhe i kishte dhënë edhe bukë!



...Edhe dita e 14 shtatorit të 2013-s nisi ashtu! Fatmira doli herët. Shkoi në varreza, foli me Visin dhe më pas i duhej të shkonte të takonte ish-shokun e të birit, të fliste me të, se pse karburanti i të birit ishte bërë me llafe se kishte naftë të keqe! Edhe pse i biri kishte më shumë se një vit që ishte vrarë, ajo mendonte dhe donte që emri i djalit të saj të mos përgojohej për keq. Nuk mund ta lejonte që në atë pronë, që iu hëngri kokën në mënyrë çnjerëzore dhe kriminale atij dhe asaj, të tregtohej karburant me hile, sepse Visi i saj nuk mund të turpërohej as i vdekur. Itinerarin e ditës dhe të dhimbjes së saj e dinin pak njerëz, por e dinin! Jetonin me të; jetuan deri në grahmën e fundit që u ngjit deri në pallat nëpërmjet borisë së mbetur takuar të makinës ndërsa killerat e kishin sulmuar me thika e kaçavida!

Fatmira kishte bërë pazarin për vete e për Tashën, fqinjën e mirë dhe me ekonomi të pamjaftueshme, së cilës i rrëfehej për krejt brengat e veta e të jetës; Visi nuk kishte qenë e vetmja goditje rrënuese e jetës së saj, por ajo kishte vazhduar të rrinte gjallë, pikërisht prej Visit, dritës së syve që ia morën ashtu siç i morën edhe frymën e fundit! Tasha e priste sepse nuk e kishin pirë kafen e ditës me të; *"Dëgjova borinë e makinës dhe dola në ballkon. Po binte shumë dhe mendova se mos iu kishte prishur dhe i kishte mbetur e takuar. Prita në ballkon ta shihja, por e pashë vetëm të mbuluar me gjak..."* Kështu e rrëfeu aso kohe momentin e fundit të jetës së mikes së saj publikisht por edhe për policinë. Grupi i oficerëve anti-krim që morën dëshminë e saj u motivuan dhe u betuan se do ta zbardhnin, por s`qe e thënë! Një natë pas vrasjes ata u shpërbënë si grup. U transferuan nëpër policë e rretheve të tjera! Vrasja mizore u hodh në publik si grabitje dhe zhurma e ardhjes së qeverisë së re, shurdhoi lëngimin e përgjakshëm në atë garazh pallati në mes të Durrësit. Vrasja u zhbë dhe autorët jetuan të qetë bashkë me pasuritë e Elvisit të saj, pa e ditur se "gjaku nuk mund të humbasë" e, herët a vonë, vlon në emër të së drejtës...

VRASJA-GRABITJE E FATMIRA DEDAJT

U fol vetëm 24 orë për krimin e rëndë që kishte ndodhur në Durrës! Policia në deklaratat e kohës tregoi se "ka dyshime që gruaja ishte sulmuar nga grabitës, sepse nuk iu gjend çanta e dorës në vendin e ngjarjes"! Pastaj, shpejt e shpejt, kronologjia e krimit monstruoz nisi të pasurohej me togfjalësh të gatshëm; Nëna e trafikantit të vrarë; i biri dyshohej se u vra për trafik droge, për pazare të pista, për punë femrash etj. Për t'u mbyllur aty dhe për të mos u hapur asnjëherë më ai fashikull i vulosur me gjakun e një nëne që kërkonte në Polici

Pas 9 vitesh tradhëti, pabesi, heshtje, pluhur e harresë zbulohet e vërteta e vrasjes së nënë e bir në Durrës. Dëshmi dhe fakte të pathëna të një prej krimeve më të llahtarshme të dekadës së fundit. Çfarë ndodhi në të vërtetë me rastin e Fatmira dhe Elvis Dedajt që u vranë në harkun kohor të 15 muajve?

dhe Prokurori vrasësit e të birit të vetëm të saj! U dhanë disa dëshmi dhe Tasha, fqinja e saj, i tregoi grupit të krimeve të rënda të gjitha konfliktet që ajo kishte pasur kohëve të fundit. Iu tha se në pronën e të birit e kishin kërcënuar ata që mbanin në punë karburantin. E kishin kërcënuar me jetë në sy të të gjithë punonjësve dhe askush nuk kishte folur, askush nuk kishte reaguar dhe sigurisht që ata njerëz nuk u pyetën kurrë nga organi hetimor që duhej të zbardhte ngjarjen, qoftë vrasje, qoftë grabitje! Sepse policia dhe prokuroria nuk shkuan asnjëherë tek personi që ajo akuzoi për vrasjen e të birit!

Në dosjen gjysmake që hartoi prokuroria e Durrësit, edhe dëshmia e mikes së saj u përgjysmua. Dëshmitë e familjarëve ishin të vakëta, ose ashtu u transmetuan në dosje. Policia dhe prokuroria thanë se kemi hapur dosjen e vrasjes së Elvisit, për të parë se çfarë ka ndodhur me ngjarjen po më pas thanë se për ngjarjen nuk kishte as prova dhe as të dyshuar. Ngjarja ishte klasifikuar pa autor, por kishte mbetur ekzekutim, pasi vrasja ndodhi në mes të ditës dhe në mes të rrugës. Ashtu u mbyll edhe vrasja e Fatmirës, as vrasje, as grabitje; thjesht një ngjarje tjetër pa autor!

Durrësi i atyre kohëve nuk linte shumë kohë për një ngjarje. Atentatet dhe vrasjet e bujshme shpejt zëvendësonin njëra-tjetrën dhe fati i fundit të jetës së Fatmirës do të varej në një miqësi po 'gjaku', që lindi pikërisht mes atyre dy vrasjesh mizore të djalë e nënë! Fatmira e mori në varr të vërtetën e saj dhe la mbi vrasësit mallkimin e të pafajshmit, që pas 9 vitesh shkulmoi dhe ndriçoi vdekjet e tyre! Vëllai i gjakut të shokut të të birit, personit që ajo i kishte drejtuar gishtin si vrasës i tij, 'tradhëtoi' më në fund atë lidhje të 'shenjtë' mes njerëzve djaj!

NUREDIN DUMANI-VRASËSI I PENDUAR...

I tradhëtuar, i rënë në kurth dhe me një plumb në trup që ia kërcënonte çdo sekond jetën e tij, ai vendosi të hapte fletët e errëta të kontratave të vdekjeve që kishte nënshkruar me dorën e tij. Me idenë se fundi i tij është i ngjashëm me të viktimave të veta, ai nisi rrëfimin pikërisht me vrasjen e Fatmira Dedajt, gruas infermiere-mami, që kishte shërbyer gjithë jetën e saj për gratë nëpër shtëpitë e Kavajës dhe Durrësit, që kishte mbetur e ve shumë e re, që kishte rritur dy fëmijë e vetme, që Visin ia kishin vrarë këta dhe më pas edhe asaj ia kishin marrë jetën po këta! Prokurorët e SPAK u dorëzuan; s`mund të bënin më të pamundurin përballë rrëfimit të detajuar të një krimi të llahtarashëm, të mbuluar me pluhurin e dashjes së organeve ligjzbatuese.


NUREDIN DUMANI, NË MOMENTIN E ARRESTIMIT

Skena horror që la Nuredin Dumani në duart e grupit të prokurove me 15 prill të vitit 2022 tronditi mbarë opinionin publik; të pamëshirë, gjaksorë dhe mizorë, ai e dinte se po tregonte krimin më të rëndë që kishte mbajtur në ndërgjegjen e tij mazokiste por mbase të kthjelluar sado pak pas atij plumbi të mbetur përjetë në trup! Ai e nisi rrëfimin me detaje tronditëse që përkonin qind për qind me dëshminë e mikes së saj*: "Donim ta vrisnim në varreza, sepse ajo shkonte çdo ditë te varri i të birit. Ne e shihnim dhe e ndiqnim. Por ndryshuam plan se Festa na e kërkoi ta vrisnim në mënyrë që të dukej si grabitje. Dhe ashtu e realizuam".* Më pas iu tregon detajet e atij momenti të llahtarshëm, se si i zunë pritë, se si e goditen me grushte dhe kaçavidë, se si e tërhoqën zvarrë të hapte garazhin teksa jepte shpirt, pasi mbyllja dhe hapja bëheshin me pult, se si e lanë të vdekur dhe ikën për tu takuar më vonë me porositësin, i cili do t`u jepte paratë e punës që kishin kryer dhe kryer ashtu siç i kishte orinetuar! Vrasësi i penduar iu tha prokurorëve se ai vetë nuk e kishte prekur fare, madje ishte bërë shumë keq teksa e shihte shokun e tij, Talo Çela,

"Dëgjova borinë e makinës dhe dola në ballkon. Po binte shumë dhe mendova se mos iu kishte prishur dhe i kishte mbetur e takuar. Prita në ballkon ta shihja, por e pashë vetëm të mbuluar me gjak..."




tek e godiste pamëshirë dhe pandaluar, por Talo ishte 'pajtuar për në krim' nga vetë Nuredini, vëllai i gjakut të hasmit të deklaruar të Fatmirës së ndjerë! Madje Nuredini u tregon se i kishte thënë "vëllait" të tij, Festim Qolit, që të largohej nga Shqipëria ato ditë, derisa këta të mbaronin 'punën' që të kishte alibi. Dhe ashtu kishte ndodhur. Festimi ishte larguar drejt Greqisë ndërsa pagesën për kryerjen e 'punës' e kishin marrë nga anëtarët e tjerë të familjes Qoli disa ditë pas vrasjes makabre!

"SI E VRAMË FATMIRA DEDEN"- RRËFIMI I NUREDIN DUMANIT

...Gjatë diskutimit Festim Qoli më tha; po më ngushton nëna Elvis Dedës, kjo pasi po interesohej vazhdimisht në Prokurori për vrasjen e djalit dhe ajo akuzonte direkt Festimin. Më kërkoi nëse mund ta ndihmoja me eliminimin e saj. Emrin e kishte Fatmira Dedaj. Pasi diskutuam më tha do të jap 40.000 mijë euro po ta vrisja. I thashë do flas me disa persona, nuk e di atë ditë apo më vonë por di që shkova i vetëm në Elbasan tek Talo Çela. Talon me sa mbaj mend e kam takuar tek lokali/servisi i Gent Sharrës. Kam diskutuar me Talon dhe Gent Sharrën për këtë pjesë. I thashë që janë shumë lekë. Unë i thash më thënë të drejtën janë 30.000 Euro pasi doja të fitoja diçka më shumë.

... Erdhi pas disa ditësh Talo Çela. I kam treguar vendin, emrin, lëvizjet e Fatmira Dedes. E ndoqa bashkë me Talon me makinë disa ditë, nuk i mbaj mend makinat. Ajo shkonte çdo ditë në varrezat e Durrësit në mëngjes. Ideja ishte ta vrisnim tek varrezat. Në ndjekjen e saj kemi futur dhe Dorjan Shkozën i cili kishte një makinë Suzuki ose Toyota me portobagazh të vjedhur, ngjyrë e kuqe. Dorjani e ndiqte dhe na jepte ne të dhënat ku ishte ku shkoi. Talo donte ta bënim tek varrezat pasi sipas tij krijonte lehtësi në largim në drejtim të Spitallës, por unë nuk pranova. Mbasi folëm me Festimin ai më tha që të bëhej tek garazhdi pasi duhej të dukej si grabitje dhe jo si vrasje pasi aty do kishim dhe Agronin (djali i xhaxhait të Festimit) që do na ndihmonte me telefon për lëvizjet e saj.

Për çdo lëvizje që bënte Fatmira unë flisja më të vëllain e Festimit, Petritin të cilin e informoja për çdo lëvizje por jo për planin. Petriti merret me biznes. Ka pas ndërtuar pallate, me sa di ka dhe 2/3 pershkarexhe për peshkim. Mesa di ka dhe një piceri Erdogan ngjitur me ish Apollonin që u shemb pas tërmetit. Petriti është diku sot tek 50-55 vjeç, është 1.80m i gjatë, i shëndoshë mban mjekër gjithmonë. Është i martuar po s'ka fëmijë. ...U vendos përfundimisht që ta eliminonim Fatmirën tek garazhdi i pallatit ku banonte. Agroni jetonte në të njëjtin pallat me të.



TALO ÇELA

...Ditën e ngjarjes shkuam me suzukin/toyotën. Talo kaloi pas, meqë makina ishte me xhama të zinj. Unë isha shofer i mjetit. Kemi bërë rrugën dhe po prisnim tek hyrja e garazhdit. Me vete kishim një pistoletë TT dhe një thikë të cilën e mbante Talo Çela. Talo kishte doreza dhe kapuç, ndërsa unë kam pasur vetëm doreza edhe një triko sportive me kapuç dhe kapele, mesa mbaj mend. Goni na bëri mesazh që Fatmira kishte dal dhe e dinim që do kthehej. Agroni na jepte të gjitha informacionet kur hynte dhe dilte Fatmira. Ajo lëvizte me Citron C4 ishte lehtësisht e verifikueshme. Kemi pritur kthimin e saj rreth 1 orë dhe e pamë që erdhi, u nisa mbas saj me makinë tek garazhdi, hymë njëkohësisht tek garazhdi. Ajo zbriti nga makina pasi parkoi dhe po dilte për punën e saj.

Unë po rrotullohesha tek parkimi dhe Talo doli nga makina dhe po priste momentin. Unë pashë që Talo po e godiste ... Talo kishte dhe armën me vete po s'e përdori. Ai përdori thikën më pas për ta eleminuar. Ajo ishte e shtirë pa ndjenja nga goditjet e tij me grushte dhe shqelma, ai i drejtoi thikën dhe më duket se e goditi në qafë. Unë nuk mund ta shikoja dot. Kështu donte dhe Festimi që të ndodhte pasi donte të dukej jo si vrasje por si grabitje prandaj u përdor konflikti. Talo më pas i grabiti çantën, nuk e di se çfarë kishte brenda se kam parë. Isha i tensionuar nga gjaku dhe nga vdekja e zonjës..."


NË GJURMË VRASËSISH

SPAK nisi të identifikonte me radhë personat; Festa ishte Festim Qoli, një biznesmen i njohur në Durrës. Më saktë familje biznesmenësh. Petriti ishte vëllai i tij ndërsa Agroni ishte djali i xhaxhait. Nuredini tha se pas vrasjes së Elvisit, djalit të Fatmirës me 6 qershor 2012 ishin bërë vëllezër gjaku. Kishin pirë gjak gishti dhe jetonin në harmoni të plotë. Ai e ndjente detyrim t`ja kryente punët Festës, sidomos kur ishte i shqetësuar në nivele të tilla. U kërkua dosja që kishte hartuar Prokuroria e Durrësit. U mor por në të nuk kishte autor të dyshuar. SPAK e fshehu por i shpalli në kërkim tre burrat e familjes Qoli. Në dosjen e harruar, të mbyllur dhe të pushuar nga Prokuroria e Durrësit, gjithësesi ishte dhe është një dëshmi. Është sërish Tasha, fqinja e mirë e Fatmirës së ndjerë. Rrëfimi i saj nuk është marrë parasysh. Ajo u



NUREDIN DUMANI





PALLATI DHE GARAZHI
KU U VRA FATMIA DEDAJ

kërcënua dhe u detyrua ta lërë Shqipërinë. Tasha e tregoi kërcënimin publikisht por nuk mundi më të shkonte në Polici dhe Prokurori. Kishte frikën se pësonte të njëjtin fat me miken e saj, Mirën. Pas pak ditësh ajo doli e tha se nuk dinte asgjë për hallet e Fatmirës, ndaj donte ta linin të qetë, ndonëse në të njëjtin pallat me ta jetonte një nga hekësit e nënës-viktimë, sipas vrasësit të penduar!

KTHIM PAS...DËSHMIA E TASHËS

Pas vrasjes së Fatmirës, Tasha dëshmoi edhe për policinë. Iu tha se Mira kishte konflikte me ortakun e të birit*: "Ne jemi shumë shoqe, për çdo gjë flisnim së bashku. Në mëngjes Fatmira vinte dhe e pinte kafen tek unë ose shkoja unë tek ajo. Pas vdekjes së djalit, ishte tronditur shumë dhe nuk gjente rehati. Sot në mëngjes më tha se do të shkonte të takonte një shokun e djalit, se ai e kishte marrë në telefon për të sqaruar disa gjëra. Më tha që ishte shumë e shqetësuar. Se djali i saj kishte patur një pikë karburanti, dhe ortaku i Elvisit i kishte bërë shumë llafe dhe debate. Nuk i jepte paratë që i takonin nga biznesi.*

U nis dhe shkoi e takoi. Nuk e di se si u shkoi biseda. Kur është kthyer nga Shkozeti ka ndodhur ngjarja. Unë e dëgjova që ajo i ka rënë borisë së makinës për gati 15 minuta, por mendova që ka difekt qepeni. Qepeni i garazhit është elektronik, hapet me pult, dhe mendova që është bllokuar garazhi, e nuk dola në dritare të shihja ç'bëhej. Kur ajo i binte borisë unë dilja përherë në ballkon dhe e përshëndesja sa vinte. Sot mendova është prishur qepeni.

Konflikti me sa di i ka nisur që para një muaj e gjysëm. Kur erdhi nga Shkozeti, dridhej e gjitha. Atje tek karburanti që kishte djali i saj ortak me një tjetër, e kishin kërcënuar shumë. Ishte zverdhur e ishte bërë dyllë. Më tha që më ofenduan e më kërcënuan në sy të të gjithë punëtorëve të karburantit. Nuk e di pse e kanë vrarë, por duhet që policia t'i gjejë urgjent vrasësit e t'i vërë para drejtësisë, se ajo vdiq me plagë në zemër".

Pas asaj dëshmia që Tasha dha në polici, pas ngjarjes ajo u kërcënua në shkallët e pallatit. Ajo kërkoi ndihmë publikisht duke treguar se personi që e kërcënoi fliste me gjuhë të veriut dhe se i kishte thënë të tërhiqte mbrapsht gjërat që kishte thënë! *"Dy a tri ditë pasi u vra Fatmira, një person i panjohur më ka kërcënuar tek shkallët e pallatit. Unë nuk e di kush ishte, por unë isha duke u ngjitur, ndërsa ai duke zbritur. Foli në dialektin verior, e më tha: "Tërhiqi mbrapsht ato që ke thënë, përgënjeshtroi!". Pata drikë që ta denoncoja rastin edhe në polici, se unë nuk dua të përfshihem fare në këto punë. Që prej vrasjes e gjithë lagjja është e frikësuar. Gratë e pallatit shkojnë të blejnë bukë dhe e bëjnë rrugën me vrap. Unë jam e frikësuar për vete..."*

KRONOLOGJI VRASJESH

Me 6 qershor 2012, në afërsi të Golemit, në rrugën dytësore ekzekutohet me breshëri kallashnikovi një 35 vjeçar. Policia e asaj kohe, e cila thuajse nuk jepte shenja jete, mblodhi vetëm gëzhojat në vendin e ngjarjes! U bë me dije se viktimë e atij atentati ishte Elvis Dedaj, një djalë që jetonte mes Durrësit dhe Perëndimit, që kishte disa prona në Durrës, por që ishte marrë edhe me trafik droge dhe kishte precedentë në Europë. U shoqëruan disa persona por më pas u lanë të lirë. Policia nuk mori telefonin e viktimës, të hapte tabulatet telefonike dhe të shihte se kush e kishte telefonuar për ta nxjerrë në atë pritë, pasi Elvisi u tha se ishte në një drekë me miq të tijët. Ose mbase policia e mori telefonin po nuk e zbardhi kurrë bisedën e fundit të jetës së tij! Duke qenë se policia dhe prokuroria nuk po bënin asnjë veprim për të zbardhur vrasjen e të birit, kërkimet i nisi e ëma, Fatmira. Ajo i gjurmoi dhe shkoi në prokurori dhe polici duke iu kërkuar hetimin e ortakut të djalit të saj, Festim Qolit. Pasi ajo e dyshonte si personin e vetëm që ia kishte vra të birin. Fatmira u betua se do t`i gjente dhe shpejt do të viheshin para drejtësisë. Por ndodhi e kundërta. Dëshmitari i drejtësisë, Nuredin Dumani, tha se Fatmirën e kishte shitur prokuroria e Durrësit, ndonëse ende nuk është hetuar grupi që u mor me hetimin e atyre dy vrasjesh. Pas një viti, Fatmira u masakrua në garazhin e saj poshtë pallatit, për ta mbyllur përfundimisht portën e jetës, po jo të së vërtetës.

...Tashmë dy ngjarjet thuajse janë zbardhur. Prokuroria ka fakte, prova, dëshmi dhe gjithçka i duhet për të hedhur dritë mbi atë akt barbar që iu mori jetën asaj dhe të birit, të paktën që djali i Visit, nipi i saj, të mos e kalojë jetën në terrin e mosdijes se kush dhe pse ia vranë babë e gjyshe!

LUFTË DHE SPIUNAZH

NJË HISTORI E PABESUESHME NË GJIROKASTËR

Nga ERALD KAPRI

"Darka e gabuar" e Ismail Kadaresë zhvendos ngjarjet në qytetin e gurtë të Gjirokastrës kur për një moment, regjimi komunist pretendonte se mjeku shqiptar Dr. Gurameto mund të zbulonte çelësin e komplotit të vrasjes së Stalinit. Por përtej të pabesueshmes të historisë së këtij romani, në kohën e luftës, në qytetin e gurtë, pretendohet një histori spiunazhi që përfshin disa personazhe interesante dhe të panjohur për publikun, por me lidhje të shumëfishta.

Spiridon Grima ishte një 58 vjeçar nga Malta por me shtetësi britanike i cili kaloi 5 vitet e luftës në Gjirokastër dhe drejtonte aty një fabrikë të prodhimit të duhanit. Mirëpo, për komunistët e sapo ardhur në pushtet në 1944, ai ishte një agjent i Gestapos gjermane. Ngjarja merr nota misteri për shkak të një hetimi që i bëhet shtetasit të pazakontë që jetonte në Gjirokastër, por edhe ndërhyrjes së britanikëve që në një kohë rekord e marrin Spiro Grimën dhe e evakuojnë në Itali brenda një 1 muaj pas çlirimit të vendit.

Një dosje e plotë hetimore gjendet e pluhurosur në Arkivin Britanik mbi aktivitetin e Spiro Grimës që jetoi dhe punoi në Gjirokastër por pothuajse asgjë nuk ka për të në Shqipëri. Përmes këtij hetimi, zbulohen pretendimet e të dyja palëve dhe në fund, një ndërhyrje e lartë deri tek diktaroi Enver Hoxha që i jep të gjithë kësaj historie një shije komploti dhe misteri.


HISTORIA E SPIRO GRIMËS

Spiro Grima kishte lindur në Korfuz dhe ishte rritur në Maltë. Ai ishte martuar me një grua britanike dhe kishin 2 vajza. Kishte jetuar në shumë vende, mes tyre edhe në Gjermani për 12 vite. Pretendonte se ishte specialist i përpunimit të duhanit dhe jeta e kishte detyruar të jetonte në shumë vende, të njihte shumë njerëz dhe madje të fliste shumë gjuhë të huaja.

Në dosjen hetimore, Grima thotë se erdhi në Shqipëri në vitin 1938 me ftesë të një prej industrialistëve të parë shqiptarë, ndoshta më i pasuri i Shqipërisë, ish kryeministri Ibrahim Biçakçiu. Grima do të drejtonte një punishte të përpunimit të duhanit në Sarandë dhe me pushtimin Italian, ai do të internohej në Delvinë, nisur nga shtetësia e tij britanike. Italianët e burgosën për disa muaj edhe në Tiranë, por me ndërhyrjen e mikut të fuqishëm shqiptar, Grima do të zhvendosej në Gjirokastër me familjen e tij ku do të drejtonte një punishte duhani.

Siç pretendon ai, pushtuesit gjermanë e detyruan të vendosin në punë punishten për interes të tyre ndërsa ai ishte parë të vizitonte edhe drejtuesit gjermanë të ushtrisë në Gjirokastër të cilëve, siç pretendonte, u dërgonte duhan. Me ardhjen e ushtrisë partizane në Gjirokastër, Spiro Grima do të arrestohej dhe do të mbahej i burgosur për 1 muaj.

Një trupë partizane nisi hetimin ndaj tij dhe e morën në pyetje duke e akuzuar se ishte një agjent i Gestapos gjermane që kishte si detyrë të informonte mbi situatën në Shqipëri për gjermanët dhe madje për nacionalistin


R.A./CARDS

1. Please trace:-
SURNAME..GRIMA.....
ALIASES.....
DATE OF BIRTH..1898.....
FURTHER DETAILS.....

OTHER NAMES..SPIRIDIONE & SPIRO
NATIONALITY..BRITISH (MALTA)
PLACE OF BIRTH..MALTA.....
~~Member of N.S.D.A.P.~~ WORKED FOR GERMANS IN ~~ALBANIA~~ ALBANIA

2. ~~Please card CX/22666/A as subject's RF if he does not already have one.~~
3. Please cancel all S.O.E. cards & references.


Trace results:-

SOE 41 ND /400/12


Please return to R.A./S.O./F.
8. 2. 61.

R.A./F.F./2.
Please file attached papers on CX/.....
R.A./S.O./A.

Trace only



ALAN PALMER



ENVER HOXHA

Kreu i misionit ushtarak britanik në shqipëri, Alan Palmer, informoi Londrën mbi evakuimin e menjëhershëm të Spiro Grimës drejt italisë, në fundin e dhjetorit 1944. Ndërhyrja e britanikëve deri tek Enver Hoxha, përmes britanikut të vetëm që Hoxha besonte, Alan Palmer, krijoi hije dyshimi të mëtejshëm. Hoxha me Palmer kishin krijuar një miqësi së bashku dhe i shërbenin njëri-tjetrit por ana tjetër, Spiro Grima ishte një mik dhe bashkëpunëtor i disa miqve shqiptarë, edhe të Enver Hoxhës.

Në fakt, në vitet e para të luftës, Enver Hoxha zhvilloi të njëjtin aktivitet si Grima, jo në prodhimin por në shitjen e duhanit në dyqanin e famshëm në Tiranë, 'Flora', bashkë me nipin e Ibrahim Biçakçiut, Esat Dishnica. Të gjitha këto rrethana mund të kenë shpëtuar nga plumbi Grimën por edhe e larguan nga një telash që ndoshta mund të dinte më shumë seç duhej. E në fakt, asgjë nuk u dëgjua më për Spiro Grimën më pas.

Kjo ngjarje nxjerr zbuluar edhe miqësinë e Enver Hoxhës me britanikun Palmer. I ri dhe ambicioz, ishte i vetmi oficer britanik që fitoi respektin e Enver Hoxhës dhe ai mund ta takonte atë pa nevojën e një përkthyesi. Enver Hoxha nuk pranonte asnjë tjetër për të komunikuar dhe gjithnjë komanda aleate e Mesdheut i kërkonte Palmerit të negocionte me Enver Hoxhën. Në përfundim të luftës, Palmer u bë këshilltari politik i misionit Britanik në Tiranë dhe sërish ai do të ishte i vetmi që do të bisedonte me Hoxhën për tema të nxehta.

Ai njihej për miqësinë e tij me liderët komunistë shqiptarë ndërsa kolegët britanikë evidentonin afërsinë e Palmerit me Hoxhën, shpesh duke hedhur dyshime se Palmeri ishte një mbështetës i diktatorit shqiptar.

Në vjeshtën e vitit 1945 Palmer do të largohej nga Shqipëria dhe nuk do të fliste më për Enver Hoxhën, por as ky i fundit nuk do e anatemonte si gjithë oficerët e tjerë britanikë. Besohet se ata nuk patën më kontakte ndonëse së bashku ishin takuar me dhjetëra herë duke diskutuar temat më të nxehta të luftës dhe fillimet e pushtetit pas saj.

Alan Palmer, pas lufte, do të merrte në dorë fabrikën e biskotave Huntley&Palmers, më e madhja në botë. Ajo ishte krijuar që në fillim të shekullit të 19-të dhe në fillim shekullin 20-të, Huntley&Palmers ishte një ndër kompanitë më të mëdha në botë. Miliarderi i biskotave nuk foli më për miqësinë e tij me Enver Hoxhën, miqësi që e gradoi shpejt dhe i dha vëmendjen që ai kërkonte gjatë shërbimit të tij në Luftën e Dytë Botërore, duke u dekoruar pas saj nga Mbreti Britanik për Shërbime të Shquara.

grek Napolon Zerva, i cili kishte masakruar popullsinë çame atë vit.

HETIMI I GRIMËS

Ferik Hado dhe Nonda Papuli, dy komunistë besnikë të regjimit, morën në pyetje Spiro Grimën duke dhënë disa konluzione që kërkonte dënimin me vdekje të britanikut me origjinë malteze. Pretendimi i komunistëve të rinj ishte se bazuar në disa informacione të marra nga gjermanë të dorëzuar, Spiro Grima ishte informator i Gestapos, dhe se me aktivitetin e tij, dëmtoi lëvizjen partizane, veçanërisht duke dhënë informacion mbi partizanët që vinin nga minoriteti grek.

Prova më e fortë e komunistëve ishte se një shtetas austriak Hane Pruk Shtalba që jetonte në Tiranë prej vitesh dhe punonte si berber. Ai pak para se të vdiste, u dorëzoi një liste me emra komunistëve, për të cilët mendohej se ishin informatorë të Gestapos Gjermane. Ata pretenduan se zhvilluan një hetim të mëtejshëm duke besuar se aktiviteti i Grimës përfshinte informacion të gjerë që shkonte deri tek nacionalisti grek Napoleon Zerva, por që vështirë se mund ta provonin këtë gjë. Teksa britaniku i pazakontë që prodhonte cigare në Gjirokastër në kohën e luftës pritej të ekzekutohej nga një trupë partizane, pati një ndërhyrje të beftë për çështjen e tij tek më i forti i regjimit, Enver Hoxha, për ta liruar atë.

JETA E NATËS NË VITET '90



NGA DISKO ALBANIA DHE MARIKAJ TE BUZUKËT E PARTY-t RAVE

Nga REZARTA DELISULA

Me atletet Simod, furnizimi i parë me mall të huaj në fillim të viteve '90, ku duhej të rrije me orë për t'i blerë, bluze T-shirt lidhur mbi kërthizë, xhinse të sjella me pako nga emigrantët e 2 korrikut 1990 dhe flokë origjinalë që i derdheshin mbi supe, vajzat e Tiranës nisën të frekuentonin diskotekat e para të hapura në kryeqytetin e shqiptarëve në fillim vitet '90. Po aq të gjata i mbanin flokët dhe djemtë të etur nga dëshira për të imituar The Beatles, e që më parë nëse tentonin ua prisnin policët në mes të rrugës ashtu sikurse ia grisnin me gërshërë dhe pantallonat kauboj. Nën tingujt e muzikës dance të atyre viteve ato vallzonin teksa imitonin lëvizjet e bashkëmoshatarëve europianë.

DISKO 'MARIKAJ' DHE 'ALBANIA'

Në majë të kodrës së Marikajt, në rrugën Vorë-Manës, italiani Alberto Rancini hapi diskon-restorant në vilën e bukur lyer me të verdhë. Një vend që frekuentohej nga paria e kohës, gazetarë, intelektualë por dhe të 'fortët' me të dashurat e tyre. Ditët e shtuna, makinat niseshin nga Tirana ndërsa të rinjtë rrinin si sardele njëri mbi tjetrin sepse mjete nuk kishin të gjithë. Jo të gjithë mund të shkonin në Marikaj megjithatë vargu i makinave të parkuara niste nga rrëza e kodrës deri në majë të saj ndërsa njerëzit ngjiteshin turma turma. Sigurisht që për ato vite çmimet ishin të kripura megjithatë sërish disko 'Marikaj' mbushej plot. Disko 'Marikaj' ishte si një oaz europian pasi ishin të shumtë edhe të huajt që e frekuentonin. Ky vend u menaxhua për vite me radhë nga italiani Rancini ndërsa në vitin 2000 ai u akuzua nga prokuroria italiane për pjesëmarrje në një grup kriminal që tregtonin viza italiane të cilat kushtonin 1000-1500 dollarë e pikërisht në vilën e Marikajt bëhej dorëzimi i parave e falsifikimi i dokumenteve që dorëzoheshin në konsullatë. Disko më e famshme në Tiranën e fillimviteve 90 mbetet Disko Albania e cila u kthye dhe në pikë referimi për tu orientuar. E ndodhur përballë shtëpisë së Kadaresë pranë Hotel Tirana, disko ishte lehtësisht e arritshme në këmbë ose me transport publik për ato që e kishin shtëpinë më larg. Ajo ndodhej nën tokë. Ishte si një koridor i errët që herë pas here zgjerohej dhe në mes ishte pista e vallëzimit. Pikërisht në këtë lokal modern u zhvillua në vitin 1992 konkursi i kërcimit '12 vallëzime pa një të shtunë' me prezantues Adi Krasta e Valbona Çoba, skenar Pandi Laço dhe regji të Vera Grabockës, një kompeticion ku të rinjtë mësuan lëvizjet e para të kërcimit modern. Disko 'Albania' në fillim funksiononte natën por jepej dhe me prenotime nga mëngjesi. Kryesisht diskot në Tiranë hapeshin në ora 11 e mbusheshin me gjimnazistë që lenin orën e mësimit dhe më pak student.

MODA E DISKOVE

Duke parë tendencën e gjimnazistëve për të kërcyer në diskoteka gjatë orarit të mësimit nisën të hapeshin një pas një shumë diskoteka, madje edhe pranë shkollave. Disko Refleksioni përballë oborrit të Akademisë së Arteve frekuentohej nga Petroninsat, te Gjimnazi Partizani ishte disko 'Enigma', 'Sami Frashëri' ishte 'Monako, 'Luks' në bodrumet e Pallatit të Kulturës, te Partizani i Panjohur Disko 'Blu', 'Hot Line' po ashtu te Cirku i Tiranës, në Bulevardin Zogu i Parë, ishte 'Meteori' dhe 'Fantastik'. Ndërsa te Inxhinieria e Ndërtimit u hap Disko Agi, në Qytetin Studenti 'Kapanina' dhe 'Roteori', te Artet 'Artisti', në mes të Parkut



ARTUR STRAZIMIRI:

KUSH ISHIN ELITAT E MBRËMJEVE QË FREKUENTONIN BODRUMIN TIM PARA VITEVE 1990

BARDH KADILLI E KOSTIKA TREBICKA, FREKUENTUES TË RREGULLT



Edhe sot kur e takon Artur Strazimirin, energjia që përcjell është fantastike, ndërsa të duket sikur vitet kanë mbetur në vend duke mos e tjetërsuar njeriun që organizonte mbrëmjet e famshme në bodrumin e shtëpisë së tij, pranë gjimnazit Partizani. Ka qenë fundi i gushtit 1983 kur ai bashkë me disa shokë të lagjes sistemuan bodrumin e shtëpisë private dhe e përshtatën sipas mundësisë që ofronte koha, në një vend ku më pas do të mblidhej elita e Tiranës së atyre viteve. 'Men Musaraj ishte legjenda e mbrëmjeve që organizoheshin nëpër shtëpi, dhe ai e kishte nisur herët, në vitin 1972. E kam takuar Menin kur isha 16 vjeç dhe energjia e atij njeriu e kultura muzikore më befasoi. Kështu në fund të gushtit bashkë me disa çuna lagjeje, Vin Kraja, Gaz Kraja, Bert Cici u mblodhëm e bashkë me Ben Mamaqin, Bledar Mamaqin, Andis Mamaqin, Taulant Deda, Bardh Kadilli, Ben Hoxha, Kostika Trebicka dhe dy çuna nga Durrësi kushërinj të Benit u mblodhëm në festën e parë në bodrum. Cunat i binin veglave, kishim 2 kitara, bateri, violin e luanim për qejfin tonë. Vinte Rina, Arjana, Zamira Begeja ndërsa Ben Musaraj regjistronte këngë në magnetofon', tregon Artur Strazimiri. Muzika që dëgjohej në ato kohë ishte ajo italiane e angleze ndërsa në bodrum luheshin The Beatles, Dire Straits, Deep Purple, rock, muzikë që nuk vdes kurrë. Tur Strazimiri kujton dhe Genc Dashin e Kujtim Spahiun, dy ikona të tjera të mbrëmjeve në Tiranën e para viteve '90. Në bodrumin e Strazimirëve kishte dhe një të veçantë tjetër. Të gjithë që vinin aty për të festuar, shënonin emrat në mur dhe datën e orën që kishin hyrë. Edhe kur ktheheshin sërish ata e gjenin emrin skalitur në muret e bodrumit që gjendej pranë gjimnazit Partizani. Por si e përjetoi Tur Strazimiri fillimin e viteve '90 kur u hapën klubet e tjera të natës në Tiranë? 'Në fillim të demokracisë u hap disko Albania që ndodhej përball shtëpisë së Kadaresë, një tjetër bodrum pranë shtëpisë së Tedi Papavramit, një te shtëpia e Kacelve poshtë sahatit e Disko Refleksion te Korpusi. Ishim reth 70 vetë që frekuentonim jetën e natës dhe kur mbylleshin lokalet unë merrja shoqërinë time në shtëpi dhe vazhdonim deri në mëngjes. Kur Tirana u miksua me të ardhur nga vende të ndryshme të Shqipërisë jeta e natës u prish pak, flas për ata që pinin alkol dhe nuk e njihnin muzikën por donin të komandonin muzikën'- thotë Tur Strazimiri. Sot ai del rrallë por i pëlqen më shumë të frekuentojë vende ku luhet muzikë live dhe jo muzikë kompjuterike ndërsa shpirti i tij rock&roll do të mbetet i gjallë me të deri në frymën e fundit.



ARTUR STRAZIMIRI

KAÇURELI I PARË SHQIPTAR

Tur Strazimiri kujton një histori shumë interesante në vitet '86-'87. 'Kur mblidheshim në bodrumin e shtëpisë time me elitën e çunave e gocave të Tiranës në ato vite, secili sillte ndonjë shishe ponç, konjak ose fërnet sipas rastit dhe ne nuk kishin kushte për t'jua ndarë në gota gjithësecilit se bëheshim rreth 30 vetë e më shumë. Në shtëpi sipër unë kisha një tenxhere shumë të madhe e aty përzinim të gjitha shishet e mbase mund të them që te bodrumi im është bërë kaçureli i parë në Tironë. Pijen e shpërndaja me garuzhde ndërsa për gota përdornim kavanozët e salcave'- tregon Tur Strazimiri.

Rinia dikur i mbipopulluar me ndërtimet pa leje ishte 'Krokodili'. Me ndërtimin e ish-Bllokut me palate të larta nisi dhe aty hapja e klubeve të natës. 'Cawboy' në anë të vilës së Enver Hoxhës, 'Canon' që është ndër të vetmit që mbijeton edhe sot, dhe shërbente më shumë si afterparty, 'Cavaliero', 'Capricio' që është ende në modë përbalë Kullës së Vodafonit në Bllok… Te Sheshi Willson 'San Paolo', 'Vullkani', 'Super Star', më tej 'Mulino'.

RAVE PARTY DHE BUZUKË

Në fillimet e viteve '90 një pjesë e rinisë preferonte grupet 'Prodigy', 'Red Hot Chilli Papers', Curt Cobain, që i përkisnin rrymës rave. Pikërisht te piramida u ndërtua një klub i tillë. Një pjesë e madhe e frekuentuesve të këtij klubi tymosnin kanabis dhe përdornin edhe lloje të tjera drogash të ndryshme, visheshin ndryshe, ishin më të ndryshëm nga të tjerët dhe ishin kryesisht nga Tirana dhe një pjesë e tyre vinin nga familje të njohura intelektuale kryeqytetase. Po atëherë emigrantët e parë sollën dhe imitacionet e buzukëve grekë në kryeqytet. Një i tillë u hap pranë Librari Flora dhe njihej si buzuku i Odisesë. Silo Club ishte një tjetër i tillë pranë Fabrikës së Miellit në ish-Qytetin e Nxënësve. Muzika e kënduar nga më të famshmit e Greqisë shoqërohej me shishe të shtrenjta pijesh alkoolike dhe shporta me trëndafila që u hidheshin vajzave të cilat vinin të veshura me taka të larta dhe minifunde. Hyrja në Silo Club ishte me pagesë për djemtë dhe një long drink kushtonte 600-800 lekë.


Armand Haderllari

MUZIKA LIVE

Një nga klubet më të famshëm me muzikë live ku këngëtarë shqiptarë luanin muzikën e tyre dhe hitet botërore ishte Rozafa te 9 katëshet. 'Rozafa' në ato kohë frekuentohej nga njerëz të njohur e jo çdo kush mund të futej në këtë klub madje në një moment ai u bë dhe me kartë antarësie. Më pas u hap Rozafa Palace ku është sot Triss te ish-markata në Unazë pranë rrugës 'Hoxha Tasim'. Aty vinin më shumë drejtuesit kryesorë të mediave, djemtë e njohur të qytetit, biznemenë… Krahas muzikës live kishte dhe DJ dhe kazino pra një klub si jashtë shtetit, i thonim dikur. Kryeqyteti pasurohej çdo ditë me modele të ndryshme diskotekash ndërsa pas viteve 2000 klubet e natës nisën të frekuentohen masivisht nga studentët që vinin nga rrethet e studionin në Tiranë.

JETA E NATËS NË SYTË E MANDIT

Armand Haderllari është një ndër menaxherët e njohur të klubeve të natës në Shqipëri.Në vitet 1988-1992 ai ishte në gjimnazin Qemal Stafa. Me klasën në vitin e 4-t frekuentonin Gbox ku futeshin monedha e dëgjonin rock. 'Frekuentuesit e diskove në Tiranë ishin vendali dhe gjimnazistët njiheshin me njëri-tjetrin, Marikaj për ne ishte më i veçantë sepse ishte jashtë qytetit. Muzika ishte e huaj, dance më shumë ndërsa shqiptare nuk diskutohej. Aty nisëm dhe pijet e para long drinks jackcola, vodkaportokall por edhe camparin e pinim. Aty nga viti 1995-1996 filluan të dilnin dhe studentët e rretheve. Në vitin 1997 pati një mbyllje të klubeve të natës dhe në 1998 për shkak të trazirave politike nuk kishin shumë frekuentim'- tregon Mandi. Në vitin 2004 u hap Irish Pub te libri universitar ku Mandi pas një experience të marrë jashtë shtetit nisi menaxhimin e bistros. 'Morëm disa qasje jashtë dhe unë arrita të bëja orën e aperitivit, ku banaku mbushej me ushqime bufe dhe me 500 lekë kushtonte ushqimi bashkë me një gotë verë, ishte risi për tregun shqiptar. Pastaj në 2008 hapëm bashkë me ortakët 'Mai Tai' ku pati një boom të jashtëzakonshëm pasi mbante 2000 vetë kishte pishinë dhe vendnodhja në kodër i jepte pamje spektakolare. Pas marrjes pjesë në Big Brother 3 hapa 'Davidoff' një vend dedikuar të rinjve paradite në bllok paralelisht me 'Mai Tai', tregon Mandi i cili të ardhmen e mendon të drejtoj një pub të vogël me klientelë të rritur ku të bëhet muhabet e në sfond të ketë muzikë të mirë jo komerciale. Po si e përkufizon ai jetën e natës sot në kryeqytet? 'Janë dy lloj klientësh ata që vijnë për tu kënaqur e janë të qetë dhe një grup tjetër që vijnë për të kënaqur të tjerët dhe janë të bezdisur e nuk i kam qejf t'i kem në ambientet e mia'- përfundon Mand Haderllari. Kjo ishte pak a shumë një panoramë e jetës së natës në kryeqytet në vitet '90 ku dominonte muzika e mirë, stilet unike të kërcimit me koreografi dhe veshjet ku dominonte e zeza dhe lëkura.

VESHJET SIPAS MODËS

Veshjet e vajzave ndryshonin sipas viteve me modën që përcillej nga televizionet italiane. Në kohën kur Ambra bënte emisionin 'Non e la Rai', vajzat vishnin funde me pala korenti të shkurtra, më pas këpucët me platform poshtë, kambale, golfë të zinj e pallto të gjata të zeza në dimër. Kush kishte xhup lëkure ishte më në modë dhe kërcenin me të pa e hequr.

ATLAS

Pasion për cilësi

MIELLI ASSOS



MIELLI I PARË SHQIPTAR BIO



Inva Mula:

UNË SOPRANOJA E PARË SHQIPTARE NË SKENAT EVROPIANE

Inva Mula sot ka ndryshuar shumë nga vitet 90, kur shkoi për herë të parë në Francë dhe zgjodhi të qëndrojë atje. Tani, e tërhequr nga skena "aktive" ka gjetur skenën e vet "korçare", ku organizon aktivitete dhe i duket sikur është në Paris. Cila është lidhja me djalin e vajzën dhe rikthimi me dashuri në Korçën e Serenatave

Nga **SUADA DACI**

Kritika mbarë botërore do ta cilësonte si një ndër sopranot më të mëdha të botës. Mësimet e para ajo i mori në moshën 5 vjeçare në piano. Pas studimeve në Akademinë e Arteve në Tiranë filloi karrierën si soprano. Fitoi konkursin Tefta Tashko Koço dhe më pas çmimet e saj do të ishin të pafundme. Ishte viti 1992 kur fitoi çmimin "Madame Butterfly" në Barcelonë dhe më pas triumfoi në vitin 1993 me çmimin e parë në konkursin e parë operialë të Placido Domingos dhe më pas suksesi do të kishte vetëm emrin **INVA MULA.**

Është një zonjë shumë e madhe (për fuqinë dhe emrin që mbart mbi supe, qoftë të vetin apo edhe të familjes së saj), por në të njëjtën kohë është edhe një zonjë shumë elegante dhe "petite" që mbart energji shumë pozitive brenda vetes. Dhe e dini pse e them këtë, sepse Inva Mula ka pesë vite që bën bashkë artistë nga e gjithë bota në Korçë. Në Korçën e saj të dashur e cila në vitin 1987 i dha çmimin e parë në konkursin Tefta Tashko Koço dhe 35 vitesh Inva Mula nderohet nga ky qytet me titullin "Qytetare Nderi". Ndonëse mban tituj shumë të rëndësishëm si " Kavaliere e penës dhe e artit" dhënë nga shteti francez, "Nderi i Kombit" marrë me meritë nga shteti jonë duket se dhe ky titull i ri po i shijon pamasë artistes së mirënjohur.

Unë e takova në Prespë dhe megjithëse duhet të prezantonte "Mik Festival", të koordinonte punët në backstage, nuk i tha jo intervistës për revistën tonë.

Veshur me një fustan të bardhë veror, atlete bojë rozë dhe një kapele , e madhja Inva Mula u bë një, jo vetëm me të ftuarit e saj specialë por edhe me banorët e zonës, që e shihnin me adhurim...

MIK FESTIVAL

Interesante jeta nganjëherë (ose gjithmonë në fakt) por ne na pëlqen të themi nganjëherë, i tërheq njerëzit aty ku do vetë. Dhe unë jo rastësisht por atëherë kur isha më e re unë mora pjesë në konkursin Tefta Tashko Koço (që më vjen keq) që nuk ekziston më dhe u çudita dhe vet që mora çmimin e parë, pasi s'më njihte njeri dhe kërkesat në artin klasik kanë qenë gjithnjë në maksimumin e vet. Dhe për shumë e shumë vite unë ngaqë nuk jetova më në Shqipëri, kisha shumë vite pa shkelur në Korçë derisa para 5 vitesh u riktheva në këtë qytet. Një mbrëmje të bukur që vetëm në

NJË SHQIPTARE NË TEATROT
MË TË RËNDËSISHME TË BOTËS

këtë qytet mund të ndodhë të gjithë njerëzit këndonin njëzëri, pasonin kitarën sikur ish-in të programuar (kur në fakt çdo gjë ishte spontane) dhe pata një thirrje të brendshme ku thashë ky qytet që këndon vetë, ky qytet që ka nxjerrë shumë artistë, ky qytet meriton të ketë një Festival Internacional. E përjetova aq fortë sa më doli nga shpirti fjala MIK që është "Muzika Internacionale në Korçë". Nga ana tjetër doli dhe fjala më e bukur në botë MIK që është shumë e dashur dhe që të thërret", më tregon me çiltërsinë e një fëmije Inva Mula. **(Le ta themi mes nesh këtë fakt është kaq komode dhe kaq rehat sa ndërkohë që bashkëbisedojmë ajo është duke provuar edhe gatimet tradicionale të Korçës. Dhe ju e dini se si gatuajnë zonjat korçare).**

Duke lexuar për jetën dhe dëgjuar intervista të shumta të Inva Mulës, instiktivisht më lind pyetja: A i duket e ngjashme Korça me Parisin?!

(Në një rrëfim për emision Blu në korrik të vitit 2003 Inva Mula shprehet se ka qenë gjithnjë e apasionuar pas Parisit, por në të njëjtën kohë Parisi nga ai që kishte lexuar dhe imagjinuar ishte ndryshe nga ai me të cilin ajo u përball. Dhe madje si çdo turist gjëja e parë që bëri shkoi dhe pa "Kullën Eiffel" ku edhe banonte pranë saj)…

Por le të kthehemi tek Korça, a është ky qytet një Paris i vogël?

"Jo nuk më ngjan dhe gjithnjë kam pyetur sepse e kanë quajtur Parisi i vogël. Por disa nga përgjigjet që më kanë ardhur spontanisht kanë qenë sepse ndoshta si rrugët e Parisit që hapen pas një rrethi. Por mendoj që Korça është qyteti më frankofon shqiptar, duke qenë se liceu i parë është hapur këtu. Por edhe aristrokacia korçare ka jetuar duke mësuar frengjishten dhe jo anglishten. Prandaj mendoj që është qyteti më frankofon që kemi dhe ndërmjet Luftës së Parë dhe të dytë Botërore është formuar një qeveri franceze këtu. Ka një varr të ushtarëve që kanë ndërruar jetën këtu. Mendoj që Korça nuk ka lidhje vizuale por historike ka patjetër me Parisin.

PARISI

Një shprehje e njohur thotë se " një ditë e keqe në Paris, është gjithsesi një ditë më e mirë se kudo tjetër". Sa ja ndjen mungesën kryeqytetit francez, Inva Mula?!

"Parisi është vendi ku pas Tiranës ndihem si në shtëpi. Karriera ime shpërtheu atje dhe kur e kthej kokën pas them si ka mundësi që shpërtheu në vendin më të vështirë për t'u kapur. Por dhe kjo do analizë të thellë, por mendoj pse jo. Pse mos të shpërthente në Paris dhe ndihem shumë krenare për atë që bëra. Megjithatë Parisi është vendi ku kam lindur të dy fëmijët e mi. Atje i kam çuar në kopsht, në shkollë dhe jam e përgjysmuar, pra Inva mes Tiranës dhe Parisit.

Në kohët që jetojmë ka shumë artistë që po e lartësojnë dhe po e ngrenë në një tjetër nivel emrin e Shqipërisë. Ama në periudhën kur Inva Mula vendosi të qëndronte në Paris, ishin të paktë personazhet që e zhvillonin karrierën e tyre jashtë shtetit dhe një prej tyre ishte edhe sopranoja e famshme, që kudo ku shkelte e kudo ku këndonte e thoshte me zë të lartë që ishte nga, SHQIPËRIA.

"Është një raport që ka patur ndryshimin e vet. Unë kam qenë nga të parat që ika, ose s'mund ta them që ika por që fitova një bursë, shkova për ta bërë atë dhe për t'u kthyer. Por mbaj mend që ishte janari i vitit 1992 dhe kushtet në Shqipëri ishin të paimagjinueshme. Unë mendoja që do mbaroja dhe do kthehesha, por për shkak të situatës në Shqipëri qëndrova në Paris dhe e vijova atje karrierën time. Mirëpo asokohe për Shqipërinë nuk kishte një imazh të mirë. Vendi jonë nuk njihej dhe ndërkohë unë isha shqiptarja e parë që këndoja në operën e Parisit, në La Scala të Milanos në Arenën e Veronës, e në shumë teatro të tjera prestigjoze. Më vjen mirë që i kam shkelur e para këto teatro. Në fillim ata çuditeshin thonin nga vjen ky njeri, ndërkohë që ne po dëgjojmë për eksodin por në fakt këtu paska art dhe artistë të mëdhenj. Unë ndihesha krenare me Kadarenë, se në çdo tavolinë që shtrohej ai ishte referenca kryesore. Por ishte gjithashtu edhe Tedi Papa-







vrami, një nga figurat më të rëndësishme të artit shqiptar që pati dhe ai rrugëtimin e tij. Mos të harrojmë Angjelin Prelocajn që edhe pse kishte ikur shumë i vogël ishte një referëncë shumë e madhe. Ai ishte një nga figurat më të mëdha të koreografisë madje do ta cilësoja historike pasi ta bësh këtë gjë në Operan e Parisit, ku baleti është në majat e botës atëherë ke arritur gjithçka. Fatmirësisht unë nuk isha vetëm në këtë rrugëtim dhe isha shumë e lumtur. Ne na kanë ftuar të flasim për rrënjët tona në mediat më të rëndësishme franceze dhe padashje kemi mbajtur mbi vete edhe hallet e vendit. Këto probleme nuk ishin problem për kolegët e mi italianë apo gjermanë, por ky ishte proçes që e bëri rrugëtimin e tij dhe mua më pas nuk më pyesin më se nga cili vend vija, pasi tashmë të gjithë e dinin që vija nga Shqipëria.

E keni menduar se si do të ishte karriera juaj nëse do të kishit qëndruar në Shqipëri, e pyes unë?! Dhe Inva Mula përgjigjet shumë thjesht.

"E kam menduar por nuk mund të përgjigjem, pasi nuk e kam provuar por mendoj se do të gjeja gjithnjë një rrugëzgjidhje për të çarë në art".



FAMA & KARRIERA

Kurioze isha të dija gjithashtu se si ka qenë (dhe është) raporti i Inva Mulës me famën. A ka qenë ajo mendjemadhe, a ka ndjerë ajo rivalitet? A e kanë dashur më shumë njerëzit si artisten e madhe apo për njeriun e mirë që ajo ka zgjedhur të jetë në jetë.

"S'kam qenë kurrë mendjemadhe. Madje njerëzit që më rrethonin më thonin që je shumë e thjesht bëhu pak më mendjemadhe. Por unë mendoj që kjo vjen nga një edukatë familjare, pasi nëna dhe babai im kanë qenë njerëz mbi të gjitha modestë dhe të përulur. Madje mendoj që kjo ka qenë një nga madhështitë e tyre. Andaj siç janë prindërit ashtu do të bëhen edhe fëmijët sepse në jetë ata kanë qenë shembujt e mi. Unë se kam konsideruar famën si qëllim në vetvete, kam qenë shumë e lumtur që me anë të shembullit tim të tërheq afër vetes njerëz të mirë dhe pozitivë. Nuk e kam konsideruar veten të famshme, por lider dhe kam dashur të kem afër meje njerëz që kanë po të njëjtën energji si unë. Ndihem shumë mirë se kur shoh njerëz që kënaqen dhe them gjithë këto shkëndija lumturie njeriu s'ka fjalë dhe i shpreh ato me buzëqeshje.

A ka Inva Mula ndonjë peng nga karriera e saj?!

Pengje nuk kam, bëra një karrierë shumë më të rëndësishme nga ç'mund ta kisha imagjinuar dhe ëndërruar dhe në këtë drejtim nuk kam asnjë peng. Qëllimi i jetës sime është të gëzojë jetën dhe të tjerët, nëpërmjet artit dhe muzikës dhe tashmë ky është stili im i jetësës. Nuk më intereson më të bëj një produksion se kam bërë pafund të tillë, tani dua të bëj miq bashkë dhe të gëzoj me ta.

Ajo ka qenë gjithnjë e rrethuar me njerëz të mëdhenj të artit botëror, madje edhe në një nivel me ta. Por a ka patur Inva Mula një idhull botëror?

Placido Domingo ka qenë personazhi që kam adhuruar dhe që e takova shumë thjesht pa planifikuar që do ta takoja. Unë fitova edhe konkursin e tij si dhe konkursin tim të parë në Paris që hapi më pas dhe dyert e karrierës sime.

FËMIJËRIA E INVA MULËS

Në çdo intervistë të sajën sopranoja me famë botërore thotë se ndihet me fat që ka patur në jetë dy prindër si Avni dhe Nina Mula.

Nëna e saj ka qenë shumë kërkuese me të dhe motrën e saj të gjitha të ardhurat që ajo fitonte shkonin për kurset e tyre duke filluar që nga pianoja, frëngjishtja, anglishtja, italishtja e deri te rrobaqepësia. Ndërsa Avni Mula ishte një baba më tolerant, por që kishte autoritet si prind dhe artist.

Siç mësova lojërat e fëminisë mësova dhe muzikën, pra dashuria për artin ka ardhur në formën më të natyrshme tek unë. Një fëmijë e ka të vështirë të studiojë një instrument. Siç ka thënë edhe Rosini një nga vuajtjet për një fëmijë është që të studiojë një instrument. Në fillim ishin prindërit që më nxitën të mësoja pianon dhe më pas ajo u bë një domosdoshmëri për mua", kujton Inva Mula.



Ju e ruani ende pianon tuaj të parë, a luan sot vajza juaj Nina?! E pyes unë…

Jo nuk ka luajtur, piano e parë është piano ku babi im ka shkruar këngët më të bukura dhe i ka shkruar në një piano shumë modeste, që ka qenë instrumenti jonë i vetëm i familjes. Aty është ushtruar nëna ime, motra ime, unë dhe e ruaj si gjënë më të shtrenjtë.



NJË NËNË SI INVA MULA

Përveç artistes që ne njohim dhe që kemi parë të shkëlqejë në skenë, Inva Mula është edhe nënë e dy fëmijëve. Antoni ishte 3 muajsh kur ajo u detyrua ta linte të birin në Paris dhe shkoi të këndonte në Hamburg, Gjermani. Sot ai është 26 vjeç, një djalë shumë trendy dhe stil e që ka tërhequr vëmendjen e të gjithëve në Instagram. (Por nuk është beqar)…

"Antoni sa zgjohet në mëngjes luan Chopen dhe kjo është çudia. Ai thotë sa më shumë luaj muzikë klasike aq më shumë e perfeksionoj atë elektronike, sepse figurat më të bukura ritmike që gjenden në muzikën klasike, janë shkolla më e madhe prandaj them sa mirë që ai inspirohet nga muzika klasike", tregon plot pasion Inva Mula për gëzimin e saj të parë.

Ndërsa Nina erdhi si një dhuratë në jetën e saj atëherë kur ajo nuk e priste dhe sot është krah nënës së saj. Nina duket një fëmijë shumë energjik dhe është në krah të nënës edhe në këtë intervistë që jemi duke realizuar.

Por nga ndryshon Inva si mami me Antonin dhe Ninën?

"Ajo që ndryshon janë fillimisht dy gjenerata me 17 vite diferencë, ajo që nuk ndryshon dhe që mbetet konstante është dashuria e pakufishme që kam për të dy. Sa herë më thotë Nina kë do më shumë?! I them të dy bashkë. Antonin e kam si shok sepse me të mund të diskutojë shumë gjëra, por edhe Nina po më bëhet shoqe. Nina dhe shumë fëmijë të tjerë të pranishëm në MIK Festival këndonin njëzëri këngë "gold" të muzikës shqiptare dhe ky ishte një detaj që më ra në sy.

Nina jo vetëm e do shumë muzikën shqiptare por sa herë jemi të dyja në makinë duke bërë udhëtimet tona, të gjata apo qoftë edhe të shkurtra ajo zgjedh të vendosë gjithnjë muzikë shqiptare dhe i këndon me shumë qejf këngët tona", thotë Inva Mula.

PASIONET E REJA TË INVA MULËS

Njerëzit e suksesshëm dallohen gjithmonë dhe kudo. Thuhet gjithashtu se ata tregojnë edhe më të rinj nga sa janë në të vërtetë, po marrim këtu shembullin e Sophia Loren, Madonna, etj. Janë energjikë e gazmorë dhe mbi të gjitha optimistë për jetën. E nëse më sipër mora shembuj emrash të huaj, mund të them fare mirë se shembulli tipik shqiptar i një njeriu të suksesshëm është INVA MULA. Ajo ka shijuar çdo sekondë të artit të saj dhe tani është duke zbuluar disa pasione të reja në jetën e saj.


"Më pëlqen jeta e fshatit. Prej 4 vitesh shkoj atje dhe prashis, më pëlqen shumë kontakti me natyrën. Dhe jo vetëm për ta parë por edhe për të parë se si funksionon një gjë e tillë. E marr dhe Ninën me vete dhe i them duhet ta shohësh se si realizohet kjo gjë që ne hamë, shiko çfarë mundi është. Më pëlqen shumë edhe jeta e detit, sepse ne jemi njerëz pasionant, jemi gjatë gjithë kohës në lëvizje…"





Sa herë më thotë Nina kë do më shumë?! I them të dy bashkë. Antonin e kam si shok sepse me të mund të diskutojë shumë gjëra, por edhe Nina po më bëhet shoqe. Nina dhe shumë fëmijë të tjerë të pranishëm në MIK

FILMAT NGA "SKËNDERBE



Nga ERGYS ALUSHI

Filmat e parë u shfaqën në Shqipëri në qytetet Shkodër e Korçë, kur Shqipëria nuk ishte ende e pavarur. Shkodra ishte një nga qytetet më të mëdha shqiptare, rreth 40 mijë banorë, dhe zhvillonte tregti me shumë vende të rajonit.

Fotografi Kol Idromeno ka shfaqur filmat e parë në qytetin e Shkodrës. Ai fliste mirë frëngjisht dhe kishte letërkëmbim edhe me vëllezërit Lymierë, nga të cilët mësoi edhe për shpikjen e tyre, atë të kinemasë. Dokumenta të shkruara nuk ka, por dëshmi pas dëshmie kanë ardhur të dhëna se filmat e parë janë shfaqur prej tij në vitin 1908, ndoshta duke përfituar nga liria e paktë që dhanë xhonturqit që erdhën në pushtet. Nuk flitet për filma të mirëfilltë, por

...EU", "TANA", "FURTUNA", SI NISI KINEMATOGRAFIA SHQIPTARE




Kristaq Dhamo mbylli sytë në 14 gusht 2022, në moshën 89-vjeçare pak ditë përpara se ky numër i Newsbomb.al të binte në duart e lexuesve. Gazetari Ergys Alushi përgati këtë material për kinematografinë shqiptare, in Memoriam për regjizorin e madh, të parin e një filmi artistik shqiptar. Në rrugëtimin e krijimit të kinematografisë shqiptare që nga hapat e para të saj në fillim të shekullit të kaluar, Kristaq Dhamo ka skalitur me gërma të arta emrin e tij. Por si u realizua filmi "Tana" në qershorin e 1957? Si u zgjodh subjekti e protagonistët? Cilat kanë qenë përshtypjet e regjizorit? Në një rrugëtim të gjatë me artikujt e botuar në kohën e realizimit të filmave të parë, vijnë edhe historitë e disa filmave të zëshëm të asaj kohe...

për pamje të shkëputura nga vende të ndryshme të botës. Në Shkodër në këtë periudhë ekzistonte edhe një aparat kinematografik që ishte në pronësi të klerit katolik e përdorej prej tij për qëllime fetare. Në shtator të vitit 1912, Kol Idremeno ngriti kinemanë e parë me një aparat kinematografik që e mori me qira nga një austriak, duke shënuar kështu shfaqjet e para, me lejen e dhënë nga autoritetet turke.

Lufta e Parë Botërore, që shënoi hyrjen e ushtrive të huaja në vend, solli edhe hapjen e sallave të para të kinemave. Italianët e ngritën të parët një të tillë në Vlorë, aty ku është sot godina e teatrit të qytetit. Pati edhe në Korçë e Shkodër, më vonë edhe në Tiranë e Berat.

"Për herë të parë në vendin tonë, u çel kinema "Përparimi" në Vlorë në vitin 1920 nga pronari vendas Kojedhel Luari. Mirëpo autoritetet e asaj kohe, duke mos e vlerësuar rolin që loz kinemaja në jetën kulturore të popullit e penguan atë me anën e taksave të ndryshme të rënda, duke bërë që pronari i saj të mos ishte në gjendje t'i përballojë shpenzimet. Kështu që kinemaja u mbyll. Salla e saj e improvizuar mbeti për një



I PARI FILM
NË GJUHËN SHQIPE.
PRILL 1944



GAZETA E RE E
JANARIT 1929
INFORMON
PËR FILMIN
DOKUMENTAR
SHQIPTAR NË
AMERIKË

kohë në dispozicion të bashkisë së qytetit, ku zhvilloheshin mbledhje e veprimtari të tjera, por rrallë shfaqje filmash". ("Historia e kinemasë në Shqipëri", Abaz Hoxha, "Skena dhe Ekrani").

"Gazeta e Korçës" në shkurt 1928 njoftonte se një film i xhiruar në Shqipëri u shfaq në Boston, SHBA, dhe u prit shumë mirë. Ishte realizuar nga Jorgji Prifti, ndërsa bënte pushimet në Shqipëri. U transmetua fillimisht në një panair shqiptar në Boston dhe propagandonte bukuritë e vendit. Qëllimi – tërheqja e turistëve. E gjithë kjo pasqyrohej në "Gazeta e Re" në janar 1929. Filmime nga amatorë u kryen atëkohë dhe në Tiranë, Korçë, Shkodër, Vlorë e Durrës. Kamerat me të cilat filmohej ishin në pjesën më të madhe në pronësi të ushtarëve italianë, të cilët pas kapitullimit të Italisë, dezertuan duke u bashkuar në shumë raste me shqiptarët.

FILMI NË PUSHTIMIN E ITALISË

Krahas pushtimit ushtarak, Italia fashiste nxitoi të realizojë edhe pushtimin kulturor të Shqipërisë. Gazetat e kohës shkruanin për realizimin e filmit "Skënderbeu", një film që do të ngrinte lart rolin e heroit shqiptar. Xhirimet do të bëheshin në Shqipëri dhe skenari do të shihej në përfundim edhe nga shkrimtarë shqiptarë.

Një film tjetër, 'Kalorësi i Krujës" filloi të xhirohej në muajin maj të vitit 1940, me skenarist, regjisorë e aktorë italianë. Xhirimet u bënë disa pjesë në Krujë e Shkodër, të tjerat në një studio kinematografike në Firence. Subjekti i filmit i shërbente propagandës fashiste dhe mbështetej mbi fakte e ngjarje të pavërteta për zakonet e traditat shqiptare.

Gjatë muajve të parë të pushtimit, Instituti "Luçe" realizoi disa filma dokumentarë nga Shqipëria, ku spikasin "Ullishtat e Vlorës", "Miniera e Selenicës" etj. Në vitin 1942, në kinematë shqiptare u shfaq filmi "Bijtë e shqipes së Skënderbeut", me skenar të Mihallaq Mone dhe operator Alfredo Çeketi.

Termin "Shoqëri kinematografike" e hasim për herë të parë në vjeshtën e 1942 kur u krijua "Tomori film", në pronësi të italianit F.Tagliarini (zyrtar i lartë i qeverisë e propagandës fashiste), por që deklaronte xhirim filmash me subjekte shqiptare. Megjithë propagandën e madhe që iu bë krijimit të kësaj shoqërie, ajo realizoi vetëm një film të shkurtër, të xhiruar në Shën Naum, me një skenar të përgatitur nga Mihallaq Mone. Këto ishin shenjat e para të fillimit të një kinematografie shqiptare, e cila ende nuk i kishte kushtet për të qenë e tillë në vendin tonë, për shkak të mungesave të shumta, si në njerëz ashtu dhe në teknikë.

KRIJIMI I KINOSTUDIOS "SHQIPËRI E RE"

Në janar të vitit 1945, filmi u bë monopol i shtetit. Në prill të vitit 1947, u krijua ndërmarrja e parë kinematografike shqiptare. Në këtë vit shënohen edhe kronikat e para, të cilat përkuan me udhëtimet e udhëheqësit komunist në disa zona të vendit, në Jug të saj.

Ndërtimi i Kinostudios në vitin 1952 ishte një hap i rëndësishëm për të ardhmen e kinematografisë së vërtetë shqiptare. U fillua me dokumentarët. Ndër regjisorët e parë të filmit dokumentarë është Endri Keko, ku veçohen dy



FOTO NGA SHITJA
E BILETAVE PËR
SHFAQJEN TEATRORE
TOPAZI. TIRANË 1945

FORTEX
nutraceuticals

VITAMIN C 500 + ZINC + D3 DIRECT

PËRTHITHJE MAKSIMALE

Rrit imunitetin

Lufton viruset

Zn D3 C

- funksionimin normal të sistemit imunitar
- mbrojtjen e qelizave nga stresi oksidativ

Bustina të tretshme

Merret pa ujë

Shtesë ushqimore




NË GLORIA

VAZHDON SOT PREJ 6 DERI 12 TË NATËS FILMIN E

FESTIMEVE TE 25 vjetorit NË TIRANË

– Inaugurimi i Statujës të Skënderbeut – Arrijtja e N. M. T. Mbretit Zog I-rë në Sheshin Skënderbe – Fillimi i Parakalimit:

a) Vajzat e Institutit „Nana Mbretneshë" në krye me Princeshat Mbretnore
b) Paraushtarakët
c) Garda Mbretnore.
ç) Ushtëria – dhe Artileria me topat.

filmat e tij "Dritë mbi Shqipëri" (viti 1958) dhe kinopoemën e parë "Ringjallja" (viti 1961). Në dokumentarin e parë, regjisori Keko dhe operatori Jano Nano, xhironin punën e qindra të rinjve e të rejave, zhytur në baltë, tek betonizonin këmbët e digës së hidrocentralit "Lenin".

Sokrat Musha, operatori i parë, kujton: "Nëpër vendin tonë" *kështu quhej kinoditari ynë. Kronika e ditës ishte cast shumë i rëndësishëm për të ardhmen e kinematografisë sonë të re, për dhuratën e re që na bënte Partia. Atë ditë shoku Enver preu shiritin e inagurimit të Kinostudios "Shqipëria e re'. Ishte nder i madh për ne që filmuam atë moment historik të filmit shqiptar…Për të nxjerrë me sukses në ekran kinoditarin e parë, kolektivi i vogël krijues punoi ditë e natë dhe ia arriti qëllimit… Ajo kuti filmi me 300 metrat e para ishte angazhimi që ne punonjësit e kinematografisë merrnim përpara Partisë për të ecur më tej në rrugën e re. Në kinematë e qyteteve u shfaq kinoditari i parë. Urimet, vërejtjet qenë për ne shpërblimi që morëm atë ditë". ("Skena dhe Ekrani, viti 1982)*

KUR XHIROHEJ FILMI "SKËNDERBEU" (1953)

Ishte koha kur filluan xhirimet e filmit "Skënderbeu", një prodhim rus. Pakkush e di që filmi "Skënderbeu" ka fituar një çmim të rëndësishëm ndërkombëtar në Festivalin Ndërkombëtar të Kanës. Çmimi ishte për ngjyrat më të mira.

Lajmin e parë për çmimin e dha gazeta "Zëri i Popullit" në 4 prill 1954: *"Më 3 prill 1954, në Kanë është duke u zhvilluar Festivali i 7-të Ndërkombëtar i Filmit. Delegacioni sovjetik përbëhej nga G. Aleksandrov, Lubov Orlova, Sergei Jutkeviç, Akaki Horava, Klara Luçko dhe Litvinenko. Gazeta lokale 'Le Patriot' shkruan: 'Interpretim i shkëlqyer i Skënderbeut nga Akaki Horava, shfaqje e mirë e aktorëve të tjerë, muzikë e shkëlqyer dhe teknikë e lartë".*

Filmi u prit mirë në Europë, aq më tepër kur regjisori i filmit ishte Sergej Jutkjeviç, dhe në rolin e Skënderbeut luante një nga aktorët më të mirë të Bashkimit Sovjetik, Akaki Horava, që për famën e madhe që gëzonte në B.R.S.S. ishte zgjedhur dhe deputet. Asaj kohe filmi u shfaq në Francë dhe në disa shtete të Bllokut të lindjes, ndërkohë që Italia kërkonte ta shfaqte, por me disa shkurtime. Turqia tregonte indiferencë pasi Skënderbeu konsiderohej Tradhëtar. Jehona e filmit ishte e madhe, kudo ku shfaqej. Ende sot në Rusi, filmat ku Akaki Horava ka luajtur role, kërkohen e pëlqehen ende.

Për herë të parë në kinematë e Moskës filmi u shfaq më 28 nëntor 1953, në të njëjtën ditë që u shfaq dhe në Tiranë me një sukses të menjëhershëm. Përveçse regjizori dhe aktori kryesor ishin Rusë, edhe skenari ishte përgatitur nga autorë sovjetikë sipas historisë që kishin grumbulluar në Shqipëri.


Xhirimet e para janë luftimet me kuaj. Nga Bashkimi Sovjetik, Odesa drejt Durrësit u nisën anije të mëdha me grupe kuajsh që në qytetin bregdetar u pritën me kuriozitet. Kali i bardhë i përzgjedhur për t'u kalëruar nga Skënderbeu, ngordhi. Në të tilla kushte u përzgjodh një kalë tjetër me ngjyrë të bardhë. Xhirimet kryheshin në vende të ndryshme. Një pjesë e filmit do xhirohej në Tiranë, në liqenin artificial, në zonën e kishës së Shën Prokopit. Disa skena të tjera janë xhiruar në Durrës, (bregdet) dhe në Gjirokastër. Në jug, sovjetikët qëndruan në hotel "Sopoti", në sheshin me emrin e Çerçiz Topullit. *"Ardhja e aktorëve sovjetik shënohej e vlerësohej ngjarje për banorët të cilët i mirepritën dhe u treguan të gatshëm të bëheshin pjesë e skenave masive; veshur luftëtarë, me fustanella, në kështjellë në çatitë e shtëpive karakteristike dhe ne betejat e improvizuara në rrugët dhe sokakët me kalldrëm të qytetit",* shkruhet në median e kohës. Në xhirimet e filmit "Skënderbeu" vetëm tre aktorë ishin shqiptarë, Naim Frashëri që luante Palin, Besa Imami që luante Donikën dhe Adivije Alibali në rolin e Mamicës.

Filmi u dublua në gjuhën shqipe dhe në Premierën e tij në Tiranë në 28 nëntor erdhi regjizori rus Sergej Jutkjeviç, por jo aktori kryesor që luajti Skënderbeun. Arsyet e mosardhjes së tij nuk u mësuan ndonjëherë, por ai kishte ardhur më parë në Qytetin "Stalin" kur ishte shfaqur filmi para premierës zyrtare dhe ishte parë nga familjet ruse që ishin të shumta në qytet. Në kinema "Kosova" gjatë premierës ishte edhe udhëheqësi Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu.

Por, suksesi dhe bashkëpunimi zgjati aq sa zgjatën marrëdhëniet Shqipëri – Bashkim Sovjetik. Filmi u ndalua kur dy qeveritë shpallën armiqësinë me njëratjetrën. Kishte dhe një arsye tjetër: Asistent-regjizori



AFISHE FILMASH NË KINEMA PARTIZANI



KRISTAQ DHAMO, KINOREGJISORI I FILMIT TË PARË ARTISTIK ME METRAZH TË GJATË "TANA"

Krahas aktorëve të teatrit të shtetit u aktivizuan edhe 1000 figurantë nga populli, montazhierë, punonjës të laboratorit, elektriçistë e tjerë. Ndihmë të madhe në realizimin e filmit kanë kooperativistët e Lozhanit të Korçës, të cilët qëndruan dy ditë e dy netë në dispozicion të kolektivit të Kinostudios.

i filmit Viktor Stratobërdha dhe aktorja Adivije Alibali në rolin e Mamicës u shpallën "Armiq të regjimit" për qëndrimet që kishin mbajtur ata dhe familjet e tyre. Adivije Alibali u internua për vite të tëra nga regjimi, pas dënimit të bashkëshortit Jusuf Alibali.

"TANA" FILMI I PARË ARTISTIK SHQIPTAR

Para "Tana"-s, që njihet si filmi i parë artistik shqiptar, Kinostudio kishte realizuar filmat me montazh të shkurtër "Bijtë e saj" në 1957 dhe filmin dokumentar "Karl Marks" për hidrocentralin mbi lumin Mat.

"Tana" ishte film bazuar në subjektet e kohës, marrë nga novela e shkrimtarit Fatmir Gjata dhe për skenarin punuan Fatmir Gjata, Nasho Jorgaqi e regjizori Kristaq Dhamo. Kolektivizimi në fshat dhe ndryshimet në disa aspekte të jetës shoqërore ishin në qendër të filmit që kishte brenda dashurinë, urrejtjen, zemërimin, ligësinë, mentalitetet deri tek përdorimi i armës për të ndaluar një dashuri. *"Dhe kështu, më 1 qershor 1957, në majë të një kamioni u nisëm për në Korçë. Ngjarjet e filmit, personazhet, karakteret, koloriti, peizazhi i novelës "Tana" të Fatmir Gjatës dhe vet prototipet ishin nga fshatrat e këtij rrethi. Qysh në dimrin e vitit 1956 kishim vrarë mendjen për një subjekt filmi me shkrimtarin Nasho Jorgaqi. .. Në mes të këtyre kërkimeve na tërhoqi vëmendjen novela "Tana" me lirizmin e poezinë e saj, me konfliktin bashkëkohor, me figurën e vajzës së re fshatare, që ngrihet plot dinjitet mbi paragjykimet e së kaluarës. U lidhëm më shpirtërisht me të kur së bashku me autorin e veprës u njohëm së afërmi me Tanën e vërtetë, me të shoqin dhe familjen e saj. Fatmir Gjata nuk kishte trilluar, por kishte krijuar mbi të vërtetën jetësore" (Kristaq Dhamo, regjisor i filmit).*

Tinka Kurti, atëhohë një vajzë e re, luan personazhin kryesor Tana Premti. Kritika e vlerësoi paraqitjen e mirë që bëri në film, edhe pse vinte nga teatri. I dashuri i Tanës, Stefani, luhet nga aktori i madh Naim Frashëri, një djalë malësor, romantik që do të ndërtojë një jetë të re edhe pse e ka të vështirë se duhet të shkojë në fshat. Ndërsa Lefter Dhosi luhet nga i madhi Kadri Roshi. Në film ky personazh kërkon të martohet me Tanën dhe i ndikuar nga fjalët e njerëzve qëllon me armë mbi Stefanin me të cilin Tana kishte rënë në dashuri.

Xhirimet e filmit u kryen në atelienë ngjitur me Liceun Artistik. Janë skenat e kooperativistëve mbledhur në një klub ku dëfrejnë e kërcejnë. Stefani dashuruar me Tanën, nga dritarja sheh vajzën që kërcen me Lefterin, një kooperativist në fshat. Ata kërcejnë vallen e shamisë së beqarit dhe në kërcim e sipër Tana djeg shaminë dhe e mbështet kokën në supin e Lefterit. E gjithë skena xhirohet me mjeshtëri nga operatori Mandi Koço.

Mitropolia e Korçës refuzoi t'u jepte një veshje prifti. Aktori korçar Pandi Raidhi, mori përsipër ta zgjidhte këtë problem. Ai njihte një prift në zonë dhe duke sajuar një ngjarje të gëzueshme nga jeta e tij e ftoi priftin në ish-restorant "Krimea". Prifti ishte pijedashës dhe pas një dopio konjaku pranoi që t'ia jepte veshjen 'sa për një fotografi'. Në dopiot e tjera u krijua mundësia që të xhirohej gjithë pjesa tjerër, ende pa i dalë gjumi priftit.

FILMI "TANA" ËSHTË 2450 METRA I GJATË

Për xhirimin e tij u harxhuan 22.500 metra film. Në një skenë të filmit ku paraqitet një qen i egërsuar nga 6 metra film është dashur të shpenzohen 500 metra.

Kinostudio bëri një punë të madhe teknike: U ndërtua karela e parë rrethore, u modifikuan prozhektorët bashkë me aparaturën e sallës së dublimit e të inçizimit. Dekori i parë u ndërtua në garazhin e kinostudios, duke shfrytëzuar trarët për vendosjen e dritave. Kostumet dhe rekuizitët i morën nga kooperativistët e Bulgarecit, Mborjes, Drenovës. Për figurantë u përdorën masa e madhe e fshatarëve dhe qytetarëve, të cilët pra-



MARGARITA XHEPA NË ROLIN E ZYRAKËS, NË FILMIN "VITET E PARA"




MARGARITA XHEPA DHE SANDËR PROSI NË FILMIN "VITET E PARA", 1965

nonin me dëshirë dhe pa asnjë shpërblim. Edhe episodi i festës, është xhiruar në një festë të vërtetë, në Lozhan, në përvjetorin e batalionit territorial.

Xhirimet e filmit atëkohë u ndërprenë pas ndarjes nga jeta të aktorit të Teatrit Nikolla Panajoti. Ai luante rolin e rojtarit në film, por nuk e çoi dot deri në fund. "Ndodhi që na u sëmurë e na vdiq një nga aktorët më të mirë të komedisë e të estradës bashkëkohore, një aktor i mrekullueshëm karakteresh, Nikolla Panajoti. I përfshirë në valën e madhe të punës e të shqetësimeve krijuese, e mbajti të fshehtë krizën derisa mbaroi së xhiruari episodin, episodin e parë e të fundit. E rregulluam në atë mënyrë vijueshmërinë e personazhit të lënë përgjysmë prej tij, për ta ruajtur të paprekur të vetmin dokument filmik të këtij artisti me dhunti të shumta. Ai mbeti në film me zërin e tij, me humorin dhe këngën që edhe në jetë nuk i ndante nga goja". (Kristaq dhamo, regjisor i filmit)

Kur filmi u shfaq, pati një sukses të jashtëzakonshëm. Drejtori i Kinema "17 Nëntori" në Tiranë, Llazar Kenuti, në intervistë në median e kohës thoshte se nga 3 herë në ditë, filmi po shfaqej 5 herë në ditë për shkak të kërkesave. "Vetëm ditën e parë filmin e panë 3000 vetë, ndërsa në gjithë kinematë filmin e panë 8500 vetë".

"Tana" është filmi i parë shqiptar që ka të realizuar një puthje mes dy aktorëve. Një puthje që për mentalitetin shqiptar të kohës, ishte tabu. *"Është e vërtetë dhe kjo më bën krenare. Nuk pata asnjë hezitim kur tek filmi "Tana", nën një pemë i dhashë puthjen partnerit tim, aktorit të madh Naim Frashëri. Është puthja e parë në historinë e filmit shqiptar dhe kjo më bën të ndjehem vërtetë mirë. Ishte koha e tillë, mentaliteti që të pengonte për të realizuar skena të tilla. Megjithatë, edhe pse isha shumë e re, pasioni e bën aktorin të interpretojë edhe skena të tilla që tashmë janë të zakonshme", rrëfente vite më vonë aktorja Tinka Kurti në rolin e Tanës në film.*



PETRAQ LUBONJA, KINEAST, 20 FILMA NË 14 VJET



"Sigurisht që nuk ishte e lehtë. Madje ju them se për të bërë atë puthje, n'a u desh të realizonim 29 dubla dhe fatkeqësisht skenën e hoqën më pas. Zemërohem me vete dhe them: "Mirë atëherë që nuk lejonte koha dhe regjimi, po sot, përse nuk jepet puthja ime me Naim Frashërin?"

"FURTUNA" SHQIPTARO – SOVJETIKE (1959)

Në ditët e para të marsit të vitit 1959, nisën xhirimet e filmit të ri shqiptaro-rus, "Furtuna". Xhirimet e para të skenave të dimrit nisin në malet e Bogës, në Shkodër. Zana, personazhi kryesor e heroina e filmit, u luajt nga Ana Shëngëllaja që kishte interpretuar më parë rolin e Tatianës në filmin "Evgjen Onjegin". Një tjetër aktor sovjetik Griçenko luante rolin e oficerit britanik, ndërsa oficerin e misionit sovjetik e luante Kuznjeçov.

Naim Frashëri dirigjonte kastën e aktorëve shqiptarë në rolin e Hajdarit, udhëheqës i partisë dhe përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm; Pjetër Gjoka vjen në rolin e Rrapos, komandatit fshatar të batalionit, Llazar Filipi në rolin e fshatarit Demir; Sulejman Pitarka si ideolog i Ballait Komnbëtar në rolin e Eshref Beut; Loro Kovaçi në rolin e Xhavit Agës drejtues ushtarak i Ballit; Liza vorfi në rolin e një gruaje fshatare të varfër e cila strehon Hajdarin e plagosur dhe nuk e tregon, megjithëse i marin vajzën e vetme; Mihal Popi në rolin e gjeneralit fashist Italian Luçiano. Vangjel Heba në rolin e Vasilit, djalit të shkathët gazmor e trim që vritet për të shpëtuar shokët lart në mal dhe Nikolin Xhoja në rolin e një fashisti Italian.

Në rolin e Arbenit, një nga personazhet kryesor të filmit, është përzgjedhur të luajë student i Institutit të lartë të fiskulturës Mario Ashiku dhe në rolin e Shpresës e dashura e Vasilit është përzgjedhur studentja e Institutit pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës, Filika Dimo.

Filmi fillon me xhirimet e skenave masive të operacionit të dimrit ku angazhohet populli i krahinës dhe repartet e Ushtrisë Popullore.

Malësoret e Bogës ishin mësuar të shihnin banorë të Shkodrës apo rrethinave që vinin ndonjëherë për pushime, por u çuditën së tepërmi kur panë makina të mëdha, vinça, ushtarë e shumë gjera të tjera. Popullata u shtua ndjeshëm me shqiptarë e rusë e zona u gjallërua. Në skenat e filmit vjen një betejë e vërtetë lufte, dhe për të u angazhuan edhe njerëz që



‘Për ndihmesën e shquar që ka dhënë në zhvillimin e artit tonë kinematografik, duke krijuar me nivel të lartë ideoartistik shumë filma që e bëjnë kinematografinë një art militant, të dashur, pasqyrë të gjallë të epokës së ndritur të Partisë, armë e fuqishme për edukimin komunist të masave punonjëse”

kishin marrë pjesë në luftë siç ishte kolonel Lefter Kasneci që u tregon aktorëve skenat e taktikat e luftës. Edhe Naim Frashëri, që dikur kishte qenë në çetat partizane jep maksimumin të interpretojë sa më bukur rolin e komandatit të luftëtarëve.

Filmohet natë e ditë dhe regjizori rus Ozerov ishte shumë kërkues ndërsa konsultohet edhe me regjizorin e ri Kristaq Dhamo e skenaristin Fatmir Gjata që ndihmohej nga Juri Ozerov d h e Llazar Siliqi. Ndërsa muzika e filmit mban emrin e të madhit Çesk Zadeja dhe G.Popov. Filmi dhe sot e kësaj dite ruan madhështinë e skenave dhe fuqinë e transmetimit të mesazheve.

PËR HERË TË PARË NJË ÇMIM NË FESTIVALIN BOTËROR

Kinematografia shqiptare kishte pak më pak se një dekadë që kishte lindur, por kjo nuk pengoi dy kameramanët shqiptarë Dhimitër Anagnosti dhe Viktor Gjika që punën e parë të diplomës “Njeriu kurrë nuk vdes” ta paraqisnin në Festivalin Botëror të shkollave Kinematografike në Hollandë (1961) e të marrin çmimin e parë.

Artisti i Popullit, Dhimitër Anagnosti është një ndër regjisorët më të mirë shqiptar të të gjitha kohës. Ai lindi më 23 janar 1936 në fshatin Vuno të Himarës. Që në shkollë karakterizohej nga pasioni i madh për letërsinë, prandaj ëndrra e tij u bë realitet kur vazhdoi Institutin e Kinematografisë, dega kamaraman në një shkollë jashtë vendit.

Pas marrjes së çmimit të parë, ai bashkë me Viktor Gjikën ishin operatorët në filmat “Debatiku’, “Toka Jonë”, “Komisari i dritës” (operator dhe regjisor) bashkë me Viktor Gjikën, i vlerësuar me urdhërin “Naim Frashëri”, klasi II, 1966, në filmin “Duel i Heshtur”, regjisor, “Plagë të vjetra’, skenarist dhe regjisor, vlerësuar me çmimin e Republikës, klasi II, 1970, “Cuca e maleve”, film-balet, skenarist dhe regjisor; “Lulëkuqet mbi mure”, regjisor.

Ky është cilësuar filmi më i mirë i Festivalit të dytë të filmit artistik shqiptar, ku mori çmimin e Republikës, klasi i parë, 1979, ka marrë çmimin e madh në Festivalin e Beogradit dhe “Medaljen e Artë” në Xhifoni të Italisë më 1985. Ka edhe shumë e shumë filma të tjerë duke përfshirë edhe filma dokumentarë, ku është vlerësuar me shumë çmime jashtë e brenda vendit. Në vitin 1979 mori titullin “Artist i Merituar”, ndërsa më 1987 “Artist i Popullit”.

“ZANA DHE MIRI” – FILMI I PARË VIZATIMOR

E ndërsa filmi artistik kishte marrë udhë, për fëmijët, Kinostudio “Shqipëria e Re”, nuk kishte lëvizur akoma. Në vitin 1975, në një prej atelieve të Kinostudios u hodhën hapat për lindjen e filmit vizatimor shqiptar. “Zana dhe Miri” shënoi fillimin e një epoke të re në suksesin e prodhimit të filmave vizatimorë.

Në vitin 1987 numri i filmave vizatimor arriti në 16, duke ndikuar në zgjerimin e atelieve dhe pajisjen e tyre me aparatura


KOMBIT

I pari film në gjuhën shqipe

NË GLORIA SOT OPERETA GJERMANE Ufa

Vagabondat Shëtitës

ME

Lilian Harvey — Willy Fritch


MUZIKË E KËNGË — KRYEKËPUT

SUPLIMENT JOURNAL FOX me evenimentet e fundit: a) Mbytja e vaporit Amerikan PANAY nga Aviasioni Japonez — Martesa e Princit të Greqisë Paul me Frederikën Luiza — HITLERI në Munchen etj. etj.

ORA 7-9 dhe 9-11

SË BASHKUT DHE FILMI ME Boris Karlof

Dhoma e Zezë



NË REPARTIN E FILMIT VIZATIMOR



NË REPARTIN E ZËRIT

moderne, si edhe shtimin e krijuesve.

Ndër filmat janë: "Pika e ujit", "Zhgarravinat", "Mirela", "Çufo dhe bubi kaçurrel", 'Llustra – llustra", "Dy gostitë", "Pushëbardhi", 'Lodrat dhe Miri" e të tjerë.

Secili nga piktorët, Bujar Kapexhiu, Gazmend Leka, Boris Ikonomi, Esperanca Konomi, Artan Maku, Artur Dauti, Artur Muharremi e të tjerë ndër vite, kishin stilin e tyre të veçantë që i dallonte nga njëri – tjetri.

14 FILMA NË VIT!

Në vitin 1982 prodhimi vjetor i kinematografisë shqiptare ka arritur në 14 filma artistikë, që përbën një nga shifrat më të larta në Evropë dhe në botë për milionë banorë.

Kështu, për 1 milion banorë tek ne i takon 5.6 filma artistik. Në RFGJ i takon 0.8 filma për 1 milion, në SHBA 0.94, në Jugosllavi 1.36. Në shifra të ulta ishin edhe shtete të tjera si Anglia që prodhonte 41 filma, Hollanda 13, Finlanda 11, Danimarka 10 e të tjera.

Më vitin 1945 në Shqipëri funksionin rreth 17 kinema ndër të cilat vetëm 4-5 ishin relativisht të përshtashme, ndërsa të tjerat ishin salla të improvizuara në kushte të papërshtashme teknike dhe higjenike. Në vitin 1982 në shqipëri numëroheshin 410 kinema e kinolëvizëse, që japin filma deri në skajet më të largta të vendit


Kinostudio "Shqipëria e re" është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me urdhërin e Flamurit, me motivacionin: *'Për ndihmesën e shquar që ka dhënë në zhvillimin e artit tonë kinematografik, duke krijuar me nivel të lartë ideoartistik shumë filma që e bëjnë kinematografinë një art militant, të dashur, pasqyrë të gjallë të epokës së ndritur të Partisë, armë e fuqishme për edukimin komunist të masave punonjëse".* Në 40 vjetorin e krijimit të kinematografisë shqiptare, më 13 prill 1987, iu dha titulli "Artist i Popullit' regjisorëve Dhimitër Anagnosti, Kristaq Dhamo. Titullin "Artist i Merituar' Lionel Konomi, Ibrahim Muça, Kristaq Mitro, Marianthi Qemo, Gëzim Erebara, Donika Muçi, Vlash Dubroniku, Bujar Lako, Timo Flloko, Shyqyri Sako.

KINOAKTORËT SOVJETIK NË QYTETIN "STALIN"

Në gusht 1958 në Tiranë mbërritën kinoaktorët sovjetikë Boris Andrejev dhe Zinaida Kirienko që u pritën nga udhëheqësit më të lartë komunistë. Ata vizituan Durrësin, Korçën, Vlorën e Qytetin Stalin. Ky qytet ishte i preferuar prej sovjetëve jo veç prej emrit por edhe sepse kishte shumë shtetas rus. Në kinemanë verore "18 tetori", dy aktorët dolën përpara turmës. "Jam shumë i gëzuar që takohem me punonjësit e naftës. Ky është fryt i miqësisë i vendosur për jetë të jetës midis të dy vendeve tona nga partitë tona marksiste leniniste" tha para turmës aktori Boris Andrejev.



ÇASTE PUNE NË STUDION E GRIMIT



ASLLANI I INTERIT

ËNDRRA E NJË NATE VERE E KRISTJANIT ELBASANAS

Nga RETIN TOKA

Ishte data 9 mars i vitit të largët 2022. Në një familje të thjeshtë elbasanase kishte gëzim të madh. Në jetë kishte ardhur djali i parë i shtëpisë, Kristjani. Babai Gentiani kishte emigruar afro 1 vit më parë drejt Italisë. Peripecitë dhe jeta e vështirë në Shqipëri e kishin detyruar t'i ngjitej gomones për të kërkuar më të mirën për familjen e tij. U vendos në Piza me shpresën se do të punonte dhe do të merrte përtej Adriatikut edhe bashkëshorten me djalin e sapoardhur në jetë. Ditët e para ishin të vështira për të. Si çdo emigrant tjetër i duhej të punonte fort për të përballuar jetesën. Vështirësinë ia shtonte më shumë edhe dëshira për të parë djalin e porsalindur.

Kristjani i vogël erdhi në jetë pikërisht në datën 9 mars, ditën kur ka lindur edhe klubi i Interit. Koiçidencë e bukur... Askush s'e kishte menduar se një ditë, një djalë i urtë nga një familje e thjeshtë elbasanase do të vishte fanelën zikaltër. Por, fati e paska pasur të shkruar që ai t'i bashkohet ekipit që ka lindur në të njëjtën datë me të. Historia e jetës së Kristjanit është sa e bukur, aq dhe emocionuese. Edhe pse është shumë i zënë për shkak të përgatitjeve intensive me Interin, 20-vjeçari mban fjalën dhe gjen kohën për të treguar jetën e tij në një rrëfim enkas për revistën Newsbomb.al. Ashtu si në fushë, është i qetë dhe kujton me detaje hapat e të parë e deri sot që është në "gojë" të Europës për atë që ka treguar në fushën e blertë.

LARGIMI NGA SHQIPËRIA, ZHVENDOSJA NË ITALI

Babai Gentiani në emigrim bëri gjithçka dhe pas 2 vitesh ia doli që të merrte me vete edhe familjen. Kristjani ishte i vogël dhe nuk mund të përcaktonte drejtimin në jetë. Fillimisht futet në kopësht në Piza. Pasioni i babait për futbollin bëri që në moshën 5 vjeç e gjysmë ta fuste me moshat e shkollave. *"Pasioni im për futbollin nisi nga televizori. Shihja shumë ndeshje dhe dalëngadalë nisi të më pëlqente. Kur kam marrë topin për herë të parë në dorë, kuptova që ishte lodra e duhur për mua. Më vonë nisa të shkoja me babain në stadium dhe kështu lindi dëshira më e madhe për të qenë edhe unë një ditë në fushë",* tregon fillimisht 20-vjeçari.



Me zikaltërit kishte një lidhje të pashpjegueshme. Fati i kishte sjellë paralelisht në të njëjtën datë në "jetë". Ndoshta siç thonë e kishte të "shkruar" që shqiptari do të ishte vetëm i interistëve. Në atë vit, Inter do të përballej me Bayern Munchen në finalen e madhe të Champions League. Zikaltërit triumfuan duke marrë tripletën e famshme me Jose Mourinhon

Si çdo gjë që nis për herë të parë, edhe për Kristianin e vogël ishte e vështirë. Në Piza ishte një akademi që mbikëqyrej nga klubi i Fiorentinës. Ai nuk e mban mirë këtë moment, por nga ajo që i ka treguar i ati, rrëfen se i është dashur të udhëtonte rreth 7-8 kilometra çdo ditë. *"Babai punësoi një mik tonin për të më çuar me makinë në stërvitje. Edhe mami ishte në punë dhe nuk kishte mundësi tjetër"*, vijon më tej. Në fund të vitit 2007-të vjen në Piza, Akademia e Empolit për të provuar lojtarë të prespektivës. Pikërisht këtu nis gjithë historia e suksesit për elbasanasin e vogël që tashmë po çon lart emrin e Shqipërisë në arenën europiane.

FIORENTINA DHE EMPOLI, ZGJEDHJA E PARË E MESFUSHORIT

Kristiani duhej të zgjidhte mes Fiorentinës dhe Empolit. Babai ishte tifoz i futbollit italian, por për të vendosur për djalin e kishte të vështirë. Kishin miq që luanin në Seria A. Fati deshi që afër tyre të ishte një djalosh që kishte kontribuar për Fiorentinën, ndërsa më vonë me Torinon. Pikërisht ky mik u bë shkak që Kristiani t'i bashkohej Empolit, duke qenë se Akademia e tyre ishte shumë më e mirë se e Fiorentinës.

"Fillimet kanë qenë shumë të vështira. S'e besoja asnjëherë se do të arrija këtu ku jam sot. Por, punoja çdo ditë për të arritur sa më lart. Realisht nuk ka qenë aspak e lehtë. Ka pasur shumë momente të vështira. Por, jam mbështetur shumë nga familja ime", mes emocioneve Kristiani vijon më tej: "Babai më ka qëndruar gjithmonë pranë. Asnjëherë s'më ka kritikuar. Më ka lënë të lirë në aspektin profesional për të mos më ushtruar trysni". Si çdo vogëlush, edhe në familjen e Asllanit rëndësi kishte edhe formimi arsimor për djalin e tyre. Duke qeshur Kristiani tregon: "Më kritikonin shpesh për mësimet. Megjithatë unë e kisha mendjen vetëm te futbolli. Nëse mund të thuhet, jam dashuruar me shikim të parë me të".

EMPOLI, PIKËNISJA E HISTORISË SË SUKSESIT

Në moshën 7 vjeçare e gjysmë, Asllani transferohet te Akademia e Empolit. Aty e provojnë si fantazist pas sulmuesve, si mesfushor qëndre, por në fund e vendosin si lojtarin që bën urën lidhëse mes mbrojtjes dhe mesfushës. Kristiano Filipi ka qenë trajneri i tij te ekipet zinxhirë. Tekniku italian e kujton që në vegjëli lojtarin shqiptar si djalë të shkathtë dhe mjaft të përqëndruar në punën e tij. Serioziteti në familje ishte pasqyruar dhe te edukimi i Asllanit. Edhe pse ish-trajneri i tij flet me nota pozitive, Kristiani ka qenë shumë i vogël për ta mbajtur mend.

"Në fillimet e mia s'mund të kujtoj profesorin që kam hedh hapat e parë. Por, më vonë mund t'iu tregoj se nisa të punoja si kamarier në një lokal aty në fshat. Ishte i trajnerit Filipi. Poshtë banakut mbaja edhe një top. Në kohën e lirë mundohesha të ushtrohesha me të. Një herë më gjeti pronari që ishte edhe trajneri im teksa luaja me disa klientë dhe njërin prej tyre e driblova me tabaka në dorë", thotë duke qeshur. Ndërsa Filipi për mediet italiane e përshkruan: "*Unë kisha një biznes timin, një lokal. Kristjani luante që i vogël aty pranë me fëmijët e tjerë. Gjithmonë e ndiqja me kujdes. E shihje gjithë ditën me top duke xhongluar e dribluar djemtë e tjerë. Në një rast arriti të driblonte me një tabaka mbi duar brenda lokalit… Dua të theksoj gjithashtu se ai u rrit në një familje serioze*".



Ka pasur shumë momente të vështira. Por, jam mbështetur shumë nga familja ime", mes emocioneve Kristiani vijon më tej: "Babai më ka qëndruar gjithmonë pranë. Asnjëherë s'më ka kritikuar. Më ka lënë të lirë në aspektin profesional për të mos më ushtruar trysni"

TALENTI, TRAMPOLINA E TË ARDHMES SË NDRITUR

Në Akademinë e Empolit, Asllani ra shpejt në sy. Që te moshat dhe më vonë dalëngadalë ngjiti shkallët e karrierës. Provoi çdo fanelë të ekipeve zinxhirë deri te U-19. Trajneri i fëmijëve Francesco Pratali e drejtoi menjëherë te klubi i Presidentit Corsi për një kontratë profesioniste. Më vonë u grumbullua në ekipin e parë. Nuk mungoi ftesta as nga Kombëtarja U-19 dhe më tej nga kuqezinjtë e Edy Rejës. Në sezonin 2021-2022 arriti të zinte edhe vendin e titullarit. Ishte vetëm 19-vjeç. Në Itali flisnin me superlativa me të.

Qetësia që e karakterizon "joshi" edhe gazetarët më me emër përtej Adriatikut. Cilësitë në fushë ishin të padiskutueshme. Fati ka qenë në anën e Kristjanit duke mos pësuar asnjëherë dëmtim serioz. "Kam punuar ditë pas dite. Më pëlqen të qëndroj i vetëm, të jem i qetë për t'u fokusuar në gjërat që dua të bëj. Me futbollin kam pasur shumë mbështetje nga familja ime. Nuk kam pasur dëmtime serioze. Kohën që kaloj me futbollin ia kam borxh familjes sime sepse e konsideroj si gjëja më e shtrenjtë për mua". Rrëfimi i tij është emocionues, aq sa disa herë mbetet pa fjalë përmes telefonit. Shkëlqimi te Empoli ra në sy të gjithë Europës. Mediet e huaja nisën aludimet e para.

INTER, DASHURIA E HERSHME E KRISTJANIT

Në vitin 2010-të, Kristjani ishte vetëm 8 vjeç. Me zikaltërit kishte një lidhje të pashpjegueshme. Fati i kishte sjellë paralelisht në të njëjtën datë në "jetë". Ndoshta siç thonë e kishte të "shkruar" që shqiptari do të ishte vetëm i interistëve. Në atë vit, Inter do të përballej me Bayern Munchen në finalen e madhe të Champions League. Zikaltërit triumfuan duke marrë tripletën e famshme me Jose Mourinhon. *"Kisha dalë me babain për të ndjekur finalen e Champions League. Isha 8 vjeç dhe ecja në majë të gishtave në lokal, po përpiqesha të shihja një pjesë të ekranit ku transmetohej ndeshja. Atë natë kuptova se e doja këtë ekip (Interin). Mund të ndjenim karriget që dridheshin mbi pllaka kur Milito tregoi me gisht Van Buyten, atëherë nuk kuptuam më asgjë. Mbaj mend që disa gota fluturuan në tokë dhe unë u hodha përpjetë"*, flet mes emocionesh talenti i kombëtares shqiptare. Me zikaltërit duket që ka qenë i lidhur që në "embrion". Teksa ishte pjesë e Empolit tek të rinjtë, ai i kishte shënuar Interit duke i eleminuar në gjysmëfinale. *"Brenda një viti fitova kampionatin me të rinjtë (Empoli), duke eliminuar Interin në gjysmëfinale me një gol nga goditja e lirë; shënova golin tim të parë në Serinë A kundër Interit dhe në fund u vesha zikaltër, por i tillë kam qenë gjithmonë. Kam fjetur me topin nën krahë, mbuluar me batanije, siç bëjnë fëmijët për t'u mbrojtur nga përbindëshat e natës".*

SINJALET E PARA ZIKALTËR

Paraqitjet pozitive te Empoli bënë që drejtuesit e Interit ta piketonin shqiptarin para përfundimit të sezonit. 23 ndeshje të luajtura, 14 prej të



cilave nga minuta e parë. 1 gol i shënuar dhe 1 asist i dhënë bindën interistët që ky lojtar duhej të bëhej pjesë e tyre. Fillimisht ishin gazetarët italianë që raportuan interesin e drejtorit sportiv Marotta për 20-vjeçarin. Askush s'e besonte, madje as vetë Asllani. Gjithmonë tentonte të qëndronte me këmbë në tokë. "Kam ëndërruar që tifozët të bërtisnin emrin tim kur të firmosja me Interin. Pak ditë më parë zbulova se nuk ishte ëndërr. Babai më çoi për herë të parë në Milano për të parë një derbi shumë vite më parë, ne fituam 2-1. Ai u kthye aty kur shënova golin tim të parë në Serinë A, disa muaj më parë", thotë ai. Si një lojtar profesionist kërkon të jetë diskret në lidhje me negociatat me klubin zikaltër. Nuk kujton se si është kontaktuar, ndoshta s'do ta bëjë diçka të tillë duke treguar se është ngjitur në nivelet e një profesionisti që në Shqipëri janë të rrallë. "Nuk mund ta kujtoj se kush më ka kontaktuar i pari nga Inter. (Qesh). Është marrë menaxheri im, bashkë me babain. Detyra ime është të jap maksimumin me topin", shton më tej ai.

30 QERSHOR 2022,
KRISTJAN ASLLANI ZYRTARISHT INTERIST

Thashethemet për transferimin e Kristjan Asllanit te Interit nisën të bëheshin gjithmonë e më të shumta. Reagimet nga klubi zikaltër lanë të kuptonin se interesi për shqiptar ishte real. Drejtori Giuseppe Marotta e vlerësonte maksimalisht dhe fillimisht po tentohej huazimi i tij. Por, cilësitë në fushë bënë që drejtuesit të ndryshonin mendje. Asllani do të huazohej, megjithatë në fund të sezonit janë të detyruar të blejnë kartonin e tij. Dhe kështu ndodhi. Në datën 30 qershor, mesfushori i Kombëtares u prezantua si zikaltër duke firmosur kontratën e jetës me Interin. Ëndrra e një nate vere u bë realitet. Emocionet ishin të papërshkrueshme jo vetëm për Kristjan Asllanin dhe familjen e tij, por për gjithë shqiptarët anë e mbanë botës. Një 20-vjeçar do të përfaqësonte gjakun kuqezi në arenën ndërkombëtare me një klub gjigant si Interi. Ndjesitë e asaj dite janë ende të gjalla në trurin e Kristjanit që tregon: "Mirë se erdhe tek Interi!", ky ishte mesazhi I Javier Zanettit. Desh më ra të fiktë. Ishte një ëndërr për mua. Ende s'arrija ta besoja. Ishte gëzim i madh. Udhëtova drejt Milanos me babain. Po atë ditë u gjenda në një dhomë me Romelu Lukakun. Ende s'mund ta besoja. Kisha veshur një fanelë të Interit dhe prisja të firmosja. Pak e kuptova se ç'po ndodhte. Vëmendja kryesore nuk ishte vetëm te unë, pasi në atë periudhë kaloi edhe Romelu te Inter". Me zikaltërit u përshtat mjaft mirë. Ju duk sikur kishte një jetë

"Brenda një viti fitova kampionatin me të rinjtë (Empoli), duke eliminuar Interin në gjysmëfinale me një gol nga goditja e lirë; shënova golin tim të parë në Serinë A kundër Interit dhe në fund u vesha zikaltër, por i tillë kam qenë gjithmonë. Kam fjetur me topin nën krahë, mbuluar me batanije, siç bëjnë fëmijët për t'u mbrojtur nga përbindëshat e natës".

aty. Ngrohtësia dhe pritja e mrekullueshme e shokëve të skuadrës i krijuan klimë pozitive Asllanit. "Jam shumë i lumtur që jam këtu. Shpresoj të bëj mirë dhe të jap maksimumin tim. Dua të ndihmoj Interin për arritjen e objektivave. Me trajnerin Inzaghi po punojmë shumë", shton më tej ai. Gjithë këtë sukses, padyshim arritje të jashtëzakonshme Asllani ia dedikon familjes së tij. "Teksa firmosja me Interin në mendje më erdhën vështirësitë që kemi kaluar. Babai im ka ardhur me gomone në Itali, ndërsa më vonë mbërrita unë me mamanë time. Jam shumë i lumtur që jam këtu dhe kam pranë familjen time. Njerëzit flasin për kontrata të majme, shuma eurosh, por në fakt unë s'i mendoj lekët aspak. Gjithë këtë sukses ia dedikoj familjes sime që më ka mbështetur në çdo hap që kam hedhur".

FTESA NË KOMBËTARE, MARRËDHËNIA DHE OBJEKTIVAT KUQEZI

Një lojtar si Asllani nuk mund të lihej asesi pa qenë pjesë e Kombëtares. Ai u pikas nga scoutet shqiptarë që te moshat e Empolit. Fillimisht u ftua nga përfaqësuesja U-19 dhe më vonë nga trajneri Edy Reja. Në mars të këtij viti, Kristiani u grumbullua në kombëtaren e madhe duke bërë realitet tjetër ëndërr në jetë. Si më i vogli i skuadrës u prit mjaft mirë nga lojtarët kuqezi. Aty kishte shumë miq që e kishin këshilluar për karrierën e tij. "Te Kombëtarja më pritën mirë. Jemi një grup fantastik. Shokët e mi më të ngushtë janë Bajrami, Ismajli pasi kemi luajtur bashkë në Itali me Empolin. Gjithashtu edhe Hysaj është një mik i mirë. Kam shumë vite që e njoh", shprehet ai.

Asllani është nga ata futbollistë që nuk ka një idhull për mënyrën se si do të luajë në fushë. Ai dëshirojë të krijojë modelin unik. "Ç'është e vërteta nuk kam një idhull. Dua të krijoj modelin tim dhe të jap më të mirën për Interin", shton më tej. Kombëtarja shqiptare ka grupin më të mirë që ka pasur ndonjëherë ndër vite. Lojtarë që luajnë në kampionate elitare europiane që kanë potencialin për të çuar Shqipërinë mes më të mirave. Sa larg mund të shkojë kjo skuadër? Asllani nuk kërkon të shohë tutje: "Nuk e di sa larg mund të shkojmë, por kemi një skuadër të mirë. Ka futbollistë me përvojë. Mund të vecoj Nedimin (Bajramin), Ismajlin, Hysjan, Gjimshitin, Kumbullën e të tjerë që formojnë një ekip të fortë. Mund të bëjmë gjëra të bukura bashkë". Tifozët janë oksigjeni i çdo skuadre si në nivel përfaqësues, ashtu edhe në nivel Kombëtar. Asllani ka një mesazh për ta: "Ju ftoj të vini gjithmonë në stadium. Të jeni të shumtë e të na mbështesni siç keni bërë deri më tani. Jeni fantastikë!".

PIKA E DOBËT E KRISTIANIT DHE JETA SENTIMENTALE

Emigrimi i babait në vitet 2000 krijoi një boshllëk të madh në shtëpinë e Kristianit. Mamaja e vetme s'mund të përballonte rritjen e të birit, por gjithashtu t'i jepte drejtim shtëpisë. Një kontribut të madh kanë dhënë dy gjyshërit e Asllanit. Ata vijojnë të jenë në jetë dhe ndryshe nga familja e lojtarit, kanë zgjedhur të qëndrojnë në Elbasan. Janë pika e dobët e mesfushorit. Me zërin që i dridhet tregon sa i përmalluar është. "Kam gjyshin dhe gjyshen në Elbasan. I dua shumë. Kur isha i vogël, rrija çdo ditë me ta. Deri 2 vjeç mund të them që më kanë rritur. Më merr malli shumë. Vij çdo vit dhe i vizitoj, por nuk më mjafton të shmallem. Futbolli më merr shumë kohë dhe nuk mundem të vij në periudhë tjetër", flet i emocionuar Kristiani. Një djalë kaq i përfolur është e pamundur të mos ketë edhe një vajzë në krah. Por, me sa duket hë për hë duket se nuk dëshiron të "tradhëtojë" dashurinë e tij të parë, futbollin. Kristiani nuk është i dashuruar. Këtë e thotë duke mos hezituar aspak. Përkundrazi. "Nuk jam në një lidhje. Nuk jam i dashuruar", shprehet i prerë. Me sa duket vajzat italiane, por edhe shqiptare do ta kenë të vështirë ta ndajnë nga lodra e parë, topi i futbollit. Le të presim. Fillimisht të shijojmë sukseset e tij profesionale.

Historia e Kristjan Asllanit është provë se si suksesi arrihet gradualisht duke i ngjitur shkallët njëra pas tjetrës. Fillimet mbeten gjithmonë të vështira. Dëshira dhe këmbëngulja për të arritur gjithmonë objektivin, janë ccelësi i suksesit. Përvoja jetësore e lojtarit kuqezi tregon se si peripecitë dhe vështirësitë e jetës, një ditë gjithmonë shpërblehen. Ndaj, le t'i besojmë kohës, pasi është e vetmja që u jep zgjidhje të ëmbla edhe situatave më të vështira.



Jumpsuit- e dhe aq

Jump-et janë ideale në këtë moment të vitit. Me taka, me atlete dhe mbi të gjitha me shumë akesorë do të dukeni perfekt me to.



Gusht e gunë...

Nga SUADA DACI

Kështu thuhej dikur me të hyrë muaji gusht. Edhe pse jemi në fund të verës, ende me thënë të drejtën nuk jemi gati për të paketuar kanatjerët e fustanet me rripa, sepse temperaturat e larta vazhdojnë të jenë ende prezente në të gjithë vendin (dhe jo vetëm). Ju do thoni po ti pse me xhaketë?! Fillimisht kam zgjedhur një xhaketë lino, me ngjyra të pastra verore (e kaltra është e preferuara ime) dhe së dyti është ideale për mbrëmjet e freskëta për ta veshur qoftë me pantallona lino ose edhe me xhinse të shkurtra. Megjithatë në vijim ju do t'ju japim disa këshilla se si të visheni në këto ditë të fundit të gushtit. Shfrytëzojini dhe pak ditë se vitin tjetër jam e sigurt që do t'ju dalin nga qejfi këto outfite... (Të paktën unë nisem nga eksperienca ime)



Çantat e vogla

Mbajini edhe për pak kohë çantat e vogla sepse në dimër nuk ju nxënë asgjë. Që prej periudhës së karantinës kemi parë që të gjithë kanë filluar t'i përdorin ato në maksimum dhe do të vazhdojmë t'i kemi prezente edhe përgjatë kësaj periudhe. Veshja juaj do të duket më stil.





Lino, lino dhe vetëm lino

Mblidhini linot nga i keni nga si keni dhe vishini edhe këto ditë të nxehta vere. Edhe pse është një nga materialet që zhubroset më shpejt përsëri duket këndshëm dhe mbi të gjitha të mban freskët. Ka qenë kryefjala e kësaj vere, s'më besoni hidhini një sy Instagramit për të parë blogeret...







Atlete me fustane të shkurtër

Erdhi momenti të nxirrni atletet dhe ato mund t'i kombinoni me një fustan apo "jumpsuit" të shkurtër sepse do të dukeni shumë elegante.









Ju duhet patjetër një detaj printi

Nëse zgjidhni të krijoni një look "total black", mirë do të ishte që të kishit patjetër një kimono me printe apo me detaje tropikale. Më besoni do dukeshit edhe më interesante.

Kaftan
me ngjyra

Nëse ka pasur ndonjëherë një kohë më të përshtatshme për një kaftan të lirshëm ai është kulmi i verës. Një veshje e tillë do të ishte ideale nëse do ta shoqëronit edhe me aksesorët e duhur si përshembull një rreth i madh, një palë vathë të mëdha si dhe sandale me platformë.


















Vish gjithë
ngjyrat

Thuaji "BYE-BYE" nuancave neutral dhe thuaji "HELLO" ngjyrave të ylberit. Vera është periudha më e mirë e vitit për të miksuar ngjyrat e theksuara, madje pse mos t'i vishni ato të gjitha menjëherë?!

Ruani
një temë

Përshembull ju pëlqen roza?! Rozë le të jetë e gjithë veshja juaj, përshtuatur me atlete ose sandale që i shkojnë kësaj ngjyre.



Mbani edhe për pak kohë shpinën jashtë

Fustanet me shpinë të hapur janë kryesisht trend-i i momentit. Sepse janë delikate, seksi dhe të shkëlqyera për të mposhtur nxehtësinë e kësaj vere që ishte nga më të nxehtat që kishim përjetuar ndonjëherë.





Nxirrni kostumet e zyrës

Tani jemi gati t'i nxjerrim kostumet simpatike (njësoj siç bëra dhe unë) nga dollapi për të lehtësuar rrugën tonë dhe për t'u kthyer në rutinën e zakonshme të zyrës.





Mos e mbërtheni totalisht këmishën

Në vend që të fusni vetëm njërën anë të këmishës suaj me kopsa në brezin tuaj, thjesht lini disa butona të poshtëm për të treguar një trekëndësh të vogël të mesit. Kaq e lehtë, kaq elegante pra çfarë po prisni?!



QUIZBOMB



© COPYRIGHT

Nga KADRI VOKOPOLA

KINOFJALËKRYQ






HORIZONTALE

1. Një ekip realizues.
5. _Egoyan regjisor.
9. Mund të jetë një defekt.
13. Fantazma e operas.
15. _Heche aktore.
17. Nino Rota.
18. Janë në modë.
20. Një mund të jetë saudit.
22. Një është Hëna.
26. Gjysmë limiti.
28. Me të bëjnë letër.
31. Është Afërdita.
32. Aktorja në foto.
36. Ma... ktheni së prapthi.
37. Ekstreme në detaj.
39. Aktori në foto.
42. _Williams teniste.
44. Diftong në teatër.
45. U shkrua nga Remarque.
47. Janë baballarët.
48. Sistemi Monetar Europian.
50. Ente Mjedisore Nacionale.
51. Institucione Operative Lokale.
52. Mund të jetë me harqe.
53. Jepen për hartim.
55. Tara_ aktore.
57. Gjysmë erotik.
58. Ishin rivalët e Babilonasve.
59. Mbyllin koncertin.
60. Inicialet e Derain.
62. Inicialet e Munch.
63. Fillojnë nesër.
65. Janë bixhozi për poker.
67. Mburraveci i Alphonse Daudet.
70. _Sastre aktore.
71. Është uji i deuterit.
72. Udhëhoqi Marshimin e Madh.

VERTIKALE

1. Një ndenjëse me rezerva.
2. Inicialet e Eisntein.
3. Franca për shkurt.
4. Gjysma e firmës.
6. Në krye të tabelës.
7. _Jabeur teniste.
8. Kufizojnë muajin.
10. Mund të jenë autonome të tilla.
11. Është kryelarta.
12. Opera e Mascagni-t.
14. Është mjet matës.
16. Në fund të pritjes.,
19. I dha famë Odiseut,
21. Hector_që qe kompozitor.
23. Përmbledh librat e shenjtë të Mazdeizmit.
24. Sidney_regjisori i Serpico.
25. Një mund të jetë dallues.
27. Qëndron mbi piedestal.
29. _Bova aktor.
30. Një dru aromatik që përdoret në mjekësi.
33. Qe Zeusi i nordikëve.
34. Koha e një viti.
35. Gjysmë pomate.
37. Një Blerim_aktor shqiptar.
38. _Brown që thirrej Mr. Dynamite.
39. Oliver Hardy.
40. Duhen shfrytëuar.
41. Ekstreme në litar.
43. Unë dhe ti.
46. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
49. _Zola që shkroi Germinal.
54. Perëndia greke e luftës.
56. Një ndryshon çdo ditë.
57. _Andrea aktore.
61. _Brown i Kodi i Da Vinci-t.
62. Ente Tregtare Elbasan.
64. Brian_ i ambient music.
66. Inicialet e Cocciante-s.
68. Inicialet e Duvall.
69. Inicialet e Magtritte.







MOJ E BUKURA SHQIPËRI!

HORIZONTALE

1. Carol aktore.
4. Sikur janë në krye.
6. Dobroshi aktore.
9. Fillojnë ngadalë.
11. Materia e trurit.
13. Një inkursion me Phantom.
15. Një binar.
17. Ushqehet për armikun.
20. Kufizojnë mendimin.
21. Me të nxjerrin tapë.
23. Janë ata që kanë mungesë hemoglobine.
25. Foto 1.
31. Gibson aktor.
32. Hapen me kllapa.
33. Helen aktore.
34. Foto 2.
35. Kush s'ka... s'ka as kohë e as vullnet.
37. Lumi i Bernës.
40. Qendër ditore.
41. I bindet eprorit një i tillë.
43. Raketa pa zanore.
47. Film i Giuseppe Tornatore-s.
50. Nikola Tesla.
51. Foto 3.
54. Paul Anka.
55. Një e shkruar mbi zarf.
56. Një munnd të jetë kokosi.
57. Takat pa ekstreme.
58. Si moral.
60. Ruhen në fund.
61. Fillojnë raportin.
63. Është shuma e përgjithshme.
65. Ka privilegjin e jetës.
66. Foto 4.
67. Inicialet e Moravia-s.
68. Metheny kitarist.

VERTIKALE

1. Mund të jetë vrastare.
2. Luajnë pa ujë.
3. Qendër votimi.
5. Në fund të fundit.
6. Dy asa.
7. Kështu fillon turni.
8. Ra... së prapthi.
9. Është pikë në kushtetutë.
10. Bien në vjeshtë.
11. Një sportist në unaza.
12. Mund të jetë balistike.
14. Janë si defe.
16. Është ndërprerë te xhuxhët.
18. Degan aktor.
19. Kufizojnë një takim.
22. Renzo arkitekt.
24. _Greco që qe piktor.
25. Gjahu pa ju.
26. I ka tek ringu.
27. Zanore mileti.
28. Lozin pa zanore.
29. Zanoret e agait.
30. Kufizojnë lëvizjet.
32. Kufijtë e Palestinës.
35. Qe një guru i famshëm sikh.
36. Është bombë dore.
38. Shkatërruan Kartagjenën.
39. Mund të jenë monstruoze.
41. E njohur ako e Kolombit.
42. Mund të jenë autonome.
44. Parashtesa e të huajit.
45. Tharë pa zanore.
46. Tase e volejbollit.
47. Josa trainer.
48. Haset pa kufij.
49. Louis Armstrong.
52. Thirrja e sulmit.
53. Ivan Reitman.
54. U shpik nga Volta.
59. Një tip_kërcimi.
62. Nina Hagen.
64. Në mes të dhomës.







HARD SUDOKU

		4			8			3
	5	9			3		2	7
		7	4	5	9			
5					2	6		1
		2			4			6
				8		9		
7					1	4		

MESATAR SUDOKU

			2			3		8
6					5			
	2			1	3			
	1							
		9			8	5		
				3		6	8	
			5	7				1
	3	4				9	6	
				4			7	

I LEHTË SUDOKU

				7	4			
	9			6	1	7	5	
			9					
3			8					6
	4	2						
						1		
8		6						1
	3				7		8	4
		5	2					



KURIOZITETE

PSE ATENTATET VETËVRASËSE QUHEN **KAMIKAZE?**

Në pamje të parë duket një pyetje me përgjigje relativisht të lehtë, pasi çdokush ka dëgjuar për pilotët vetëvrasës japonezë në luftën e dytë botërore, të cilët kishin për mision të lëshoheshin bashkë me avionin që drejtonin mbi anijet luftarake e aeroplanmabajtëset amerikane, duke u shkaktuar atyre dëme shumë të mëdha. . Por ama pakkush e di se termi kamikaze nuk ka asnjë lidhje me aktin vetëvrasës Kamikaze në gjuhën japoneze është një fjalë e përbërë nga Kami, që do të thotë hyjni, perëndi, dhe kaze që do të thotë erë. Origjina e këtij termi është shumë e vejtër, që në vitin 1274, flota mongole e Kublai Khan, ndërsa sulmonte Japoninë u shkatërrua nga një taifun legjendar, gjë që u përsërit edhe në vitin 1281, kur stuhia e madhe mbyti shumë anije mongole. Për këtë arsye, japonezët e quajtën stuhinë kamikaze, pra "erë hyjnore" që i mbrojti atat nga pushtimi mongol. Prandaj edhe pilotët japonezë në luftrën e dytë botërore, për analogji me sa më lart u quajtën kamikaze, me shpresën e besimin për të shkatërruar flotën amerikane. Ma kalimin e viteve termi mori edhe kuptimin me të cilin përdoret sot gjërësisht për të treguar atentatet vetëvrasëse.




PSE DISA **LOKALE-KAFENE** TIPIKE FRANCEZE QUHEN **BISTROT?**

Lidhur me këtë për shumë kohë ka qarkulluar një legjendë urbane, sipas të cilës, në origjinë të këtij termi janë oficerët e ushtrisë ruse. Sipas kësaj legjende, oficerët e ushtrisë ruse që hynë në Paris 1814, frekuentonin shumë pijetoret e vogla nëpër lagjet e Parisit, dhe të irrituar nga ngadalësia me të cilën shërbenin kamerierët, u ulëritnin atyre në rusisht: bistro, (быстро!) që do të thotë shpejt. Por që në fakt etimologët e filologët francezë e hedhin poshtë si krejtësisht të pavertetë, pas lokalet bistrot kanë ekzistuar shumë kohë pra se të vinin ushtarakët rusë. Sipas tyre, origjina e këtij termi mund të vijë nga bistraud që do të thotë shërbëtor, bistingo (cabaret) apo bistouille (alkool i cilësisë së ulët). Sido që të jetë, ekspertët francezë bien dakord se etimologjia e kësaj fjale është akoma e papërcaktuar, por janë të gjithë të një mendjeje se nuk ka origjinë ruse.

PËRGJIGJET

PËRGJIGJE **KINOFJALËKRYQ**



PËRGJIGJE **MOJ E BUKURA SHQIPËRI!**

A	L	T	■	S	I	■	A	R	T	A	■	N	G	■	G	R	I
R	A	I	D	■	T	R	A	■	U	R	R	E	J	T	J	A	■
M	N	■	A	P	■	R	■	■	■	■	A	N	E	M	I	K	E
A	■	G	J	I	R	I	I	L	A	L	Z	I	T	■	M	E	L
■	P	A	R	A	N	T	E	Z	A	T	■	■	H	U	N	T	■
■	S	H	E	N	G	J	I	N	I	■	N	G	E	■	A	A	R
K	■	■	T	O	■	A	■	■	■	V	A	R	T	E	S	■	O
R	K	T	■	■	E	■	M	A	L	E	N	A	■	N	T	■	M
I	S	H	U	L	L	I	I	S	A	Z	A	N	I	T	■	P	A
M	E	R	R	■	A	R	R	E	■	A	K	A	■	E	T	I	K
E	N	■	R	A	■	■	E	■	N	■	■	T	O	T	A	L	E
T	O	K	A	■	B	E	L	S	H	I	■	A	M	■	P	A	T

PËRGJIGJE **HARD SUDOKU**

2	7	4	9	1	8	5	6	3
8	5	9	6	4	3	1	2	7
3	6	1	7	2	5	8	4	9
9	2	8	1	3	6	7	5	4
6	1	7	4	5	9	2	3	8
5	4	3	8	7	2	6	9	1
1	8	2	5	9	4	3	7	6
4	3	6	2	8	7	9	1	5
7	9	5	3	6	1	4	8	2

PËRGJIGJE **MESATAR SUDOKU**

1	9	7	2	6	4	3	5	8
6	8	3	7	9	5	1	2	4
4	2	5	8	1	3	7	9	6
8	1	6	9	5	7	2	4	3
3	4	9	6	2	8	5	1	7
5	7	2	4	3	1	6	8	9
2	6	8	5	7	9	4	3	1
7	3	4	1	8	2	9	6	5
9	5	1	3	4	6	8	7	2

PËRGJIGJE **I LEHTË SUDOKU**

6	8	3	5	7	4	9	1	2
2	9	4	3	6	1	7	5	8
7	5	1	9	8	2	6	4	3
3	1	7	8	2	5	4	9	6
5	4	2	1	9	6	8	3	7
9	6	8	7	4	3	1	2	5
8	2	6	4	3	9	5	7	1
1	3	9	6	5	7	2	8	4
4	7	5	2	1	8	3	6	9

HOROSKOP BOMB

GUSHT 2022

DASHI

Kjo periudhë pushimesh duket se nga njëra anë ju bën të jeni më të relaksuar e nga ana tjetër duket se do t'ju bëjë më të ndërgjegjshëm për një qasje të ndryshnme sa takon administrimit të financave tuaja. Megjithatë dhjetëditëshi i dytë pritet të karakterizohet nga ndikimi mjaft pozitiv i Afërditës te Luani e sidomos i Marsit, që ju sjell energji të reja për të përballuar sfidat që ju presin. Nuk ju mungojnë oferta e propozime, por ju sugjerohet të tregoheni të matur, të dëgjoni shumë e të flisni sa më pak.

BINJAKËT

Pas një periudhe paqëndrueshmërie, mungese besimi, dëshire e vullneti. për shkak edhe të ndikimit të dyshes Mars-Uran, duket se keni ristabilizuar ekuilibret e duhura dhe jeni më të qartë në idetë dhe planet tuaja. Me hyrjen në shenjë të Afërditës ju rikthehet jo vetëm pasioni dhe dëshira për të bërë atë që dëshironi, por do të jeni edhe më të komunikueshëm e më të hapur ndaj të tjerëve. Vetëm se duhet të tregoheni të matur për të mos bërë përtej mundësive tuaja reale. Mirë shëndeti.

DEMI

Keni kaluar një periudhë jo pozitive e kjo do të reflektohet edhe në javën e parë ndoshta, por me kalimin e ditëve gjithçka rregullohet dhe kuadri yjor, me Merkurin dhe Afërditën në shenjë, premton për një muaj mjaft të qetë. Mezi prisni të rihidheni me të gjitha forcat në sektorin ku veproni, por ju këshillohet të mos vendosni të përfshirë nga entuziasmi i momentit, apo euforia për një arritje jo edhe aq domethënëse për ju. Financat në rregull, por mos e teproni me shpenzime të tepërta.

GAFORRJA

Problemet tashmë të lëna pas dore janë akumuluar e duket se ky do të jetë një muaj deri diku i vështirë në planin e raporteve me kolegët, miqtë apo qoftë edhe me familjarët dhe kryesisht për çështje ekonomike. Dhjetëditëshi i parë duket se do të kalojë ndoshta pa shumë probleme, por gjasat janë se ky muaj do të jetë i nxehtë jo vetëm nga aspektin e motit. Megjithatë, me ndihmën e miqve që nuk ju mungojnë do të mundni pa tjetër t'ia dilni mbanë. Ndikimi i Merkurit rrit kreativitetin dhe efikasitetin.

PESHORJA

Në përgjithësi të lindurit e kësaj shenje pritet të kenë një periudhë kryesisht pozitive, sidomos me rikthimin e Merkurit në shenjë. Një kërkesë a propozim i juaji që duket se ka rënë në vesh të shurdhët ju pezmaton disi, por duhet të evitoni të mendoni gjatë për gjëra që kanë kaluar. Hyrja e Afërditës në shenjë ju sjell stimuj të rinj dhe do të ndjeheni më të shpenguar e më të kthjellët në mendime. Jeni disi të dyzuar në një zgjedhje që duhet të bëni, por në fund do të bëni më të mirën.

LUANI

Në përgjithësi ju që i përkisni kësaj sheje duket se do kaloni një periudhë në të cilën do t'ju paraqiten më shumë shanse të mira për të rimëkëmbur financat tuaja, por duhet të shmangni ata që ju sugjerojnë maturi e kujdes edhe kur gjërat janë shumë të qarta. Audentes fortuna iuvat, thotë një proverb latin dhe ju e dini mirë se fati është me guximtarët, prandaj mos hezitoni. Aq më tepër që Merkuri në shenjë duket se do të bëjë të ndjeheni më të sigurtë ndërsa Hëna ju mbështet në planin sentimental.

BRICJAPI

Po kaloni një periudhë disi kaotike, e kjo ka bërë që të përmbysni të gjitha planet tuaja të derisotme e të ndjeni nevojën për të ndryshoni edhe bindjet e opinionet, për të shmangur probleme të tjera që do të mund të kompromet onin aktivitetin dhe financat tuaja. Është mirë të vështroni pak përreth, pasi mundësi dhe oferta të reja do të keni. Përfitoni edhe nga ndikimi i Afërditës në shenjë që ju stimulon aftësitë tuaja komunikuese. Jeni të favorizuar në planin sentiemental. Një dashuri e re në horizont?

VIRGJËRESHA

Edhe pse ndoshta jo gjithçka do të shkojë sipas planeve tuaja, pasi dyshja Mars-Uran sjell pak pështjellim, nuk duhet ta lëshoni veten, pasi mund të jetë vetëm një moment i përkoshëm e që mund të jetë pasojë e ndonjë detaji të lënë pas dore nga vetë ju. Hyrja e afërme në shenjë e Merkurit do t'ju ndihmojë t'ju kthjellohen idetë e t'ju rikthehen aftësitë tuaja organizative. Pjesa e dytë e muajit do të jetë më e favorshme për ju, por duhet të dini të përfitoni e të shfrytëzoni rastet që ju paraqiten.

AKREPI

Pritet të keni një dhjetëditësh të parë mjaft intensiv, pasi nga njëra anë doni të mbyllni sa më shpejt punët që ju kanë mbetur për të menduar për pushimet, e nga ana tjetër, nuk i rezistoni dot tundimit për një ofertë që ju vjen in-extremis. Me Merkurin nga njëra anë dhe Afërditën nga ana tjetër ju hapet një fazë e re në të cilën mund të gjeni kontakte dhe mundësi të reja për të zhvilluar projektet tuaja. Është momenti të vendosni vetë ju për drejtimin që duhet të merrni, pa dëgjuar të tjerët

PESHQIT

Keni mbetur disi të shkuruajar nga një eksperiencë aspak pozitive në raportet me dikë, por kjo nuk duhet të vazhdojë gjatë. Ajo që u bu u bë dhe nuk zhbëhet më. Mendoni më shumë si t'i përshtateni sa më mirë një situatë të re të krijuar, duke evituar të nxirrni konkluzione të gabuara nga ngjarjet e mëparshme. Marsi nga pozicioni i tij te Binjakët ju trazon paksa shpirtërisht, por nga ana tjetër ju rikthen sigurinë e munguar, çka ben që t'i shihi gjërat më me optimizëm. Intersant duket edhe erosi.

SHIGJETARI

Duket se fillimi i këtij muaji ju ka vënë në vështirësi, pasi dëshira tuaj për t'u riorganiziuar e për të përcaktuar prioritetet për periudhën në vijim, mbetet thjesht e tillë, ngaqë ndodhin gjërë të paparashikuara që ju pengojnë. Megjithatë, falë edhe ndikimit të Merkurit, pavarësisht pengesave që ju dalin, do të arrini të fitoni më shumë siguri e më shumë vetëdije për aftësitë e mundësitë që keni për të vënë në jetë projektet tuaja. Dielli te Virgjëresha rrit forcën tuaj të karakterit e vlerësimin për veten.

UJORI

Duket se dyshja Mars-Uran në shenjë do të sjellë një pështjellim në jetën tuaj, por asnjë alarmizëm, pasi bëhet fjalë për një "shkundje" nga ato që mezi prtiten për të filluar një ndryshim rrënjësor, për të cilin keni kohë që mendoni. Hëna e plotë në shenjë ju jep qetësinë për të hedhur hapat në drejtimin e duhur, por më me vendosmëri dhe nga ana tjetër ju bën më të hapur e më pak dyshues ndaj të tjerëve. Çlirojeni veten nga mendime të turbullta e kufizuese dhe do të shihni se ç'dobi do t'ju sjellë.

NEWS BOMB .al

ABONOHU TANI!



REVISTA E PËRMUAJSHME
POLITIKO-KULTURORE



PËR TË BËRË ABONIMIN KONTAKTONI:

POSTA SHQIPTARE:
+355 68 50 80 753

Redaksia Newsbomb.al:
+355 69 67 32 020
abonime@newsbomb.al

newsbomb.al 206,654 FOLLOWERS
newsbomb.al 37.9k FOLLOWERS
NewsbombAl 3,490 FOLLOWERS